REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË

DEGA VENDORE TIRANË

NOTER ERIKETA M. KOKOLI
ADRESA NR.10, SAMI FRASHERI, NR.16
TEL:

MARRËVESHJE SIGURUESE

Nr. repertori: 477 **Nr. koleksioni: 269**

Tirane më 19/03/2021

Ligjet referuese:

1.Ligji nr. 7850, datë 29/07/1994 "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar

2.Ligji nr. 9887, date 10/03/2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar

3.Ligji nr. 110, datë 20/12/2018 "Për Noterinë"

A202105309002915983 6

NOTER
TIRANË

MARRËVESHJE SIGURUESE

Për Kuotat e Shoqërisë Koncesionare "Rruga Orikum - Llogara" Sh.p.k

ndërmjet

Banka e Tiranës Sh.A
Banka OTP Albania Sh.A
Intesa San Paolo Bank Albania Sh.A

dhe

Gjikuria Sh.p.k

Data 18.03. 2021

TABELA E LËNDËS

KREU 1. HYRJA, INTERPRETIMI DHE PËRKUFIZIMET 5

NENI 1.01 HYRJA 5
NENI 1.02 INTERPRETIMI 5
NENI 1.03 PËRKUFIZIMET 6

KREU 2. TË PËRGJITHSHME 10

NENI 2.01 BAZA LIGJORE DHE HIERARKIA E NORMAVE 10
NENI 2.02 PËRSHKRIMI I KOLATERALIT 10
NENI 2.03 QËLLIMI I BARRËS SIGURUESE 10
NENI 2.04 APLIKIMI TEK NDRYSHIMET E KONTRATËS SË KREDISË 10

KREU 3. PËRFAQËSIMI I BARRËMARRËSVE 11

NENI 3.01 PËRFAQËSUESI I PALËVE FINANCUESE 11
NENI 3.02 VEPRIMET KRYHEN VETËM NGA PËRFAQËSUESI I PALËVE FINANCUESE 11
NENI 3.03 KOMUNIKIMET ME PËRFAQËSUESIN E PALËVE FINANCUESE 11
NENI 3.04 VEPRIMET ME EFEKT TË NJËJTË 11

KREU 4. TË DREJTAT DHE DETYRIMET E PALËVE 11

NENI 4.01 TË DREJTAT E BARRËDHËNËSIT 11
NENI 4.02 DETYRIMET E BARRËDHËNËSIT 11
NENI 4.03 TË DREJTAT E BARRËMARRËSVE 14
NENI 4.04 DETYRIMET E BARRËMARRËSVE 14

KREU 5. DEKLARIMET DHE GARANCITË 15

NENI 5.01 DEKLARIMET DHE GARANCITË E PALËVE 15
NENI 5.02 DEKLARIMET DHE GARANCITË E BARRËDHËNËSIT 16
NENI 5.03 RASTET E MOSPËRMBUSHJES 16
NENI 5.04 PASOJAT E MOSPËRMBUSHJES 17

KREU 6. EKZEKUTIMI I KOLATERALIT 18

NENI 6.01 NJOFTIMI PËR EKZEKUTIM. 18
NENI 6.02 MARRËVESHJA SI TITULL EKZEKUTIV 18
NENI 6.03 EKZEKUTIM I DETYRUESHËM. 18
NENI 6.04 SHITJA E KOLATERALIT 18
NENI 6.05 PËRDORIMI I TË ARDHURAVE 18

KREU 7. DËMSHPËRBLIMI 19

NENI 7.01 DËMSHPËRBLIMI 19
NENI 7.02 PRETENDIME NGA PALË TË TRETA 19

KREU 8. HYRJA NË FUQI DHE PËRFUNDIMI I MARRËVESHJES 19

NENI 8.01 HYRJA NË FUQI E MARRËVESHJES 19
NENI 8.02 MOMENTI I PËRFUNDIMIT TË MARRËVESHJES 19
NENI 8.03 MBIJETESA E DISPOZITAVE TË MARRËVESHJES PAS PËRFUNDIMIT 20

KREU 9. ZGJIDHJA E MOSMARREVESHJEVE 20

NENI 9.01 MJETET LIGJORE TË BARRËDHËNËSIT 20
NENI 9.02 MJETET LIGJORE TË BARRËMARRËSVE 20
NENI 9.03 ZGJIDHJA E MOSMARRËVESHJEVE 21
NENI 9.04 LEGJISLACIONI I APLIKUESHËM 21

KREU 10. TË NDRYSHME 21

NENI 10.01 AUTORIZIME 21
NENI 10.02 TRANSFERIMI, CEDIMI, ZËVENDËSIMI, PASOJAT DHE MBI PASARDHËSIT 22
NENI 10.03 PALËT E TRETA NUK PËRFITOJNË TË DREJTA 22
NENI 10.04 VEÇUESHMËRIA E INTERESAVE PASURORE 22
NENI 10.05 NJOFTIMET 22
NENI 10.06 FORCA MADHORE 23
NENI 10.07 HEQJA DORË 24
NENI 10.08 VEÇUESHMËRIA 24
NENI 10.09 ASNJË INTERPRETIM KUNDËR HARTUESIT 24
NENI 10.10 TË KUPTUARIT E DOKUMENTEVE DHE DISPOZITAVE 24
NENI 10.11 NDRYSHIMET 24
NENI 10.12 PËRFAQËSUESI I PALËVE FINANCUESE 24
NENI 10.13 DISKRECIONI LEHTËSUES 25
NENI 10.14 MARRËVESHJA E PLOTË 25
NENI 10.15 KOPJET E NJËJTA 25

Shtojca 1 – Vendim Nr.1 Datë 15.11.2020 i Asamblesë së Përgjithshme të shoqërisë "Gjikuria" sh.p.k
Shtojca 2 – Letërnjoftimet ID
Shtojca 3 – Esktraktet nga QKB

HYRJE

Kjo Marrëveshje Siguruese (në vijim "**Marrëveshja**") nënshkruhet sot më datë 18.03. 2021 ("**Data e Nënshkrimit**"), para meje Notere Eriketa Kokoli, anëtare në Dhomën Kombëtare të Noterisë, Dega Vendore Tiranë, me zyrë në adresën Rruga "Sami Frasheri", pallati përballë Drejtorisë së Policisë Tiranë, kati 4, Tiranë, nga dhe ndërmjet palëve si më poshtë (në vijim secila palë më poshtë do të referohet veçmas si "**Pala**" dhe së bashku "**Palët**" siç mund t'a kërkojë herë pas here konteksti i kësaj Marrëveshjeje):

(1) GJIKURIA sh.p.k., shoqëri e themeluar sipas legjislacionit shqiptar, me adresë në rrugën "Ibrahim Rugova", Pallati "Kontakt", kati 2, Tiranë, me NUIS J62903456H, (në vijim "**Barrëdhënësi**"), përfaqësuar në bazë të Vendimit Nr.1 Datë 15.11.2020 i Asamblesë së Jashtëzakonshme të ortakëve të shoqërisë "Gjikuria" sh.p.k, bashkëngjitur si Shtojca 1 nga administratorët e saj Z.Florenc Gjikuria, i biri i Milos, lindur më 12.01.1973, në Memaliaj, banues në adresën Kompleksi "Rolling Hills", Vila 86, Tiranë, madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar, me Letërnjoftim me Nr. 031406006 dhe me Nr. Personal H30112106D; dhe Z. Milo Gjikuria, i biri i Janit, lindur më 25.07.1943, në Dhërmi, banues në adresën Rruga "Muhamet Gjollesha", Blloku Vasil Shanto, P. 3/1, Tiranë, madhor dhe me zotësi të plotë juridike per te vepruar, mbajtës i letërnjoftimit me Nr. 034489850 dhe me numër personal E30725035J;

(2) BANKA E TIRANËS sh.a., shoqëri aksionare e themeluar sipas legjislacionit shqiptar, me adresë në rrugën "Ibrahimi Rugova", me NUIS J61924008V (në vijim "**Përfaqësuesi i Palëve Financuese**"), e përfaqësuar nga Drejtore e Divizionit të Korporatave, znj. Glenda Kurti, e bija e Agronit, lindur me 06.03.1978, në Tiranë dhe banuese në Tiranë në adresën Rr. "Kongresi i Manastirit", Pall. ½, Shkalla 3, identifikuar me pasaportë Nr. H85306150N dhe Drejtore e Departamentit të Administrimit të Kredive, Znj. Aida Cengu, e bija e Azemit, lindur me 16.02.1970 në Kukës dhe banuese në Tiranë me Letërnjoftim me Nr. 035236532 dhe me Nr. Personal H05216129L, madhore e me zotësi të plotë juridike për të vepruar;

(3) BANKA INTESA SANPAOLO BANK ALBANIA sh.a. shoqëri aksionare e themeluar sipas legjislacionit shqiptar, me adresë në rrugën "Ismail Qemali", Nr. 27, me NUIS J81817006P, e përfaqësuar nga Z. Alban Velo, shtetas shqiptar, lindur më datë 16.05.1976, në Lushnjë, me Letërnjoftim me Nr. Personal H60516140E, në cilësinë e Drejtorit të Departamentit të SME -ve dhe Zj.Jonida Duro, shtetase shqiptare, lindur më datë 08.01.1984, në Vlorë, me Letërnjoftim me Nr. Personal I45108023L, në cilësinë e Menaxheres së Marrëdhënieve me Klientët SME; dhe

(4) BANKA OTP ALBANIA sh.a. shoqëri aksionare e themeluar sipas legjislacionit shqiptar, me adresë në rrugën "Bulevardi Dëshmorët e Kombit", Twin Towers, Kulla 1, Kati 9, me NUIS K41424801U e përfaqësuar nga zoti Ferid Shijaku, në

cilësinë e Drejtori i Divizionit të Biznesit me Letërnjoftim me Nr. 035912295 dhe me Nr. Personal G80118119I dhe zoti Idit Farka, në cilësinë e Koordinator Projekti dhe i Financës së Strukturuar me Letërnjoftim me Nr. 035812285 dhe me Nr. Personal I70122052S;

Banka e Tiranës sh.a., Intesa SanPaolo Bank sh.a. dhe Banka OTP Albania sh.a., do të referohen në vijim në këtë Marrëveshje si "**Barrëmarrësit**" dhe/ose **"Kredidhënësit".**

PËRSHKRIME PARAPRAKE

MEQENËSE, më 20 Maj 2019, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Barrëdhënësi dhe Kredimarrësi kanë lidhur një Kontratë Koncesioni/PPP të nënshkruar në Tiranë përpara noter Ermal Hamzaj me Nr. 2515 Rep/Nr. 1353 Kol. Datë 20.05.2019 për projektimin, ndërtimin dhe mirëmbajtjen e segmentit rrugor "Porti i Jahteve – By Pass Orikum – Dukat (Ura e Shën Elizës)" (në vijim "**Kontrata e Koncesionit**");

MEQENËSE, Kredimarrësi ka kërkuar kredi për realizimin e projektit për projektimin, ndërtimin dhe mirëmbajtjen e segmentit rrugor "Porti i Jahteve – By Pass Orikum – Dukat (Ura e Shën Elizës)";

MEQENËSE, Kredidhënësit kanë rënë dakord që ta financojnë Kredimarrësin sipas kushteve të parashikuara në Kontratën e Kredisë (siç përkufizohet më poshtë);

MEQENËSE, Kontrata e Kredisë parashikon që Barrëdhënësi së bashku me Palët Garantuese do t'i japin Kredidhënësve garanci duke vendosur Barrë Siguruese (siç përkufizohet më poshtë) mbi Kuotat (siç përkufizohet më poshtë) e Barrëdhënësit sipas kushteve të kësaj Marrëveshje;

ATËHERË, në bazë të kushteve, të drejtave, detyrimeve, deklarimeve dhe garancive të shprehura në këtë Marrëveshje, Palët bien dakord si më poshtë:

KREU 1. HYRJA, INTERPRETIMI DHE PËRKUFIZIMET

Neni 1.01 Hyrja

Të gjitha parashtrimet që janë përfshirë në Hyrjen dhe Përshkrimet Paraprake të kësaj Marrëveshjeje janë pjesë integrale e saj.

Neni 1.02 Interpretimi

(a) Marrëveshja si e Tërë. Çdo e drejtë, detyrim, apo kusht i përshkruar në këtë Marrëveshje duhet të interpretohet në kontekstin e Marrëveshjes të marrë si e tërë dhe duke marrë në konsideratë qëllimet që nxitën Palët për të hyrë në këtë Marrëveshje.

(b) Titujt, Krerët, Nenet, Paragrafët. Titujt e krerëve, neneve, paragrafëve, nënparagrafëve që përmban kjo Marrëveshje si dhe ato që janë në tabelën e lëndës janë vetëm

për referencë dhe nuk do të ndikojnë në asnjë mënyrë në kuptimin apo interpretimin e kësaj Marrëveshjeje.

(c) Shtojcat. Të gjitha anekset dhe shtojcat bashkëngjitur apo referuar, janë inkorporuar dhe janë pjesë integrale të kësaj Marrëveshje. Nëse një fjalë e përdorur në ndonjë aneks apo shtojcë fillon më gërmë kapitale por nuk është e përkufizuar në këtë aneks apo shtojcë, do të ketë kuptimin e përkufizuar në këtë Marrëveshje. Kur në tekstin e kësaj Marrëveshjeje ka referenca për një kre, nen, paragraf, nënparagraf, aneks, shtojcë, të tilla referenca lidhen me kreun, nenin, paragrafin, nënparagrafin, aneksin apo shtojcën e kësaj Marrëveshjeje, përveçse kur përcaktohet ndryshe.

(d) Interpretimet Gramatikore. Përveçse në rastet kur thuhet shprehimisht ndryshe, në Marrëveshje:

(1) Fjalët e përdorura në numrin njëjës përfshijnë edhe ato të përdorura në numrin shumës;

(2) Fjalët e përdorura në një rasë apo gjini përfshijnë, sipas kontekstit, edhe rasat dhe gjinitë e tjera;

(3) Nëse një fjalë është e përkufizuar, edhe format e tjera gramatikore do të kenë kuptimin përkatës;

(4) Fjala "përfshin", do të thotë "përfshin, pa u kufizuar", pavarësisht nëse ndiqet nga ai togfjalësh apo jo; dhe

(5) Fjalët e përdorura në këtë Marrëveshje dhe që janë përkufizuar në Kontratën e Kredisë, nëse nuk parashikohet ndryshe, do të kenë të njëjtin kuptim.

Neni 1.03 Përkufizimet

"Barra Siguruese" është e drejta reale mbi Kolateralin, si të tashëm, ashtu dhe të ardhshëm, që siguron përmbushjen e Detyrimeve kundrejt Barrëmarrësve.

"Barrë" do të thotë çdo interes ose pjesëmarrje në kapital e çdo Personi (përfshirë çdo të drejtë për të blerë, opsion apo të drejtë parablerje) apo çdo hipotekë, uzufrukt, servitut, detyrim, peng, garanci, e drejtë shfrytëzimi, e drejtë përdorimi apo banimi, kalim të drejtash, kufizim, barrë siguruese (përfshirë ato të krijuara me ligj), kolateral financiar, titull me rezervë apo marrëveshje ose transaksione të tjera siguruese, apo dhënie me qira, blerje me këste apo qiramarrje afatgjata, shitje me kredi apo marrëveshje të tjera ku parashikohet që pagesa të kryhet në kohë të ndryshme, apo çfarëdo lloj e drejte tjetër reale apo kufizimi që mund të vihet mbi, apo lidhet me, Kolateralin.

"Barrëdhënës" është Gjikuria sh.p.k., një shoqëri e themeluar sipas legjislacionit shqiptar, me adresë në rrugën "Ibrahim Rugova", Pallati "Kontakt", kati 2, Tiranë, me NIPT J62903456H.

"Barrëmarrësit" ka kuptimin që i është dhënë në hyrjen e kësaj Marrëveshjeje.

"Data e Nënshkrimit" ka kuptimin që i është dhënë në hyrjen e kësaj Marrëveshjeje.

"Dëm" i referohet në mënyrë kumulative çdo dëmi kontraktor ose jashtëkontraktor, kosto, shpenzimi të kryer, pagese, humbje ose detyrimi i cili është pasojë direkte ose e tërthortë e shkeljes së deklaratave, garancive, premtimeve apo e zotimeve të kësaj Marrëveshjeje, përfshirë shpenzimet e kryera për të parandaluar apo përballuar Pretendimet që sjellin shkaktimin e këtij Dëmi, apo për të adresuar apo parandaluar pasojat e tij, si shpenzimet avokatore dhe gjyqësore.

"Detyrimet" ka kuptimin e dhënë në Kontratën e Kredisë.

"Disbursim" ka kuptimin e dhënë në Kontratën e Kredisë.

"Ditë Pune" do të thotë dita në të cilën Banka e Shqipërisë është e hapur për punë, përjashtuar të shtunën, të dielën dhe festat zyrtare në Republikën e Shqipërisë.

"Dokumentet e Financimit" kanë kuptimin e dhënë në Kontratën e Kredisë.

"Dokumentet e Garancive" kanë kuptimin e dhënë në Kontratën e Kredisë.

"Entitet Qeveritar" do të thotë (i) Kuvendi, Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë, çdo ministri, departament, ose nëndarje e tyre politike; dhe (ii) çdo Person tjetër, gjykatë, agjenci apo autoritet nën kontrollin e drejtpërdrejtë ose jo të Republikës së Shqipërisë, që ka juridiksion mbi Palët sipas Legjislacionit të Zbatueshëm.

"Force Madhore" në këtë Marrëveshje do të konsiderohet një ngjarje apo situatë që: (i) është e paparashikueshme, (ii) është jashtë kontrollit të Palës që e pretendon forcën madhore dhe nuk është shkaktuar për faj të saj (iii) ka ndikim direkt mbi Palën që e pretendon forcën madhore, dhe (iv) bën të pamundur përmbushjen e detyrimit nga ana e Palës që pretendon forcën madhore. Për ilustrim, Forca Madhore mund të përfshijë (x) aktet e luftës, terrorizmit, revoltat civile, veprimet e elementeve të natyrës (p.sh. zjarri, përmbytja, stuhia etj.), apo vendosja e masave të jashtëzakonshme sipas Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë. Për të shmangur çdo keqinterpretim, mungesa e likuiditetit të një Pale, bllokimi i llogarive bankare të tij nga ndonjë prej Entiteteve Qeveritare, paaftësia paguese, bllokimi i aktivitetit tregtar, pezullimi apo bllokimi i Punimeve të Barrëdhënësit nga nje Entitet Qeveritar nuk janë dhe nuk do të konsiderohen si Force Madhore.

"Garanci" ka kuptimin e dhënë te Kontrata e Kredisë.

"Gjykim" ka kuptimin që i është dhënë te Neni 5.01(c) (*Deklarimet dhe Garancitë e Palëve; Mungesa e Konflikteve apo Nevojës për Miratime*), i kësaj Marrëveshjeje.

"Informacion Konfidencial" ka kuptimin e dhënë te Neni 10.01(b) *(Autorizime; Autorizimi për Përdorimin e Informacionit Konfidencial),* i kësaj Marrëveshjeje.

"Kolateral" ka kuptimin e dhënë te Neni 2.02 (*Përshkrimi i Kolateralit*) i kësaj Marrëveshjeje.

"Kontrata e Koncesionit" ka kuptimin e dhënë në Përshkrimet Paraprake të kësaj Marrëveshjeje.

"Kontrata e Kredisë" është kontrata me Nr. 2169 Rep, Nr. 1143 Kol. Datë 15.11.2020, nënshkruar pranë noteres Eriketa Kokoli.

"Kredimarrësi" është Shoqëria Konçesionare "Rruga Orikum – Llogara" sh.p.k., shoqëri e themeluar sipas legjislacionit shqiptar, me adresë në rrugën "Ibrahim Rugova", Pallati "Kontakt", kati 3, Tiranë, me NIPT L82327014A.

"Kuota" ka kuptimin e dhënë te Neni 2.02 (*Përshkrimi i Kolateralit*) i kësaj Marrëveshjeje.

"Legjislacion i Zbatueshëm" do të thotë çdo ligj, akt nënligjor, akt normativ kombëtar apo lokal, urdhër, dekret apo akt tjetër, kod, direktivë, vendime dhe akte të ministrave, qarkore të departamenteve, rregullore, deklarata dhe interpretime të organeve zyrtare të Republikës së Shqipërisë, statutet e shoqërive Palë të kësaj Marrëveshjeje, çdo vendim gjyqësor apo çdo licencë, aprovim, leje apo autorizim apo miratime të tjera në fuqi, të Republikës së Shqipërisë, apo të çdo njësie apo ndarje administrative ose të çdo Personi të krijuar me ligj, (qoftë i pavaruar apo jo), që ka juridiksionin përkatës mbi Palët, përfshirë ndryshimet e herëpashershme të tyre.

"Ligji për Barrët Siguruese" ka kuptimin e ligjit nr. 8537 datë 18.10.1999 *"Ligji për Barrët Siguruese"*, me gjithë ndryshimet që kanë hyrë në fuqi në datën e nënshkrimit të kësaj Marrëveshje. Ligji për Barrët Siguruese konsiderohet pjesë e pandashme e Legjislacionit të Zbatueshëm.

"Ligji për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" ka kuptimin e ligjit nr.9887 datë 10.3.2008 *"Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale"*.

"Marrëveshja e Drejtpërdrejtë" është kontrata me Nr.Prot.7762/4 Datë 16.11.2020.

"Marrëveshja Ndërmjet Kreditorëve" është kontrata me nr. 472 Rep dhe nr. 264 Kol, datë 19.03.2021.

"Marrëveshje" ka kuptimin që i është dhënë në hyrjen e kësaj Marrëveshjeje.

"Ndryshim Përkeqësues Thelbësor" (i) kur përdoret në referencë me Barrëdhënësin ka kuptimin që i është dhënë në Kontratën e Kredisë; dhe (ii) kur i referohet Barrëdhënësve do të thotë një ndryshim i tillë i rrethanave që nuk i lejon Barrëmarrësve të përmbushin detyrimet e tyre në bazë të kësaj Marrëveshjeje.

"**Pala e Dëmshpërblyer**" ka kuptimin e dhënë te Neni 7.01 (*Dëmshpërblimi*), i kësaj Marrëveshjeje.

"**Pala e Dëmshpërblyese**" ka kuptimin e dhënë te Neni 7.01 (*Dëmshpërblimi*), i kësaj Marrëveshjeje.

"**Palë**" ka kuptimin që i është dhënë në hyrjen e kësaj Marrëveshjeje.

"**Palët Garantuese**" ka kuptimin e dhënë në Kontratën e Kredisë.

"**Person i Përshtatshëm**" ka kuptimin e dhënë në Marrëveshjen e Drejtpërdrejtë.

"**Person**" do të thotë çdo individ, person fizik, person juridik, ortakëri e çdo lloj forme organizimi e parashikuar nga Legjislacioni i Zbatueshëm ose ai i një vendi specifik, përfshirë Entitetet Qeveritare.

"**Përfaqësuesi i Palëve Financuese**" ka kuptimin që i është dhënë te Neni 3.01 (*Përfaqësuesi i Palëve Financuese)* i kësaj Marrëveshjeje si dhe ushtron kompetencat e Përfaqësuesit të Kredisë dhe Përfaqësuesit të Garancisë sipas Marrëveshjes Ndërmjet Kreditorëve dhe përfshin çdo subjekt që mund të zëvendësojë Përfaqësuesin aktual të Palëve Financuese në të ardhmen.

"**Pretendim**" do të thotë çdo ankesë, padi, pretendim, kërkesë për dëmshpërblim, në gjykatë, gjykatë arbitrazhi, Entitet Qeveritar apo në çdo institucion a organizëm që merr vendime të ngjashme dhe që ka juridiksion mbi Palët.

"**Rast Mospërmbushje**" ka kuptimin që i është dhënë në Kontratën e Kredisë dhe/ose te Neni 5.03*(Rastet e Mospërmbushjes)* i kësaj Marrëveshjeje.

"**Regjistri i Barrëve Siguruese**" do të thotë Regjistri i Barrëve Siguruese i krijuar në bazë të Ligjit për Barrës Siguruese, apo çdo institucion që trashëgon funksionet dhe kompetencat e tij në të ardhmen.

"**Shoqëri Mëmë**" ka kuptimin që i jepet në ligjin nr. 9901, datë 14.4.2008 *"Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare"*, i ndryshuar.

"**Të Drejtat e Lidhura**" do të thotë:

(a) çdo dividend, shpërndarje, ose interes i paguar ose i pagueshem në lidhje me Kuotat, përfshirë por pa u kufizuar në shpërndarjet të cilat lindin si pasojë e zvogëlimit të kapitalit themeltar, pretendimet mbi të ardhurat e likuidimit si dhe të gjithë pretendimet financiare të tashme apo të ardhshme të lidhura;

(b) çdo kuotë, letra me vlerë, të drejta, të holla ose pasuri të lindura ose të ofruara në çdo kohë (me anë të së drejtës së kthimit, bonuseve, preferimit, të drejtave me kusht, zëvendësimit, këmbimit ose ndryshe) në lidhje me ose mbi cilëndo nga Kuotat;

(c) të gjithë dividendët, interesat ose të ardhura të tjera në lidhje me çdo aset të përmendur në paragrafin (b) më lart;

(d) të gjithë të drejtat e votës në lidhje me Kuotat, të cilat mund të ushtrohen si në asamblenë e zakonshme të Kredimarrësit; dhe

(e) të gjitha të drejtat e Barrëdhënësit në lidhje me ose mbi cilëndo kuotë që mund të fitohet në të ardhmen prej Barrëdhënësit nëpërmjet kapitalizimit të fitimeve, rritjes së kapitalit, ndarjes, kthimit të borxhit në kapital, sigurimit të kuotave.

KREU 2. TË PËRGJITHSHME

Neni 2.01 Baza Ligjore dhe Hierarkia e Normave

Kjo Marrëveshje bazohet në Legjislaconin e Zbatueshëm, përfshirë, por pa u kufizuar në dispozitat për Ligjin Barrët Siguruese. Për aq sa lejohet nga dispozitat e Legjislacionit të Zbatueshëm, kur kjo Marrëveshje parashikon ndryshe nga Legjislacioni i Zbatueshëm, dispozitat e kësaj Marrëveshje do të mbizotërojnë.

Neni 2.02 Përshkrimi i Kolateralit

Nëpërmjet kësaj Marrëveshjeje, Barrëdhënësi vendos në favor të Barrëmarrësve, si Garanci për përmbushjen e Detyrimeve sipas Kontratës së Kredisë, Barrë Siguruese të radhës së parë mbi:

(a) kuotën pjesë të kapitalit, në pronësi të Barrëdhënësit në kapitalin e shoqërisë Shoqëria Koncesionare "Rruga Orikum – Llogara" sh.p.k., shoqëri e themeluar sipas legjislacionit shqiptar, me adresë në rrugën "Ibrahim Rugova", Pallati "Kontakt", kati 3, Tiranë, me NIPT L82327014A (në vijim "**Kredimarrësi**"); dhe që përfaqëson 100 % të kapitalit total të Kredimarrësit (në vijim "**Kuota**"), dhe

(b) çdo kuotë të re që Barrëdhënësi do të zotërojë mbi Kredimarrësin, letër me vlerë, të drejta, të holla, ose pasuri të lindura ose të ofruara në çdo kohë (qoftë me anë të kthimit, bonus, preferimit, të drejtave me kusht, zëvendësimit, këmbimit ose ndryshe), etj; dhe

(c) të gjitha Të Drejtat e Lidhura me paragrafët (a) dhe (b) të këtij Neni më lart (në vijim, paragrafët (a), (b) dhe (c) të këtij Neni, bashkarisht do referohen në këtë Marrëveshje si "**Kolaterali**").

Neni 2.03 Qëllimi i Barrës Siguruese

Barra Siguruese vendoset me qëllim sigurimin e përmbushjes të të gjitha Detyrimeve të Kredimarrësit dhe/ose Dorëzanësve sipas Kontratës së Kredisë, duke përfshirë por pa u kufizuar në shumën totale të Detyrimeve kundrejt Kredidhënësve deri në pagimin e plotë të tyre nga Kredimarrësi dhe/ose Dorëzanësit, si dhe çdo shumë tjetër që këta të fundit i detyrohen Barrëmarrësve sipas Kontratës së Kredisë.

Neni 2.04 Aplikimi tek Ndryshimet e Kontratës së Kredisë

Palët bien dakord që kjo Marrëveshje do të aplikohet *mutatis mutandis* edhe përmbi çdo ndryshim që mund t'i bëhet Kontratës së Kredisë, përveç rastit kur këto ndryshime e kanë përjashtuar shprehimisht aplikimin e kësaj Marrëveshje. Çdo ndryshim që mund t'i bëhet Kontratës së Kredisë nuk do të prekë Barrën Siguruese të vendosur mbi Kolateralin.

KREU 3. PËRFAQËSIMI I BARRËMARRËSVE

Neni 3.01 Përfaqësuesi i Palëve Financuese

Palët pranojnë se Barrëmarrësit kanë emëruar Bankën e Tiranës sh.a si përfaqësues të tyre për të ndërmarrë çdo veprim dhe firmosur çdo akt që ka lidhje me ata sipas kësaj Marrëveshje (në vijim "**Përfaqësues i Palëve Financuese**"). Palët bien dakord dhe pranojnë se çdo veprim apo akt i firmosur prej Përfaqësuesit të Palëve Financuese do të konsiderohet si i kryer personalisht prej tyre, përveç rasteve kur kjo Marrëveshje, Marrëveshja Ndërmjet Kreditorëve apo Legjislacioni i Zbatueshëm parashikon ndryshe.

Neni 3.02 Veprimet Kryhen Vetëm nga Përfaqësuesi i Palëve Financuese

Çdo veprim i parashikuar në këtë Marrëveshje, si dhe çdo veprim i nevojshëm apo i dobishëm për të ekzekutuar këtë Marrëveshje, që duhet të kryhet nga Barrëmarrësit, mund të kryhet edhe nga Përfaqësuesi i Palëve Financuese në emër dhe për llogari të të gjithë Barrëmarrësve.

Neni 3.03 Komunikimet me Përfaqësuesin e Palëve Financuese

Për zbatimin e kësaj Marrëveshjeje, Barrëdhënësi do të komunikojë me Përfaqësuesin e Palëve Financuese.

Neni 3.04 Veprimet me Efekt të Njëjtë

Çdo veprim që Barrëdhënësi kryen kundrejt Përfaqësuesit të Palëve Financuese, do të konsiderohet se ka efekt të njëjtë kundrejt Barrëmarrësve të tjerë, dhe çdo veprim që Përfaqësuesi i Palëve Financuese kryen kundrejt Barrëdhënësit, do të konsiderohet se është bërë nga tërë Barrëmarrësit bashkërisht.

KREU 4. TË DREJTAT DHE DETYRIMET E PALËVE

Neni 4.01 Të Drejtat e Barrëdhënësit

Gjatë gjithë kohëzgjatjes së kësaj Marrëveshjeje dhe derisa nuk është dërguar një njoftim për Rast Mospërmbushje, Barrëdhënësi gëzon të gjitha Të Drejtat e Lidhura me Kolateralin që bazohen në Legjislacionin e Zbatueshëm.

Neni 4.02 Detyrimet e Barrëdhënësit

Barrëdhënësi zotohet që gjatë kohëzgjatjes së kësaj Marrëveshjeje:

(a) Regjistrimi i Barrës Siguruese. Regjistrimi pranë Regjistrit të Barrëve Siguruese do të kryhet nga Barrëdhënësi me shpenzimet e veta, brenda një afati të arsyeshëm me të cilin

Barrëmarrësit janë dakord, përveç kur Barrëmarrësit vendosin ndryshe. Kur ky regjistrim kryhet nga Barrëdhënësi, ky i fundit do t'i dorëzojë Përfaqësuesit të Palëve Financuese dokumentin zyrtar që vërteton regjistrimin ose një deklaratë në formë dhe përmbajtje të pranueshme nga Barrëmarrësit në lidhje me kryerjen e regjistrimeve sa më sipër. Nëse Barrëdhënësi nuk kryen regjistrimin sipas kushteve të vendosura nga Barrëmarrësit, ose nëse Barrëmarrësit me diskrecionin e tyre të lirë vendosin që ta kryejnë vetë regjistrimin ose nëpërmjet ekspertëve të jashtëm të zgjedhur nga ata, Barrëdhënësi nuk çlirohet nga detyrimi për të mbuluar shpenzimet për kryerjen e regjistrimit. Shpenzimet për këtë regjistrim, do të mbulohen në çdo rast nga Dhënësi, sa më shpejt të jetë e mundur pas kërkesës së Përfaqësuesit të Palëve Financuese. Barrëdhënësi detyrohet të kryejë regjistrimet përkatëse edhe në Qendrën Kombëtare të Biznesit me shpenzimet e veta dhe brenda afateve ligjore.

(b) Barra me Rradhë Preference të Parë. Barrëdhënësi do t'i mbajë të drejtat e Barrëmarrësve në bazë të kësaj Marrëveshjeje si Barrë Siguruese me preferencë të radhës së parë, duke mbizotëruar mbi të drejtat e çdo kreditori tjetër të tashëm apo të ardhshëm të Barrëdhënësit.

(c) Depozitimi i Arkëtimeve në Llogarinë e Kolateralit. Barrëdhënësit do të depozitojnë në Llogarinë e Kolateralit të gjitha arkëtimet (divident, etj)që konsiderohen pjesë përbërëse e Kolateralit.

(d) Dhënie Informacioni. Me kërkesë të Përfaqësuesit të Palëve Financuese, Barrëdhënësi do të japë me shkrim çdo informacion që mund ti kërkohet në lidhje me Kolateralin.

(e) Veprime të Tjera. Me kërkesë të Përfaqësuesit të Palëve Financuese, Barrëdhënësi do të kryejë të gjitha veprimet e nevojshme si dhe do të firmosë çdo dokument apo akt, me qëllim që të ruaj të pacënuar regjistrimin e Barrës Siguruese të krijuar në bazë të kësaj Marrëveshjeje në favor të Barrëmarrësve dhe në përgjithësi ti japë efekt të plotë të gjitha të drejtave që kjo Marrëveshje u jep Barrëmarrësve, përfshirë, pa kufizim:

(1) kompletimin dhe mbajtjen në fuqi të plotë të Barrës Siguruese mbi Kolateralin;

(2) vendosjen e Barrës Siguruese në favor të Barrëmarrësve mbi të gjitha kuotat e ardhshme dhe Të Drejtat e Lidhura me to të nënshkruara nga Barrëdhënësi;

(3) t'i mundësojë Barrëmarrësve të ushtrojnë të drejtat dhe mjetet juridike që ata kanë të drejtë në përputhje me këtë Marrëveshje, duke përfshirë, pa kufizime, të gjitha të drejat dhe mjetet juridike të ushtrueshme pas ndodhjes së një Rasti Mospërmbushjeje; dhe/ose

(4) të ndryshojë statutin e Barrëdhënësit dhe/ose Kredimarrësit për të reflektuar sa më mirë të drejtat e Barrëmarrësve në bazë të kësaj Marrëveshjeje.

(f) Kolaterali i Lir[illegible]ga Barrët. Barrëdhënësi do të mbajë Kolateralin e lirë nga çdo Bar[illegible] (me përjashtim të at[illegible] për të cilat Barrëmarrësit kanë dhënë pëlqimin me shkrim, përfs[illegible]rë Barrën Sigurues[illegible]sipas kësaj Marrëveshje).

([illegible]) Ndalime t[illegible] Ndryshme. Barrëdhënësi nuk do të kryejë asnjë veprim material apo juridik, B[illegible]simi, dispo[illegible]imi, ndarje, bashkimi, përthithje, shndërrimi, pjesëtimi, transferimi, tjetërsimi a[illegible] drejtave mbi Kolateralin ose çdo Të Drejtë të Lidhur me të (përfshirë këtu asetet dhe/ ose aktivitetin e shoqërisë dhe/ose zmadhimin e kapitalit që mund të ndikojë në zvogëlimin e pjesëmarrjes së Barrëmarrësve në kapital) në asnjë lloj forme apo mënyre, pa miratim e mëparshëm me shkrim të Barrëmarrësve.

(h) Pretendimet apo të Metat. Do të njoftojë menjëherë Përfaqësuesin e Palëve Financuese në rast se ka apo vihet në dijeni të një Pretendimi kundrejt Kolateralit apo/dhe nëse një masë kufizimi vendoset mbi Kolateralin, apo/dhe apo një e metë materiale apo juridike mund të cenojë të drejtën e Barrës Siguruese të Barrëmarrësve. Barrëdhënësi do të ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme për ti shmangur ato Pretendime, kufizime, apo të meta duke ruajtur dhe mbajtur të pacënuar regjistrimin e Barrës Siguruese në favor të Barrëmarrësve.

(i) Shpenzimet e Barrëdhënësit. Barrëdhënësi nuk do të ngarkojë Barrëmarrësit me asnjë nga shpenzimet për regjistrimin apo mbajtjen e pacënuar të regjistrimit të Barrës Siguruese në favor të Barrëmarrësve në Regjistrin e Barrëve Siguruese.

(j) Garanci për Shpenzimet. Barra Siguruese mbi Kolateralin, përveç Detyrimeve sipas Kontratës së Kredisë do të garantojë edhe pagesën apo rimbursimin e të gjitha shpenzimeve gjyqësore, shpenzimet për ekzekutimin e detyrueshëm të Detyrimeve nëpërmjet procedurave për ekzekutimin e detyrueshëm, shpërblimin e Dëmit të shkaktuar nga vonesa e ekzekutimit, shpenzimet e kryera nga Barrëmarrësit për regjistrimin e Barrës Siguruese në Regjistrin e Barrëve Siguruese (nëse regjistrimi është bërë nga Barrëdhënësit), shpenzimet për sigurimin e Kolateralit, komisionet bankare dhe të raportit të vlerësimit, si dhe çdo detyrim tjetër të Palëve Kredimarrëse dhe/ose Barrëdhënësit që burojnë nga Kontrata e Kredisë dhe/ose kjo Marrëveshje dhe/ose Legjislacioni i Zbatueshëm.

(k) Zëvendësimi në Rast Cenimi. Në rast se Barrëmarrësve u cënohet e drejta e Barrës Siguruese sipas kësaj Marrëveshjeje, për çfarëdolloj arsye, në mënyrë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë, qoftë pjesërisht apo edhe tërësisht, atëherë Barrëdhënësi do të jetë i detyruar me kërkesën e Barrëmarrësve, të zëvëndësojë të drejtën e cënuar të Barrës Siguruese me një Garanci shtesë të kënaqshme për Barrëmarrësit si dhe brenda afatit të vendosur nga këta të fundit.

(l) Njoftime për Barrëmarrësit. Barrëdhënësi do të njoftojë Barrëmarrësit menjëherë për çdo informacion të rëndësishëm në lidhje me Kolateralin, përfshirë, pa u kufizuar në:

(1) çdo ndryshim në të dhënat identifikuese të Barrëdhënësit;

(2) ekzistencën e çdo fakti të pranishëm apo të mundshëm që mund të shkaktojë:

(i) pamundësinë e likuidimit të Kolateralit;

(ii) vështirësi për ekzekutimin e të drejtave të Kredidhënësve ndaj Kolateralit; ose

(iii) Rast Mospërmbushjeje.

(m) Ushtrimi i të Drejtës së Votës. Gjatë gjithë kohëzgjatjes së kësaj Marrëveshjeje Barrëdhënësi do ti ushtrojë të drejtat e votës në mënyrë të tillë që Barrëdhënësi të mos marrë asnjë vendim i cili (i) nuk do të ishte në përputhje me parashikimet e kësaj Marrëveshje; (ii) do të ndikonte negativisht në vlefshmërinë apo ekzekutimin e Barrës Siguruese; (iii) nuk do të ishte në përputhje ose do të ishte në kundërshtim me parashikimet në Kontratën e Kredisë; (iv) do të pengonte ushtrimin e të drejtave të Barrëmarrësve të cilat lindin nga/ose në lidhje me këtë Marrëveshje.

Neni 4.03 Të Drejtat e Barrëmarrësve

(a) E Drejta e Dokumentacionit. Barrëmarrësit kanë të drejtë të tërheqin nga Regjistri i Barrëve Siguruese, kartelën e Kolateralit, si dhe çdo dokument tjetër që lidhet me Kolateralin mbi të cilën është vendosur Barrë Siguruese në favor të Barrëmarrësve në bazë të kësaj Marrëveshje (si vërtetime mbi gjendjen juridike etj.).

(b) E Drejta e Informacionit. Barrëmarrësit kanë të drejtë të marrin të gjitha informacionet dhe dokumentacionin që në gjykimin e tyre është i dëshirueshëm dhe/ose të nevojshëm në lidhje me Kolateralin, që të sigurohen për zbatimin e të drejtave të tyre në bazë të kësaj Marrëveshjeje.

(c) Ushtrimi i të Drejtave të Barrëmarrësve. Në qoftë se Barrëdhënësi ndodhet në rrethanat e një Rasti Mospërmbushje, nëpërmjet Përfaqësuesit të Palëve Financuese, Barrëmarrësit kanë të drejtë të ushtrojnë të gjitha të drejtat që i lindin atyre në bazë të dispozitave të përshkruara te Neni 5.04 (*Pasojat e Mospërmbushjes*) i kësaj Marrëveshjeje, pa pasur nevojën e ndonjë miratimi, autorizimi apo veprimi tjetër të Barrëdhënësit.

(d) Shpenzimet. Çdo shpenzim gjyqësor ose jashtëgjyqësor që bëjnë Barrëmarrësit lidhur me këtë Marrëveshje, do të jetë në ngarkim të Barrëdhënësit dhe sigurohet edhe nga Kolaterali.

Neni 4.04 Detyrimet e Barrëmarrësve

(a) Posedimi i Lirë nga Barrëdhënësi. Barrëmarrësit nuk do të cënojnë Barrëdhënësin në posedimin e tij mbi Kolateralin, përveç kur parashikohet ndryshe në këtë Marrëveshje.

(b) Respektimi i të Drejtave. Barrëmarrësit do të respektojnë të drejtat e Barrëdhënësit bazuar në dispozitat e kësaj Marrëveshje dhe në dispozitat e Legjislacionit të Zbatueshëm.

(c) Të Dhënat Personale. Barrëmarrësit garantojnë se përpunimi i të dhënave të Barrëdhënësit do të menaxhohet nga stafi teknik i zyrës përgjegjëse për trajtimin e të dhënave personale dhe do të bëhet në përputhje me mënyrat e parashikuara nga Ligji Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

KREU 5. DEKLARIMET DHE GARANCITË

Neni 5.01 Deklarimet dhe Garancitë e Palëve

Palët deklarojnë dhe garantojnë se në Datën e Nënshkrimit dhe në datën e secilit nga Disbursimet:

(a) Themelimi dhe Mbarëvajtja. Palët janë themeluar, vazhdojnë të ekzistojnë, kanë tagër dhe autoritet të plotë juridik, nuk kanë hyrë në procedurë falimentimi, si dhe kanë përmbushur detyrimet ligjore në përputhje me Legjislacionin e Zbatueshëm. Palët zotërojnë të gjitha licensat, lejet, autorizimet dhe aprovimet e nevojshme që i duhen që të ushtrojnë veprimtarinë e tyre siç po e ushtrojnë, përveç atyre licensave, lejeve, autorizimeve dhe aprovimeve, mungesa e të cilave, veç e veç apo në tërësi, nuk kanë pasur dhe nuk pritet që në mënyrë të arsyeshme të kenë një Ndryshim Përkeqësues Thelbësor në aftësinë për të përmbushur detyrimet e tyre sipas kësaj Marrëveshjeje.

(b) Autoriteti; Nënshkrimi dhe Dorëzimi; Zbatimi. Secila nga Palët ka tagër dhe autoritet të plotë juridik për të nënshkruar këtë Marrëveshje dhe për të kryer transaksionet e përmendura në të. Nënshkrimi i Marrëveshjes, dorëzimi i saj i nënshkruar Palës tjetër si dhe kryerja e transaksioneve të përmendura në këtë Marrëveshje, janë të autorizuara në mënyrë të rregullt nga të gjitha aktet e nevojshme të secilës prej Palëve. Secila nga Palët e ka nënshkruar dhe ia ka dorëzuar Palës tjetër këtë Marrëveshje të nënshkruar sipas rregullave dhe kjo Marrëveshje përbën detyrim të vlefshëm, të ligjshëm, të detyrueshëm dhe të zbatueshëm të secilës Palë në përputhje me kushtet dhe detyrimet që përmban Marrëveshja dhe Legjislacioni i Zbatueshëm.

(c) Mungesa e Konflikteve apo Nevojës për Miratime. Nënshkrimi i kësaj Marrëveshjeje nga secila nga Palët, si edhe kryerja e transaksioneve të përmendura në të dhe zbatimi i kushteve dhe detyrimeve të saj nuk shkaktojnë ndonjë shkelje, apo nuk shkaktojnë nevojën që të ushtrohet e drejta për të përfunduar, anuluar, apo për të përshpejtuar plotësimin e ndonjë detyrimi, nuk sjellin humbje të përfitimeve materiale, apo nuk rezultojnë në krijimin e ndonjë Barre mbi Kolateralin, përveç Barrës Siguruese të parashikuar sipas kësaj Marrëveshje, për shkak të konfliktit me ndonjë dispozitë të (i) marrëveshjeve, licensave apo çfarëdo prej angazhimeve të tjera të detyrueshme ligjore ku secila nga Palët është palë, (ii) ndonjë urdhër administrativ apo vendim gjykate (në vijim "**Gjykim**") ose (iii) Legjislacionin e Zbatueshëm. Secilës nga Palët nuk i kërkohet të marrë, apo të aplikojë për të marrë, ndonjë miratim, leje, aprovim, licencë, urdhër, apo autorizim nga ndonjë Entiteti Qeveritar lidhur me nënshkrimin, dorëzimin si dhe përmbushjen e detyrimeve të kësaj Marrëveshje, përveç atyre aprovimeve apo autorizimeve që janë specifikuar shprehimisht në këtë Marrëveshje.

(d) Vërtetësia e Deklarimeve. As kjo Marrëveshje dhe as ndonjë deklaratë, raport, ose dokument i shkruar, i përgatitur dhe i paraqitur, ose që duhet përgatitur dhe paraqitur nga secila nga Palët, sipas kësaj Marrëveshjeje ose në lidhje me transaksionet e kryera si pasojë e saj, nuk përmban ndonjë deklarim, apo nuk lë pa përmendur fakte materiale të domosdoshme, prania ose mungesa e të cilave do t'i bënte këto deklarata, raporte apo dokumenta të pasakta apo të pavërteta.

(e) Nuk ka dijeni për Deklarata të Pasakta. Secila nga Palët nuk ka dijeni që ndonjë nga deklarimet, garancitë apo premtimet e bëra nga vetë Pala apo nga Pala tjetër në këtë Marrëveshje mund të mos jenë të vërteta apo të sakta.

(f) Mungesa e Shkakut që Sjell Pavlefshmërinë. Secila nga Palët nuk ka dijeni për ndonjë shkak që mund të sjellë pavlefshmërinë e Marrëveshjes apo ndonjë neni të saj.

(g) Mungesa e Konflikteve. Secila nga Palët deklaron se në dijeninë e saj nuk ka asnjë Gjykim, veprim, procedurë apo hetim në ndonjë gjykatë apo institucion tjetër (i) që mund ta ndalojë atë të nënshkruajë këtë Marrëveshje, (ii) që ka qëllim ndalimin e kryerjes së veprimeve që janë objekt i kësaj Marrëveshje, ose (iii) që mund të ndalojë apo që mund të ndikojë thelbësisht dhe negativisht në përmbushjen e detyrimeve të një Pale sipas kësaj Marrëveshjeje, ose vlefshmërinë dhe zbatueshmërinë e saj.

Neni 5.02 Deklarimet dhe Garancitë e Barrëdhënësit

Barrëdhënësi deklaron dhe garanton se në Datën e Nënshkrimit dhe në datën e secilit nga Disbursimet:

(a) Pronar me të Drejta të Plota. Barrëdhënësi është pronar me të drejta të plota mbi Kolateralin dhe ka të drejtë ta përdorë Kolateralin si Garanci duke vendosur Barrë Siguruese mbi të.

(b) Radhë e Parë. Të drejtat e Barrëmarrësve mbi Kolateralin mbizotërojnë mbi të drejtat e çdo kreditori tjetër të Barrëdhënësit.

(c) Kolaterali i Lirë nga Barrët. Barrëmarrësit do të mbajnë Kolateralin të lirë nga çdo Barrë (me përjashtim të atyre për të cilat Barrëmarrësit kanë dhënë pëlqimin me shkrim, përfshirë Barrën Siguruese sipas kësaj Marrëveshjeje).

Neni 5.03 Rastet e Mospërmbushjes

Krahas Rasteve të Mospërmbushjes të parashikuara si të tilla në Kontratën e Kredisë, do të konsiderohen si Rast Mospërmbushje edhe rastet si më poshtë vijon:

(a) Shkelje e Deklaratave dhe Garancive. Barrëdhënësi është në shkelje të një apo të gjitha deklarimeve dhe garancive të bëra, por pa u kufizuar te Neni 5.01 (*Deklarimet dhe Garancitë e Palëve*) dhe Neni 5.02 (*Deklarimet dhe Garancitë e Barrëdhënësit*) të kësaj Marrëveshjeje, apo ndonjë prej këtyre deklarimeve dhe garancive rezultojnë të jenë të pasakta dhe të paplota.

(b) Mosrespektim i Detyrimeve. Barrëdhënësi nuk respekton parashikimet te Neni 4.02 (*Detyrimet e Barrëdhënësit*) të kësaj Marrëveshjeje, për çfarëdolloj arsyeje, përfshirë, pa u kufizuar në, për shkak të një Gjykimi.

(c) Pretendime nga Persona të Tjerë. Një Person tjetër ka një Pretendim mbi Kolateralin dhe ndërmerr hapa që mund të sjellin një Ndryshim Përkeqësues Thelbësor.

(d) Gjykim mbi Palët Garantuese. Nëse ka një Gjykim mbi Palët Garantuese që mund të sjellë një Ndryshim Përkeqësues Thelbësor.

(e) Zgjidhja e Kontratës së Kredisë. Kredidhënësit kanë vendosur zgjidhjen e Kontratës së Kredisë të lidhur me Kredimarrësin dhe Palëve Garantuese për shkaqe që lidhen me shkelje të saj nga Palët Garantuese.

(f) Rrezik. Në qoftë se, sipas mendimit të Barrëmarrësve, dhe mbi baza tregtare të arsyeshme, Barra Siguruese ose Kolaterali rrezikohen ose mund të vihen në rrezik.

(g) Mospërmbushja e Tërthortë. Nëse Kredimarrësi dhe/ose Palët Garantuese dështojnë të shlyejnë një prej Detyrimeve të parashikuara në Dokumentet e Financimit sipas parashikimeve përkatëse, kjo do të konsiderohet mospërmbushje e tyre për të gjitha Detyrimet e parashikuara në të gjitha Dokumentet e Financimit ku janë palë, përfshirë, pa u kufizuar, këtë Marrëveshje.

Neni 5.04 Pasojat e Mospërmbushjes

Në rrethanat e një Rasti Mospërmbushjeje, Përfaqësuesi i Palëve Financuese, në emër të Barrëmarrësve, mund të ushtrojë secilën nga të drejtat si më poshtë, veç e veç apo së bashku:

(a) E Drejta e Përfitimit të Dividendëve. Barrëdhënësi jep shprehimisht pëlqimin se, me ndodhjen e një Rasti Mospërmbushjeje dhe marrjen e një njoftimi nga Përfaqësuesi i Palëve Financuese, Barrëmarrësit do të kenë të drejtë - pa asnjë miratim, autorizim, urdhër ekzekutimi, Gjykim, apo veprim tjetër - të përftojnë të gjithë të ardhurat dhe përfitimet që rrjedhin nga Kolaterali, përfshirë, pa u kufizuar, Të Drejtat e Lidhura, dhe çdo shumë të arkëtueshme tjetër që lidhet me Kolateralin dhe, në vijim të kreditojë të ardhurat neto kundrejt Detyrimeve. Nga data e marrjes së njoftimit të sipërpërmendur Barrëdhënësi zotohet të mos kryejë asnjë pagesë për dividendë, si dhe çdo shumë tjetër të paguar ose të pagueshme në lidhje me Kuotat, pa miratimin e Barrëmarrësve.

(b) Ushtrimi i Kontrollit në Rast Mospërmbushje. Kur ndodh një Rast Mospërmbushjeje, Përfaqësuesi i Palëve Financuese mund të ushtrojë të drejtën për kontrollin efektiv të Barrëdhënësit në përputhje me Nenin 6.03 (*Ushtrimi i Kontrollit mbi Kredimarrësin*) të Marrëveshjes së Drejtpërdrejtë.

(c) E Drejta për Sekuestrimin dhe Shitblerjen e Kolateralit. Kur ndodh një Rast Mospërmbushjeje, Barrëmarrësit, pa paragjykuar të drejtat e tjera që ata kanë sipas kësaj Marrëveshjeje apo marrëveshjeve të tjera që palët kanë nënshkruar dhe/ose Legjislacionit të Zbatueshëm, gëzojnë të drejtën për sekuestrimin e Kolateralit dhe shitblerjen e tij sipas parashikimeve te KREU 6 (*Ekzekutimi i Kolateralit*) i kësaj Marrëveshjeje.

(d) Maturimi i Përshpejtuar. Kur ndodh një Rast Mospërmbushje, nga çasti i ngjarjes së kësaj rrethane mospërmbushje dhe në çdo kohë më pas, Përfaqësuesi i Palëve Financuese (i) ka të drejtë të kërkojë pagimin e një pjese apo të gjithë Detyrimeve kundrejt Kreditorëve brenda 10 Ditësh Pune nga njoftimi i bërë për këtë qëllim, pavarësisht nëse këto Detyrime janë maturuar ose jo dhe/ose (ii) zgjidhjen e njëanshme të kësaj Marrëveshjeje.

KREU 6. EKZEKUTIMI I KOLATERALIT

Neni 6.01 Njoftimi për Ekzekutim.

Në kushtet e një Rasti Mospërmbushjeje, Përfaqësuesi i Palëve Financuese do të njoftojë Barrëdhënësin që planifikon të fillojë procedurat e ekzekutimit të detyrueshëm për Kolateralin. Ky njoftim do të bëhet brenda 10 (dhjetë) Ditëve Pune nga marrja dijeni për Rastin e Mospërmbushjes.

Neni 6.02 Marrëveshja si Titull Ekzekutiv

Palët pranojnë dhe njohin se kjo Marrëveshje përbën titull ekzekutiv në bazë të Nenit 31 të Ligjit për Barrët Siguruese dhe Legjislacionit të Zbatueshëm. Në Rast Mospërmbushjeje kjo Marrëveshje ekzekutohet nga përmbaruesi gjyqësor me urdhër të gjykatës kompetente.

Neni 6.03 Ekzekutim i Detyrueshëm.

Në rast të fillimit nga ana e Barrëmarrësve të procedurave të ekzekutimit të detyrueshëm për pagimin e Detyrimeve sipas gjykimit dhe diskrecionit të vetëm të Kredidhënësve, Kolaterali do t'i nënshtrohet procesit të ekzekutimit të detyrueshëm, pavarësisht nëse kanë filluar ose jo procedurat përmbarimore edhe mbi pasuritë e tjera të luajtshme apo të paluajtshme të Palëve Garantuese, ose mbi pasuri të tjera të vendosura në hipotekë apo në barrë siguruese në favor të Barrëmarrësve si Garanci për shlyerjen e Detyrimeve.

Neni 6.04 Shitja e Kolateralit

(a) Shitja e Kolateralit. Njoftimi mund të përfshijë faktin se Kolaterali mund të shitet pjesërisht ose tërësisht, në përputhje me parashikimet në Legjislacionin e Zbatueshëm.

(b) Personi i Përshtatshëm si Blerës. Palët bien dakord që, në përputhje me Nenin 6.06 (*Transferimi i Kuotave të Kredimarrësit te Personi i Përshtatshëm*) të Marrëveshjes së Drejtpërdrejtë, Barrëdhënësi do t'ia transferojë Kolateralin Personit të Përshtatshëm, nëse i kërkohet nga Përfaqësuesi i Palëve Financuese.

(c) Kredidhënësit si Blerës. Palët bien dakord që Barrëmarrësit mund ta blejnë Kolateralin ose një pjesë të tij sipas parashikimeve në Legjislacionin e Zbatueshëm për ekzekutimet e detyrueshme.

Neni 6.05 Përdorimi i të Ardhurave

Kur ndodh një Rast Mospërmbushje, Barrëdhënësi autorizon shprehimisht dhe në mënyrë të parevokueshme Barrëmarrësit që, në përputhje me Nenin 30 të Ligjit Për Barrët Siguruese, pa patur nevojë për miratim apo njoftim shtesë [përveç atij të përshkruar te Neni 6.01 (*Njoftimi për Ekzekutim*) i kësaj Marrëveshjeje], të paguajnë në rrugë jashtëgjyqësore, dhe të ndërmarrin të gjitha veprimet e nevojshme apo të dëshirueshme në lidhje me ripagimin e Detyrimeve dhe të gjitha shpenzimeve, qofshin gjyqësore ose jo, në përputhje me Legjislacionin e Zbatueshëm, duke i mbajtur nga fondet e krijuara nga shitja e Kuotave apo përfitimi i të drejtave të arkëtueshme.

KREU 7. DËMSHPËRBLIMI

Neni 7.01 Dëmshpërblimi

Në përputhje me dispozitat e kësaj Marrëveshjeje, secila nga Palët (në cilësinë e saj si palë zhdëmtuese, në vijim "**Pala Dëmshpërblyese**") pranon të dëmshpërblejë Palën tjetër (në cilësinë e saj si palë e dëmshpërblyer, në vijim "**Pala e Dëmshpërblyer**") dhe ta mbrojë atë nga çdo Dëm i shkaktuar, drejtpërdrejt apo tërthorazi, që bazohet në, lind nga, apo rrjedh prej, pa u kufizuar në, mospërmbushjen nga Pala Dëmshpërblyese të detyrimeve, deklarimeve, garancive, kushteve apo të premtimeve të parashikuara në këtë Marrëveshje, me kusht që, në rastin e Barrëmarrësve, mospërmbushjet vijnë si rezultat i një pakujdesie të rëndë apo dashjes. Në të gjitha rastet, Barrëdhënësi bie dakord që përgjegjësia e mundshme e Barrëmarrësve është e pjesëtueshme dhe jo solidare.

Neni 7.02 Pretendime nga Palë të Treta

a) Mbrojtje nga Pala Dëmshpërblyese. Menjëherë pas (i) marrjes dijeni të ndonjë fakti, ndodhie ose ngjarjeje që mund të rezultojë në një Pretendim në bazë të kësaj Marrëveshjeje, ose (ii) marrjes së një njoftimi për ndonjë Pretendim nga një Person palë e tretë ndaj Palës së Dëmshpërblyer, Pala e Dëmshpërblyer do të njoftojë me shkrim Palën Dëmshpërblyese për natyrën dhe bazën e Pretendimit. Pala Dëmshpërblyese ka të drejtë të bëjë mbrojtjen nga Pretendimi me shpenzimet e saj dhe duke përzgjedhur këshilltarët e saj, të cilët duhet të jenë të pranueshëm dhe për Palën e Dëmshpërblyer, me kusht që (x) brenda 30 ditëve pas marrjes së njoftimit nga Pala e Dëmshpërblyer, Pala Dëmshpërblyese e njofton Palën e Dëmshpërblyer që do ta bëjë këtë mbrojtje, dhe (y) Pala Dëmshpërblyese nuk mund të nënshkruajë ndonjë marrëveshje pajtimi me palën pretenduese pa miratimin e Palës së Dëmshpërblyer.

b) Mbrojtje nga Pala e Dëmshpërblyer. Në rast se Pala Dëmshpërblyese refuzon të marrë përsipër mbrojtjen ndaj Pretendimit (i) Pala e Dëmshpërblyer do të mbrohet vetë kundër Pretendimit dhe (ii) Pala Dëmshpërblyese do të mbetet përgjegjëse për çdo Dëm të drejtpërdrejtë apo të tërthortë që mund t'i vijë Palës së Dëmshpërblyer si rezultat i Pretendimit. Pavarësisht se cila Palë do të marrë përsipër mbrojtjen ndaj Pretendimit, secila Palë do t'i vendosë në dispozicion Palës tjetër, pas kërkesës së saj, të gjitha informacionet dhe dokumentacionin e arsyeshëm dhe të nevojshëm për të mbështetur procesin e mbrojtjes ndaj Pretendimit, si dhe për të verifikuar çdo Dëm që shkaktohet nga Pretendimi.

KREU 8. HYRJA NË FUQI DHE PËRFUNDIMI I MARRËVESHJES

Neni 8.01 Hyrja në Fuqi e Marrëveshjes

Çdo veprim i parashikuar në këtë Marrëveshje, si dhe çdo veprim i nevojshëm apo i dobishëm për të ekzekutuar këtë Marrëveshje, që duhet të kryhet nga Marrësit e Kolateralit, mund të kryhet edhe nga Përfaqësuesi i Palëve Financuese në emër dhe për llogari të gjithë Marrësve të Kolateralit.

Neni 3.03 Komunikimet me Përfaqësuesin e Palëve Financuese

Për zbatimin e kësaj Marrëveshjeje, Dhënësi i Kolateralit do të komunikojë me Përfaqësuesin e Palëve Financuese.

Neni 3.04 Veprimet me Efekt të Njëjtë

Çdo veprim që Dhënësi i Kolateralit kryen kundrejt Përfaqësuesit të Palëve Financuese, do të konsiderohet se ka efekt të njëjtë kundrejt Marrësve të tjerë të Kolateralit, dhe çdo veprim që Përfaqësuesi i Palëve Financuese kryen kundrejt Dhënësit të Kolateralit, do të konsiderohet se është bërë nga tërë Marrësit e Kolateralit bashkërisht.

KREU 4. TË DREJTAT DHE DETYRIMET E PALËVE

Neni 4.01 Të Drejtat e Dhënësit të Kolateralit

Gjatë gjithë kohëzgjatjes së kësaj Marrëveshjeje dhe derisa nuk është dërguar një njoftim për Rast Mospërmbushje, Dhënësi i Kolateralit gëzon të gjitha Të Drejtat e Lidhura me Kolateralin Financiar që bazohen në Legjislacionin e Zbatueshëm.

Neni 4.02 Detyrimet e Dhënësit të Kolateralit

Dhënësi i Kolateralit zotohet që gjatë kohëzgjatjes së kësaj Marrëveshjeje:

(a) Regjistrimi i Kolateralit Financiar. Regjistrimi pranë Regjistrit të Barrëve Siguruese do të kryhet nga Dhënësi i Kolateralit me shpenzimet e veta, brenda një afati të arsyeshëm me të cilin Marrësit e Kolateralit janë dakord, përveç kur Marrësit e Kolateralit vendosin ndryshe. Kur ky regjistrim kryhet nga Dhënësi i Kolateralit, ky i fundit do t'i dorëzojë Përfaqësuesit të Palëve Financuese dokumentin zyrtar që vërteton regjistrimin ose një deklaratë në formë dhe përmbajtje të pranueshme nga Marrësit e Kolateralit në lidhje me kryerjen e regjistrimeve sa më sipër. Nëse Dhënësi i Kolateralit nuk kryen regjistrimin sipas kushteve të vendosura nga Marrësit e

Kolateralit, ose nëse Marrësit e Kolateralit me diskrecionin e tyre të lirë vendosin që ta kryejnë vetë regjistrimin ose nëpërmjet ekspertëve të jashtëm të zgjedhur nga ata, Dhënësi i Kolateralit nuk çlirohet nga detyrimi për të mbuluar shpenzimet për kryerjen e regjistrimit. Shpenzimet për këtë regjistrim, do të mbulohen në çdo rast nga Dhënësi i Kolateralit, sa më shpejt të jetë e mundur pas kërkesës së Përfaqësuesit të Palëve Financuese. Dhënësi i Kolateralit detyrohet të kryejë regjistrimet përkatëse edhe në Qendrën Kombëtare të Biznesit me shpenzimet e veta dhe brenda afateve ligjore.

(b) Dhënie Informacioni. Me kërkesë të Përfaqësuesit të Palëve Financuese, do të japë me shkrim çdo informacion që mund t'i kërkohet në lidhje me Kolateralin Financiar.

(c) Veprime të Tjera. Me kërkesë të Përfaqësuesit të Palëve Financuese, Dhënësi i Kolateralit do të kryejë të gjitha veprimet e nevojshme si dhe do të firmosë çdo dokument apo akt, me qëllim që të ruajë të pacënuar regjistrimin e kolateralit financiar të krijuar në bazë të kësaj Marrëveshjeje në favor të Marrësve të Kolateralit dhe në përgjithësi t'i japë efekt të plotë të gjitha të drejtave që kjo Marrëveshje u jep Marrësve të Kolateralit, përfshirë, pa kufizim:

(1) kompletimin dhe mbajtjen në fuqi të plotë të kolateralit financiar mbi Kolateralin Financiar;

(2) vendosjen e Kolateralit Financiar në favor të Marrësve të Kolateralit mbi të gjitha kuotat e ardhshme dhe Të Drejtat e Lidhura me to të nënshkruara nga Dhënësi i Kolateralit;

(3) t'i mundësojë Marrësve të Kolateralit të ushtrojnë të drejtat dhe mjetet juridike që ai ka të drejtë në përputhje me këtë Marrëveshje, duke përfshirë, pa kufizime, të gjitha të drejat dhe mjetet juridike të ushtrueshme pas ndodhjes së një Rasti Mospërmbushjeje; dhe/ose

(4) të ndryshojë statutin e Dhënësit të Kolateralit dhe/ose Kredimarrësit për të reflektuar sa më mirë të drejtat e Marrësve të Kolateralit në bazë të kësaj Marrëveshjeje.

(d) Kolaterali Financiar i Lirë nga Barrët. Dhënësi i Kolateralit do të mbajë Kolateralin Financiar të lirë nga çdo Barrë (me përjashtim të atyre për të cilat Marrësit e Kolateralit kanë dhënë pëlqimin me shkrim, përfshirë kolateralin financiar sipas kësaj Marrëveshjeje).

(e) Ndalime të Ndryshme. Dhënësi i Kolateralit nuk do të kryejë asnjë veprim material apo juridik, Barrësimi, disponimi ndarje, bashkimi, përthithje, shndërrimi, pjesëtimi, transferimi, tjetërsimi apo cedimi të drejtave mbi Kolateralin Financiar ose çdo të Drejte të Lidhur me të (përfshirë këtu asetet dhe/ ose aktivitetin e shoqërisë dhe/ose zmadhimin e kapitalit që mund të ndikojë në zvogëlimin e pjesëmarrjes së Marrësve të Kolateralit në kapital) në asnjë lloj forme apo mënyre, pa miratim e mëparshëm me shkrim të Marrësve të Kolateralit.

(f) Pretendimet apo të Metat. Do të njoftojë menjëherë Përfaqësuesin e Palëve Financuese në rast se ka apo vihet në dijeni të një Pretendimi kundrejt Kolateralit Financiar apo/dhe nëse një masë kufizimi vendoset mbi Kolateralin Financiar, apo/dhe apo një e metë

materiale apo juridike mund të cenojë të drejtën e kolateralit financiar të Marrësve të Kolateralit. Dhënësi i Kolateralit do të ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme për t'i shmangur ato Pretendime, kufizime, apo të meta duke ruajtur dhe mbajtur të pacënuar regjistrimin e kësaj Marrëveshjeje në favor të Marrësve të Kolateralit.

(g) Shpenzimet e Dhënësit të Kolateralit. Dhënësi i Kolateralit nuk do të ngarkojë Marrësit e Kolateralit me asnjë nga shpenzimet për regjistrimin apo mbajtjen e pacënuar të regjistrimit të kolateralit financiar në favor të Marrësve të Kolateralit në Regjistrin e Barrëve Siguruese.

(h) Garanci per Shpenzimet. Kolaterali Financiar përveç Detyrimeve sipas Kontratës së Kredisë do të garantojë edhe pagesën apo rimbursimin e të gjitha shpenzimeve gjyqësore, shpenzimet per ekzekutimin e detyrueshëm të Detyrimeve nëpërmjet procedurave për ekzekutimin e detyrueshëm, shpërblimin e Dëmit të shkaktuar nga vonesa e ekzekutimit, shpenzimet e kryera nga Marrësit e Kolateralit për regjistrimin e kolateralit financiar në Regjistrin e Barrëve Siguruese (nëse regjistrimi është bërë nga Dhënësi i Kolateralit), shpenzimet për sigurimin e Kolateralit Financiar, komisionet bankare dhe të raportit te vlerësimit, si dhe çdo detyrim tjetër të Palëve Garantuese dhe/ose Dhënësi i Kolateralit që burojnë nga Kontrata e Kredisë dhe/ose kjo Marrëveshje dhe/ose Legjislacioni i Zbatueshëm.

(i) Zëvendësimi në Rast Cenimi. Në rast se Marrësve të Kolateralit u cenohet e drejta e Kolateralit Financiar sipas kësaj Marrëveshjeje, për çfarëdolloj arsye, në mënyrë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë, qoftë pjesërisht apo edhe tërësisht, atëherë Dhënësi i Kolateralit do të jetë i detyruar me kërkesën e Marrësve të Kolateralit, të zëvendësojë të drejtën e cënuar të Kolateralit Financiar me një Garanci shtesë të kënaqshme për Marrësit e Kolateralit si dhe brenda afatit të vendosur nga këta të fundit.

(j) Njoftime për Marrësit e Kolateralit. Dhënësi i Kolateralit do të njoftojë Marrësit e Kolateralit menjëherë për çdo informacion të rëndësishëm në lidhje me Kolateralin Financiar, përfshirë, pa u kufizuar në:

(1) çdo ndryshim në të dhënat identifikuese të Dhënësit të Kolateralit ose të shoqërisë, pjesë të kuotave të së cilës përbëjnë Kolateralin Financiar;

(2) ekzistencën e çdo fakti të pranishëm apo të mundshëm që mund të shkaktojë:

(ii) pamundësinë e likuidimit të Kolateralit Financiar;

(iii) vështirësi për ekzekutimin e të drejtave të Kredidhënësve nga Kolateralit Financiar; ose

(iv) Rast Mospërmbushjeje.

(k) Ushtrimi i të Drejtës së Votës. Gjatë gjithë kohëzgjatjes së kësaj Marrëveshjeje Dhënësi i Kolateralit do t'i ushtrojë të drejtat e votës në mënyrë të tillë që Dhënësi i Kolateralit të mos marrë asnjë vendim i cili (i) nuk do të ishte në përputhje me parashikimet e kësaj Marrëveshjeje; (ii) do të ndikonte negativisht në vlefshmërinë apo ekzekutimin e kolateralit

financiar; (iii) nuk do të ishte në përputhje ose do të ishte në kundërshtim me parashikimet në Kontratën e Kredisë; (iv) do të pengonte ushtrimin e të drejtave të Marrësve të Kolateralit të cilat lindin nga/ose në lidhje me këtë Marrëveshje.

Neni 4.03 Të Drejtat e Marrësve të Kolateralit

(a) E Drejta e Dokumentacionit. Marrësit e Kolateralit kanë të drejtë të tërheqin nga Regjistri i Barrëve Siguruese vërtetimin përkatës, si dhe çdo dokument tjetër që lidhet me Kolateralin Financiar mbi të cilën është vendosur kolateral financiar në favor të Marrësve të Kolateralit në bazë të kësaj Marrëveshjeje (si vërtetime mbi gjendjen juridike etj.).

(b) E Drejta e Informacionit. Marrësit e Kolateralit kanë të drejtë të marrin të gjitha informacionet dhe dokumentacionin që në gjykimin e tyre është i dëshirueshëm dhe/ose të nevojshëm në lidhje me Kolateralin Financiar, që të sigurohen për zbatimin e të drejtave të tyre në bazë të kësaj Marrëveshjeje.

(c) Ushtrimi i të Drejtave të Marrësve të Kolateralit. Në qoftë se Dhënësi i Kolateralit ndodhet në rrethanat e një Rasti Mospërmbushjeje, nëpërmjet Përfaqësuesit të Palëve Financuese, Marrësit e Kolateralit kanë të drejtë të ushtrojnë të gjitha të drejtat që i lindin atyre në bazë të dispozitave të përshkruara te Neni 6.02 (*Pasojat e Rastit të Mospërmbushjes*) i kësaj Marrëveshjeje, pa pasur nevojën e ndonjë miratimi, autorizimi apo veprimi tjetër të Dhënësit të Kolateralit.

(d) Shpenzimet. Çdo shpenzim gjyqësor ose jashtëgjyqësor që bëjnë Marrësit e Kolateralit lidhur me këtë Marrëveshje, do të jetë në ngarkim të Dhënësit të Kolateralit dhe sigurohet edhe nga Kolaterali Financiar.

Neni 4.04 Detyrimet e Marrësve të Kolateralit

(a) Posedimi i Lirë nga Dhënësi i Kolateralit. Marrësit e Kolateralit nuk do të cenojnë Dhënësin e Kolateralit në posedimin e tij mbi Kolateralin Financiar, përveç kur parashikohet ndryshe në këtë Marrëveshje.

(b) Respektimi i të Drejtave. Marrësit e Kolateralit do të respektojnë të drejtat e Dhënësit të Kolateralit bazuar në dispozitat e kësaj Marrëveshjeje dhe në dispozitat e Legjislacionit të Zbatueshëm.

(c) Të Dhënat Personale. Marrësit e Kolateralit garantojnë se përpunimi i të dhënave të Dhënësit të Kolateralit do të menaxhohet nga stafi teknik i zyrës përgjegjëse për trajtimin e të dhënave personale dhe do të bëhet në përputhje me mënyrat e parashikuara nga Ligji Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

KREU 5. DEKLARIMET DHE GARANCITË

Neni 5.01 Deklarimet dhe Garancitë e Palëve

Palët deklarojnë dhe garantojnë se në Datën e Nënshkrimit dhe në datën e secilit nga Disbursimet:

(a) Themelimi dhe Mbarëvajtja. Palët janë themeluar, vazhdojnë të ekzistojnë, kanë tagër dhe autoritet të plotë juridik, nuk kanë hyrë në procedurë falimentimi, si dhe kanë përmbushur detyrimet ligjore në përputhje me Legjislacionin e Zbatueshëm. Palët zotërojnë të gjitha licensat, lejet, autorizimet dhe aprovimet e nevojshme që i duhen që të ushtrojnë veprimtarinë e tyre siç po e ushtrojnë, përveç atyre licensave, lejeve, autorizimeve dhe aprovimeve, mungesa e të cilave, veç e veç apo në tërësi, nuk kanë pasur dhe nuk pritet që në mënyrë të arsyeshme të kenë një Ndryshim Përkeqësues Thelbësor në aftësinë për të përmbushur detyrimet e tyre sipas kësaj Marrëveshjeje.

(b) Autoriteti; Nënshkrimi dhe Dorëzimi; Zbatimi. Secila nga Palët ka tagër dhe autoritet të plotë juridik për të nënshkruar këtë Marrëveshje dhe për të kryer transaksionet e përmendura në të. Nënshkrimi i Marrëveshjes, dorëzimi i saj i nënshkruar Palës tjetër si dhe kryerja e transaksioneve të përmendura në këtë Marrëveshje, janë të autorizuara në mënyrë të rregullt nga të gjitha aktet e nevojshme të secilës prej Palëve. Secila nga Palët e ka nënshkruar dhe ia ka dorëzuar Palës tjetër këtë Marrëveshje të nënshkruar sipas rregullave dhe kjo Marrëveshje përbën detyrim të vlefshëm, të ligjshëm, të detyrueshëm dhe të zbatueshëm të secilës Palë në përputhje me kushtet dhe detyrimet që përmban Marrëveshja dhe Legjislacioni i Zbatueshëm.

(c) Mungesa e Konflikteve apo Nevojës për Miratime. Përveç parashikimeve të paragrafit Neni 5.01(h) (*Alternativë e Pavarur*) më poshtë, nënshkrimi i kësaj Marrëveshjeje nga secila nga Palët, si edhe kryerja e transaksioneve të përmendura në të dhe zbatimi i kushteve dhe detyrimeve të saj nuk shkaktojnë ndonjë shkelje, apo nuk shkaktojnë nevojën që të ushtrohet e drejta për të përfunduar, anuluar, apo për të përshpejtuar plotësimin e ndonjë detyrimi, nuk sjellin humbje të përfitimeve materiale, apo nuk rezultojnë në krijimin e ndonjë Barre mbi Kolateralin Financiar, përveç Barrës të parashikuar sipas kësaj Marrëveshjeje, për shkak të konfliktit me ndonjë dispozitë të (i) marrëveshjeve, licensave apo çfarëdo prej angazhimeve të tjera të detyrueshme ligjore ku secila nga Palët është palë, (ii) ndonjë urdhër administrativ apo vendim gjykate (në vijim "**Gjykim**") ose (iii) Legjislacionin e Zbatueshëm. Secilës nga Palët nuk i kërkohet të marrë, apo të aplikojë për të marrë, ndonjë miratim, leje, aprovim, licencë, urdhër, apo autorizim nga ndonjë Entiteti Qeveritar lidhur me nënshkrimin, dorëzimin si dhe përmbushjen e detyrimeve të kësaj Marrëveshjeje, përveç atyre aprovimeve apo autorizimeve që janë specifikuar shprehimisht në këtë Marrëveshje.

(d) Vërtetësia e Deklarimeve. As kjo Marrëveshje dhe as ndonjë deklaratë, raport, ose dokument i shkruar, i përgatitur dhe i paraqitur, ose që duhet përgatitur dhe paraqitur nga secila nga Palët, sipas kësaj Marrëveshjeje ose në lidhje me transaksionet e kryera si pasojë e saj, nuk përmban ndonjë deklarim, apo nuk lë pa përmendur fakte materiale të domosdoshme, prania ose mungesa e të cilave do t'i bënte këto deklarata, raporte apo dokumenta të pasakta apo të pavërteta.

(e) Nuk ka dijeni për Deklarata të Pasakta. Secila nga Palët nuk ka dijeni që ndonjë nga deklarimet, garancitë apo premtimet e bëra nga vetë Pala apo nga Pala tjetër në këtë Marrëveshje mund të mos jenë të vërteta apo të sakta.

(f) Mungesa e Shkakut që Sjell Pavlefshmërinë. Secila nga Palët nuk ka dijeni për ndonjë shkak që mund të sjellë pavlefshmërinë e Marrëveshjes apo ndonjë neni të saj.

(g) Mungesa e Konflikteve. Secila nga Palët deklaron se në dijeninë e saj nuk ka asnjë Gjykim, veprim, procedurë apo hetim në ndonjë gjykatë apo institucion tjetër (i) që mund ta ndalojë atë të nënshkruajë këtë Marrëveshje, (ii) që ka qëllim ndalimin e kryerjes së veprimeve që janë objekt i kësaj Marrëveshje, ose (iii) që mund të ndalojë apo që mund të ndikojë thelbësisht dhe negativisht në përmbushjen e detyrimeve të një Pale sipas kësaj Marrëveshje, ose vlefshmërinë dhe zbatueshmërinë e saj.

(h) Alternativë e Pavarur. Palët deklarojnë dhe bien dakord që, megjithëse në Datën e Nënshkrimit ato kanë nënshkuar dy Marrëveshje, një Kontratë Pengu dhe nje Marrëveshje Siguruese me anë të së cilave Dhënësi i Kolateralit i ka dhënë Marrësve të Kolateralit një Barrë mbi Kuotat, ekzistenca e asaj marrëveshjeje nuk përbën shkelje të dispozitave të kësaj Marrëveshjeje. Për më tepër, Dhënësi i Kolateralit kupton dhe bie dakord që, nëse do të ndodhë një Rast Mospërmbushje, është krejtësisht në diskrecionin e lirë e të vetëm të Përfaqësuesit të Palëve Financuese që të zgjedhë se si do ti ekzekutojë të drejtat e Marrësve të Kolateralit mbi Kuotat, nëpërmjet kësaj Marrëveshjeje apo nëpërmjet Marrëveshjes Siguruese.

Neni 5.02 Deklarimet dhe Garancitë e Dhënësit të Kolateralit

Dhënësi i Kolateralit deklaron dhe garanton se në Datën e Nënshkrimit dhe në datën e secilit nga Disbursimet:

(a) Pronar me të Drejta të Plota. Dhënësi i Kolateralit është pronar me të drejta të plota mbi Kolateralin Financiar dhe ka të drejtë ta përdorë Kolateralin Financiar si Garanci duke vendosur kolateral financiar mbi të.

(b) Radhë e Parë. Të drejtat e Marrësve të Kolateralit mbi Kolateralin Financiar mbizotërojnë mbi të drejtat e çdo kreditori tjetër të Dhënësit të Kolateralit.

(c) Kolaterali Financiar i Lirë nga Barrët. Dhënësi i Kolateralit do të mbajë Kolateralin Financiar të lirë nga çdo Barrë (me përjashtim të atyre për të cilat Marrësit e Kolateralit kanë dhënë pëlqimin me shkrim, përfshirë kolateralin financiar sipas kësaj Marrëveshjeje).

(d) Shtrirja e Kolateralit Financiar. Dhënësi i Kolateralit garanton se në përputhje me paragrafin e dytë të Nenit 24 të Ligjit për Sistemin e Pagesave, Kolaterali Financiar siguron të gjitha llojet e detyrimeve financiare, përfshirë ato të tanishme ose të ardhme, ato aktuale ose të kushtëzuara apo të mundshme, që Dhënësi i Kolateralit i detyrohet Marrësve të Kolateralit.

(e) Kontrolli. Pranon dhe bie dakord se kjo Marrëveshje përbën "kontroll" në kuptimin e Nenit 25.b.ii të Ligjit për Sistemin e Pagesave dhe nënshkrimi i saj është dëshmi e vlefshmërisë së kolateralit financiar mbi Kolateralin Financiar.

KREU 6. RASTET E MOSPËRMBUSHJES

Neni 6.01 Rastet e Mospërmbushjes

Krahas Rasteve të Mospërmbushjes të parashikuara si të tilla në Kontratën e Kredisë, do të konsiderohen si Rast Mospërmbushjeje edhe rastet si më poshtë vijon:

(a) Shkelje e Deklaratave dhe Garancive. Dhënësi i Kolateralit është në shkelje të një apo të gjitha deklarimeve dhe garancive të bëra, por pa u kufizuar te Neni 5.01 (*Deklarimet dhe Garancitë e Palëve*) dhe Neni 5.02 (*Deklarimet dhe Garancitë e Dhënësit të Kolateralit*) të kësaj Marrëveshjeje, apo ndonjë prej këtyre deklarimeve dhe garancive rezultojnë të jenë të pasakta dhe të paplota.

(b) Mosrespektim i Detyrimeve. Dhënësi i Kolateralit nuk respekton parashikimet te Neni 4.02 (*Detyrimet e Dhënësit të Kolateralit*) i kësaj Marrëveshjeje, për çfarëdolloj arsyeje, përfshirë, pa u kufizuar në, për shkak të një Gjykimi.

(c) Pretendime nga Persona të Tjerë. Një Person tjetër ka një Pretendim mbi Kolateralin Financiar dhe ndërmerr hapa që mund të sjellin një Ndryshim Përkeqësues Thelbësor.

(d) Gjykim mbi Palët Garantuese. Nëse ka një Gjykim mbi Palët Garantuese që mund të sjellë një Ndryshim Përkeqësues Thelbësor.

(e) Zgjidhja e Kontratës së Kredisë. Kredidhënësit kanë vendosur zgjidhjen e Kontratës së Kredisë të lidhur me Kredimarrësin dhe Palëve Garantuese për shkaqe që lidhen me shkelje të saj nga Palët Garantuese.

(f) Rrezik. Në qoftë se, sipas mendimit të Marrësve të Kolateralit, dhe mbi baza tregtare të arsyeshme, Kolaterali Financiar rrezikohet ose mund të vihet në rrezik.

(g) Mospërmbushja e Tërthortë. Nëse Palët Garantuese dështojnë të shlyejnë një prej Detyrimeve të parashikuara në Dokumentet e Financimit sipas parashikimeve përkatëse ose dështon të përmbushë ndonjë detyrim tjetër të lidhur me garantimin e Kontratës së Kredisë, kjo do të konsiderohet mospërmbushje e tyre për të gjitha Detyrimet e parashikuara në të gjitha Dokumentet e Financimit ku janë palë, përfshirë, pa u kufizuar, këtë Marrëveshje.

Neni 6.02 Pasojat e Mospërmbushjes

Në rrethanat e një Rasti Mospërmbushjeje, Përfaqësuesi i Palëve Financuese, në emër të Marrësit të Kolateralit, mund të ushtrojë secilën nga të drejtat si më poshtë, veç e veç apo së bashku:

(a) E Drejta e Përfitimit të Dividendëve. Dhënësi i Kolateralit jep shprehimisht pëlqimin se, me ndodhjen e një Rasti Mospërmbushjeje dhe marrjen e një njoftimi nga Përfaqësuesi i Palëve Financuese, Marrësit e Kolateralit do të kenë të drejtë - pa asnjë miratim, autorizim, urdhër ekzekutimi, Gjykim, apo veprim tjetër - të përftojnë të gjithë të ardhurat dhe përfitimet që rrjedhin nga Kolaterali Financiar, përfshirë, pa u kufizuar, Të Drejtat e Lidhura, dhe çdo shumë të arkëtueshme tjetër që lidhet me Kolateralin Financiar dhe, në vijim, të kreditojë të ardhurat neto kundrejt Detyrimeve. Nga data e marrjes së njoftimit të sipërpërmendur Dhënësi i Kolateralit zotohet të mos kryejë asnjë pagesë per dividendë, si dhe çdo shumë tjetër të paguar ose të pagueshme në lidhje me Kuotat, pa miratimin e Marrësve të Kolateralit.

(b) Ushtrimi i Kontrollit në Rast Mospërmbushje. Kur ndodh një Rast Mospërmbushje, Përfaqësuesi i Palëve Financuese mund të ushtrojë të drejtën për kontrollin efektiv të Dhënësit të

Kolateralit në përputhje me Nenin 6.03 (*Ushtrimi i Kontrollit mbi Kredimarrësin*) të Marrëveshjes së Drejtpërdrejtë.

(c) E Drejta për Sekuestrimin dhe Shitblerjen e Kolateralit Financiar. Kur ndodh një Rast Mospërmbushjeje, Marrësit e Kolateralit, pa paragjykuar të drejtat e tjera që ata kanë sipas kësaj Marrëveshjeje apo marrëveshjeve të tjera që palët kanë nënshkruar dhe/ose Legjislacionit të Zbatueshëm, gëzojnë të drejtën për sekuestrimin e Kolateralit Financiar dhe shitblerjen e tij sipas parashikimeve te KREU 7 (*Ekzekutimi i Kolateralit Financiar*) i kësaj Marrëveshjeje.

(d) Maturimi i Përshpejtuar. Kur ndodh një Rast Mospërmbushje, nga çasti i ngjarjes së kësaj rrethane mospërmbushje dhe në çdo kohë më pas, Përfaqësuesi i Palëve Financuese (i) ka të drejtë të kërkojë pagimin e një pjese apo të gjithë Detyrimeve kundrejt Kreditorëve, pavarësisht nëse këto Detyrime janë maturuar ose jo dhe/ose (ii) zgjidhjen e njëanshme të kësaj Marrëveshjeje.

KREU 7. EKZEKUTIMI I KOLATERALIT FINANCIAR

Neni 7.01 Ekzekutim i Menjëhershëm

Në vijim të një Rasti Mospërmbushjeje, në përputhje me Nenin 28 të Ligjit për Sistemin e Pagesave, Kolaterali Financiar i nënshtrohet ekzekutimit të menjëhershëm pa pasur nevojë për të ndjekur procedurën për ekzekutimin e detyrueshëm siç përcaktohet për mjetet e tjera të garancisë në Legjislacionin e Zbatueshëm.

Neni 7.02 Shitja ose Përvetësimi i Kolateralit Financiar

(a) Shitja ose Përvetësimi i Kolateralit Financiar. Marrësit e Kolateralit mund t'i dërgojnë njoftim Dhënësit të Kolateralit që ata do të ekzekutojnë Kolateralin Financiar. Njoftimi mund të përfshijë faktin se Kolaterali Financiar do të shitet pjesërisht ose tërësisht, në përputhje me parashikimet në Legjislacionin e Zbatueshëm.

(b) Personi i Përshtatshëm si Blerës. Palët bien dakord që, në përputhje me Nenin 6.06 (*Transferimi i Kuotave të Kredimarrësit te Personi i Përshtatshëm*) të Marrëveshjes së Drejtpërdrejtë, Dhënësi i Kolateralit do t'ia transferojë Kolateralin Financiar Personit të Përshtatshëm, nëse i kërkohet nga Përfaqësuesi i Palëve Financuese.

(c) Marrësit e Kolateralit si Blerës. Palët bien dakord që Marrësit e Kolateralit mund ta blejnë Kolateralin Financiar ose një pjesë të tij sipas parashikimeve në Legjislacionin e Zbatueshëm.

Neni 7.03 Përdorimi i të Ardhurave

Kur ndodh një Rast Mospërmbushjeje, Dhënësi i Kolateralit autorizon shprehimisht dhe në mënyrë të parevokueshme Marrësit e Kolateralit që, pa patur nevojë për miratim apo njoftim shtesë, të paguajnë në rrugë jashtëgjyqësore, dhe të ndërmarrin të gjitha veprimet e nevojshme apo të dëshirueshme në lidhje me ripagimin e Detyrimeve dhe të gjitha shpenzimeve, qofshin gjyqësore ose jo, në përputhje me Legjislacionin e Zbatueshëm, duke i mbajtur nga fondet e krijuara nga shitja e Kuotave apo përfitimi i të drejtave të arkëtueshme.

KREU 8. DËMSHPËRBLIMI

Neni 8.01 Dëmshpërblimi

Në përputhje me dispozitat e kësaj Marrëveshjeje, secila nga Palët (në cilësinë e saj si palë zhdëmtuese, në vijim "**Pala Dëmshpërblyese**") pranon të dëmshpërblejë Palën tjetër (në cilësinë e saj si palë e dëmshpërblyer, në vijim "**Pala e Dëmshpërblyer**") dhe ta mbrojë atë nga çdo Dëm i shkaktuar, drejtpërdrejt apo tërthorazi, që bazohet në, lind nga, apo rrjedh prej, pa u kufizuar në, mospërmbushjen nga Pala Dëmshpërblyese të detyrimeve, deklarimeve, garancive, kushteve apo të premtimeve të parashikuara në këtë Marrëveshje, me kusht që, në rastin e Marrësve të Kolateralit, mospërmbushjet vijnë si rezultat i një pakujdesie të rëndë apo dashjes. Në të gjitha rastet, Dhënësi i Kolateralit bie dakord që përgjegjësia e mundshme e Marrësve të Kolateralit është e pjesëtueshme dhe josolidare.

Neni 8.02 Pretendime nga Palë të Treta

(a) Mbrojtje nga Pala Dëmshpërblyese. Menjëherë pas (i) marrjes dijeni të ndonjë fakti, ndodhie ose ngjarjeje që mund të rezultojë në një Pretendim në bazë të kësaj Marrëveshjeje,ose (ii) marrjes së një njoftimi për ndonjë Pretendim nga një Person palë e tretë ndaj Palës së Dëmshpërblyer, Pala e Dëmshpërblyer do të njoftojë me shkrim Palën Dëmshpërblyese për natyrën dhe bazën e Pretendimit. Pala Dëmshpërblyese ka të drejtë të bëjë mbrojtjen nga Pretendimi me shpenzimet e saj dhe duke përzgjedhur këshilltarët e saj, të cilët duhet të jenë të pranueshëm dhe për Palën e Dëmshpërblyer, me kusht që (x) brenda 30 ditëve pas marrjes së njoftimit nga Pala e Dëmshpërblyer, Pala Dëmshpërblyese e njofton Palën e Dëmshpërblyer që do ta bëjë këtë mbrojtje, dhe (y) Pala Dëmshpërblyese nuk mund të nënshkruajë ndonjë marrëveshje pajtimi me palën pretenduese pa miratimin e Palës së Dëmshpërblyer.

(b) Mbrojtje nga Pala e Dëmshpërblyer. Në rast se Pala Dëmshpërblyese refuzon të marrë përsipër mbrojtjen ndaj Pretendimit (i) Pala e Dëmshpërblyer do të mbrohet vetë kundër Pretendimit dhe (ii) Pala Dëmshpërblyese do të mbetet përgjegjëse për çdo Dëm të drejtpërdrejtë apo të tërthortë që mund t'i vijë Palës së Dëmshpërblyer si rezultat i Pretendimit. Pavarësisht se cila Palë do të marrë përsipër mbrojtjen ndaj Pretendimit, secila Palë do t'i vendosë në dispozicion Palës tjetër, pas kërkesës së saj, të gjitha informacionet dhe dokumentacionin e arsyeshëm dhe të nevojshëm për të mbështetur procesin e mbrojtjes ndaj Pretendimit, si dhe për të verifikuar çdo Dëm që shkaktohet nga Pretendimi.

KREU 9. HYRJA NË FUQI DHE PËRFUNDIMI I MARRËVESHJES

Neni 9.01 Hyrja në Fuqi e Marrëveshjes

Kjo Marrëveshje hyn në fuqi në Datën e Nënshkrimit.

Neni 9.02 Momenti i Përfundimit të Marrëveshjes

(a) Kjo Marrëveshje do të mbetet në fuqi deri në momentin e shlyerjes së plotë të Detyrimeve kundrejt Marrësve të Kolateralit, dhe detyrimeve të tjera sipas Kontratës së Kredisë

si dhe të çdo detyrimi tjetër të lidhur me garantimin e Kredisë dhe/ose detyrimit të kësaj Marreveshjeje.

(b) Pas shlyerjes së Detyrimeve te parashikuara në paragrafin (a) më sipër, Dhënësi i Kolateralit do i drejtohet me shkrim Përfaqësuesit të Palëve Financuese duke njoftuar pagimin e plotë të tyre.

(c) Përfaqësuesi i Palëve Financuese pasi verifikon shlyerjen e Detyrimeve, brenda 10 (dhjetë) Ditësh Pune firmos dokumentat e nevojshme për fshirjen e Kolateralit Financiar nga Regjistri i Barrëve Siguruese. Heqja e regjistrimit të Kolateralit Financiar sipas këtij neni, konsiderohet dhe momenti i përfundimit të kësaj Marrëveshjeje.

Neni 9.03 Mbijetesa e Dispozitave të Marrëveshjes pas Përfundimit

Pavarësisht përfundimit të Marrëveshjes, dispozitat te Neni 8.01 (*Dëmshpërblimi*), KREU 10 (*Zgjidhja e Mosmarrëveshjeve*), Neni 11.01(b) (*Autorizimi për Përdorimin e Informacionit Konfidencial*) të kësaj Marrëveshjeje do të mbijetojnë dhe do të vazhdojnë të jenë në fuqi edhe pas përfundimit të Marrëveshjes sipas dipozitave të parashikuara te Neni 9.02 (*Momenti i Përfundimit të Marrëveshjes*).

KREU 10. ZGJIDHJA E MOSMARRËVESHJEVE

Neni 10.01 Mjetet Ligjore të Dhënësit të Kolateralit

(a) Në rast se Dhënësi i Kolateralit vlerëson se Përfaqësuesi i Palëve Financuese apo Marrësit e tjerë të Kolateralit veprojnë në shkelje të kësaj Marrëveshjeje, duhet të njoftojë menjëherë Përfaqësuesin e Palëve Financuese për këtë fakt, në formën e parashikuar te Neni 11.01(*Njoftimet*) i kësaj Marrëveshjeje.

(b) Dhënësi i Kolateralit dhe Përfaqësuesi i Palëve Financuese do të zhvillojnë bisedime me mirëkuptim për një periudhë jo më të gjatë se 30 (tridhjetë) Ditë Pune nga data e njoftimit. Në rast se Palët nuk bien dakord për ndreqjen e shkeljeve të pretenduara nga Dhënësi i Kolateralit, atëherë Dhënësi i Kolateralit ka të drejtë të ngrejë padi në gjykatën kompetente pasi afati 30 (tridhjetë) ditor i zhvillimit të bisedimeve ka përfunduar.

Neni 10.02 Mjetet Ligjore të Marrësve të Kolateralit

Në Rast Mospërmbushjeje, përveç të drejtave dhe mjeteve ligjore që parashikohen në Legjislacionin e Zbatueshëm, Përfaqësuesi i Palëve Financuese duhet të njoftojë Dhënësin e Kolateralit, i cili ka 30 Ditë Pune afat të zgjidhë mospërmbushjen, në formën e parashikuar te Neni 11.01 (*Njoftimet*) i kësaj Marrëveshjeje, përsa vijon:

(a) Duhet të paguajë të gjitha Detyrimet, duke përfshirë detyrimin e siguruar me Kolateral Financiar dhe të arkëtojë të gjithë borxhin që i detyrohet, përfshirë shpenzime të arsyeshme për kostot e gjykatës, të avokatëve dhe shpenzime të tjera ligjore; si dhe

(b) Marrësit e Kolateralit gëzojnë të drejtat e parashikuara te KREU 7 (*Ekzekutimi i Kolateralit Financiar*) i kësaj Marrëveshjeje për të siguruar përmbushjen e Detyrimeve të Dhënësit të Kolateralit.

Neni 10.03 Zgjidhja e Mosmarrëveshjeve

Palët do të përpiqen në mënyrë të arsyeshme që çdo mosmarrëveshje mes tyre të zgjidhet me mirëkuptim. Në rast se mirëkuptimi nuk mund të arrihet, secila nga Palët do t'i drejtohet Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Neni 10.04 Legjislacioni i Aplikueshëm

Kjo Marrëveshje do të zbatohet dhe do të interpretohet në përputhje me Legjislacionin e Zbatueshëm të Republikës së Shqipërisë.

KREU 11. TË NDRYSHME

Neni 11.01 Autorizime

(a) Autorizimi për Regjistrime. Dhënësi i Kolateralit autorizon Përfaqësuesin e Palëve Financuese, që në rast se e gjykon të arsyeshme, në emër të dhe me shpenzimet e Dhënësit të Kolateralit të regjistrojë formularët e njoftimit të regjistrimit dhe/ose dokumenta të tjerë në Regjistrin e Barrëve Siguruese (apo regjistra dhe regjistrarë të tjerë nëse një rregjistrim i tillë është i dëshirueshëm apo i nevojshëm) dhe të ndërmarrë të gjitha veprimet që Marrësit e Kolateralit mund të mendojnë se janë të nevojshme për të kompletuar dhe vazhduar kompletimin e Kolateralit Financiar, për të mbrojtur dhe ruajtur Kolateralin Financiar dhe për ta ekzekutuar atë.

(b) Autorizimi për Përdorimin e Informacionit Konfidencial. Në zbatim të nenit 127 të Ligjit nr. 9662, datë 18.12.2006 "Për bankat në Republikën e Shqipërisë", Vendimit nr. 67 datë 13.10.2010 "P*ër miratimin e Rregullores "Për përmbajtjen e informacionit dhe funksionimin e regjistrit te kredive në Bankën e Shqipërisë*" të miratuar nga Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë, dhe Ligjit Nr. 9887, datë 10.03.2008 "*Për mbrojtjen e të dhënave personale*", Dhënësi i Kolateralit, nëpërmjet nënshkrimit të kësaj Marrëveshjeje Kolaterali, duke pranuar se (i) të dhënat demografike dhe financiare të ruajtura në Regjistrin e Kredive të Bankës së Shqipërisë do të trajtohen nga Marrësit e Kolateralit në përputhje me Legjislacionin e Zbatueshëm, dhe (ii) Marrësit e Kolateralit, Shoqëritë Mëmë të tyre si dhe Regjistri i Kredive të Bankës së Shqipërisë kanë marrë të gjitha masat e nevojshme për të garantuar trajtimin e sigurt të të dhënave të Dhënësit të Kolateralit, autorizon në mënyrë të parevokueshme Marrësit e Kolateralit që për qëllim (ndër të tjera) të vlerësimit të përshtatshmërisë së Dhënësit të Kolateralit për të marrë përsipër dhe zbatuar detyrimet e tij në bazë të kësaj Marrëveshjeje dhe aftësisë së Marrësve të Kolateralit për të qenë në përputhje me kërkesat e ndryshme rregullatore që i aplikohen atyre:

(1) të njihet me detyrimet e Dhënësit të Kolateralit ndaj bankave/degëve të bankave të huaja/subjekteve kredidhënëse, nëpërmjet përpunimit të autorizuar të të dhënave/informacionit të Regjistrit të Kredive;

(2) të përdorin emrin dhe të dhënat identifikuese dhe financiare të Dhënësit të Kolateralit që mbahen në Regjistrin e Kredive, për kryerjen e raportimeve standarde dhe të detyrueshme në Regjistrin e Kredive të Bankës së Shqipërisë.

(3) të transferojnë dhe të trajtojnë të gjitha të dhënat personale dhe financiare të tij (më poshtë referuar si "**Informacioni Konfidencial**") me dhe tek Shoqëritë Mëmë të tyre, nëse dhe sa herë që kërkohen nga Shoqëritë Mëmë përkatëse dhe që të kenë akses, të përdorin dhe të trajtojnë Informacionin Konfidencial që Marrësit e Kolateralit zotërojnë ose marrin në zotërim nga Regjistri i Kredive të Bankës së Shqipërisë.

Neni 11.02 Transferimi, Cedimi, Zëvendësimi, Pasojat dhe mbi Pasardhësit

(a) Dhënësi i Kolateralit. Dhënësi i Kolateralit nuk mund ta transferojë, cedojë, ndryshojë apo kalojë të drejtat dhe detyrimet e kësaj Marrëveshje te asnjë Person, përveç se me parashikimet te Neni 4.02(d) (*Ndalimi për Tjetërsimin*) i kësaj Marrëveshjeje. Gjithsesi, Dhënësi i Kolateralit do të sigurohet që kolaterali financiar i vendosur mbi Kolateralin Financiar në bazë të kësaj Marrëveshje do t'i shtrijë efektet e tij edhe do të transferohet bashkë me Kolateralin Financiar dhe te pasardhësit e Dhënësit të Kolateralit, të cilët do të jenë gjithashtu të detyruar të respektojnë të drejtat e kësaj Marrëveshjeje.

(b) Marrësit e Kolateralit. Të drejtat që Marrësit e Kolateralit kanë në bazë të kësaj Marrëveshjeje janë lirisht të transferueshme dhe do kalojnë dhe te zëvendësuesit apo pasardhësit e tyre, përveç se në përputhje me Dokumentet e Financimit.

Neni 11.03 Palët e Treta nuk Përfitojnë të Drejta

Kjo Marrëveshje është lidhur vetëm mes Palëve dhe mund të zbatohet vetëm prej tyre. Kjo Marrëveshje nuk mund të interpretohet në asnjë rast se krijon të drejta për ndonjë palë të tretë, përfshirë punonjësit, agjentët, përfaqësuesit, kontraktorët, furnizuesit ose konsumatorët e një Pale. Një Person i cili nuk është Palë në këtë Marrëveshje nuk gëzon asnjë të drejtë sipas kësaj Marrëveshjeje.

Neni 11.04 Veçueshmëria e Interesave Pasurore

Dhënësi i Kolateralit bie dakord dhe pranon shprehimisht se kjo Marrëveshje është një garanci, e veçuar nga çdo Garanci tjetër që është dhënë ose do të jepet nga Palët Garantuese në favor të Marrësve të Kolateralit për sigurimin e shlyerjes së Detyrimeve. Dhënësi i Kolateralit bie dakord që Marrësit e Kolateralit mund të ushtrojnë të drejtat e tyre sipas kësaj Marrëveshjeje, pavarësisht nga të drejtat e tyre sipas ndonjë Garancie tjetër në bazë të Dokumentave të Garancisë.

Neni 11.05 Njoftimet

(a) Metoda e Njoftimit. Njoftimet dhe çdo lloj tjetër komunikimi në lidhje me këtë Marrëveshjeje do të jetë me shkrim dhe në gjuhën shqipe dhe duhet të bëhet në përputhje me këtë nen. Njoftimi do të bëhet: (i) duke e dorëzuar personalisht, me kundërfirmë; ose (ii) dërguar me postë të parapaguar me konfirmim dorëzimi nga Pala marrëse në adresën e përcaktuar në këtë

Marrëveshjeje, apo ndonjë adresë tjetër të specifikuar nga Pala përkatëse. Në shtesë të sa më lart, po pa u konsideruar njoftim, Palët do t'i dërgojnë njoftimet e tyre me e-mail (në adresën e përcaktuar më poshtë), dhe në çdo rast e adresuar qartësisht për vëmendjen e Palës përkatëse.

(b) Koha e Njoftimit. Çdo njoftim, i dërguar sipas mënyrave të mësipërme do të konsiderohet si i dorëzuar sipas rregullave dhe në kohën e specifikuar si më poshtë:

(1) Në rastin e dërgimit dorazi, kur dorëzimi kryhet te përfaqësuesit e Palës marrëse gjatë Ditës së Punës dhe dorëzimi është pranuar me shkrim nga Pala;

(2) Në rastin e njoftimit me postë të parapaguar, në mungesë të provave që njoftimi është marrë më parë, njoftimi konsiderohet i dhënë, nëse është dërguar me postë, 5 (pesë) Ditë Pune pas postimit;

(c) Adresa e Njoftimit. Adresat ku Palët mund të njoftojnë njëra-tjetrën janë si më poshtë:

(1) Drejtuar Përfaqësuesit të Palëve Financuese:

Rruga "Ibrahim Rugova",
Tiranë, Shqipëri
Në vëmendje të:
Glenda Kurti
gkurti@tiranabank.al
+355696092289
Eranda Loci
eloci@tiranabank.al
+355699107487

(2) Drejtuar Dhënësit të Kolateralit:

Rruga "Ibrahim Rugova",
Pallati Kontakt, kati 2,
Tiranë, Shqipëri
Në vëmendje të:
Florenc Gjikuria
florenc.gjikuria@gjikuria.com
+355692074000
Milo Gjikuria
milo.gjikuria@gjikuria.com
+355696092289

(d) Ndryshimi i Adresës ose Emrit. Secila Palë do ta njoftojë menjëherë Palën tjetër të kësaj Marrëveshjeje, në rast ndryshimi të të dhënave të specifikuara në këtë nen.

Neni 11.06 Forca Madhore

(a) Nuk Konsiderohet Shkelje. Vonesa në përmbushjen e detyrimeve sipas kësaj Marrëveshjeje prej njërës nga Palët nuk do të quhet shkelje ose mospërmbushje e kësaj Marrëveshjeje në rast se vjen si rrjedhojë e Forcës Madhore me kusht që (i) Pala e prekur nga kjo ngjarje të ketë marrë të gjitha masat paraprake të arsyeshme, përkujdesjen e duhur dhe masa të ndryshme të arsyeshme, për të përmbushur afatet dhe kushtet e kësaj Marrëveshjeje, dhe (ii) të ketë njoftuar Palën tjetër brenda 5 (pesë) Ditëve Pune nga ndodhja e ngjarjes, duke specifikuar saktësisht llojin e Forcës Madhore dhe arsyet pse e bëjnë të pamundur përmbushjen e detyrimit përkatës.

(b) Ndryshimi i Marrëveshjes. Në rast se pasojat e shkaktuara nga Forca Madhore janë të tilla që duhet bërë një modifikim i Marrëveshjes, Palët bien dakord të fillojnë negociatat në mirëbesim për një ndryshim të Marrëveshjes për të rregulluar pasojat e Forcës Madhore.

Neni 11.07 Heqja Dorë

Asnjë mospërmbushje ose vonesë në përmbushje nga secila Palë në ushtrimin e ndonjë të drejte ose kompetence të parashikuar në këtë Marrëveshje nuk mund të konsiderohet si heqje dorë, dhe as ushtrimi i pjesshëm apo vetëm i një të drejte, as braktisja ose mosndjekja e hapave të mëtejshëm për t'i zbatuar këto të drejta apo kompetenca, nuk do të intepretohet në asnjë rast si arsye për t'u bërë pengesë që Pala të ushtrojë në një kohë tjetër këto të drejta apo kompetenca, apo të ushtrojë në çdo rast të drejta apo kompetenca të tjera.

Neni 11.08 Veçueshmëria

Nëse, në çdo kohë, çfarëdo dispozite që përfshihet në këtë Marrëveshje ose çdo pjesë e saj, në çfarëdo mase, është ose bëhet e paligjshme, e pavlefshme, e ndaluar me ligj ose e pazbatueshme në çfarëdolloj aspekti sipas Legjislacionit të Zbatueshëm, kësaj dispozite nuk do t'i jepet asnjë efekt dhe do të konsiderohet se nuk është përfshirë në këtë Marrëveshje, por pa shfuqizuar dispozitat e tjera të Marrëveshjes. Palët bien dakord që do bëjnë çdo përpjekje të mundshme dhe të arsyeshme që dispozita e paligjshme, e pavlefshme ose e pazbatueshme do të zëvendësohet me një dispozitë të ligjshme, të përshtatshme, të vlefshme, të zbatueshme dhe që i afrohet sa më shumë synimit dhe qëllimit të dispozitës së paligjshme, të pavlefshme ose të pazbatueshme.

Neni 11.09 Asnjë Interpretim Kundër Hartuesit

Palët pranojnë që kjo është një Marrëveshje e negociuar. Fakti që njëra Palë e Marrëveshje (apo këshilltarët e saj) ka hartuar Marrëveshjen apo një dispozitë të caktuar të saj apo se ajo përfiton nga ajo dispozitë nuk do të përdoret kundër saj në interpretimin e kushteve të Marrëveshjes.

Neni 11.10 Të Kuptuarit e Dokumenteve dhe Dispozitave

Palët pranojnë dhe janë dakord se ato i kanë lexuar dhe kuptuar kushtet, detyrimet dhe të drejtat e lindura nga kjo Marrëveshje dhe se ata kanë pasur mundësinë të këshillohen me juristë sipas zgjedhjes së tyre.

Neni 11.11 Ndryshimet

Ndryshimet e kësaj Marrëveshje, përfshirë dhe Shtojcat e saj, janë të vlefshme vetëm nëse bëhen me shkrim dhe nënshkruhen nga të dyja Palët.

Neni 11.12 Përfaqësuesi i Palëve Financuese

Dhënësi i Kolateralit autorizon Përfaqësuesin e Palëve Financuese të ndërmarrë të gjitha veprimet që Përfaqësuesi i Palëve Financuese mund të mendojë se janë të nevojshme për të bërë Marrëveshjen efektive dhe për t'i dhënë efekt çdo të drejte e detyrimi të Palëve në këtë Marrëveshje, për të mbrojtur apo ruajtur Kolateralin Financiar dhe për të realizuar procedurën e ekzekutimit të detyrueshëm sipas dispozitave te KREU 7 (*Ekzekutimi i Kolateralit Financiar*) të kësaj Marrëveshjeje.

Neni 11.13 Diskrecioni Lehtësues

Përfaqësuesi i Palëve Financuese mund të japë afate kohore shtesë ose lehtësira të tjera, kompromise, rregullime, të çlirojë ose të shkarkojë nga detyrimi apo të ndërmarrë veprime të tjera me Dhënësin e Kolateralit siç mund ta shikojë të arsyeshme pa paragjykuar përgjegjësinë e Dhënësit të Kolateralit apo të drejtat e Marrësve të Kolateralit. Pavarësisht parashikimeve më lart, ky diskrecion lehtësues nuk do të përbëjë detyrim për Marrësit e Kolateralit apo heqje dorë nga ndonjë e drejtë e Marrësve të Kolateralit.

Neni 11.14 Marrëveshja e Plotë

Kjo Marrëveshje është shtesë dhe jo zëvendësim i ndonjë Barre tjetër që mbahet tani apo do krijohet në të ardhmen nga Dhënësi i Kolateralit dhe kjo Marrëveshje është në dobi të Palëve dhe e detyrueshme për to si dhe për personat që mund të zenë vendin e tyre ose të cilëve u janë transferuar të drejtat dhe detyrimet.

Neni 11.15 Kopjet e Njëjta

Kjo Marrëveshje mund të nënshkruhet në 7 (shtatë) kopje, dhe çdonjëra prej të cilave kur është e nënshkruar dhe dorëzuar nga të dy Palët në mënyrë të rregullt, do të konsiderohet si origjinale dhe të gjitha së bashku do të përbëjnë një dokument të vetëm.

[Pjesa tjetër e faqes është lënë qëllimisht bosh]

PALËT bien dakord me kushtet, të drejtat dhe detyrimet sa më lart dhe e nënshkruajnë këtë Marrëveshje më poshtë në datën 13-03 2021.

DHËNËSI I KOLATERALIT

GJIKURIA sh.p.k.

Përfaqësuar nga Administratori

Z. Florenc Gjikuria

Z. Milo Gjikuria

MARRËSIT E KOLATERALIT

BANKA E TIRANËS sh.a.

Përfaqësuar nga:

Znj. Glenda Kurti

Drejtore e Divizionit të Korporatave

Znj. Aida Cengu

Drejtore e Departamentit të Administrimit të Kredive

BANKA INTESA SANPAOLO BANK ALBANIA sh.a.

Përfaqësuar nga:

Z.Alban Velo

Drejtor i Departamentit të SME-ve

INTESA SANPAOLO BANK Albania
Rr. I. Qemali, Nr 27. Tirane
Nipt: J81817006P

Znj. Jonida Duro

Menaxhere e Marrëdhënieve me Klientët SME

BANKA OTP ALBANIA sh.a.

Përfaqësuar nga:

Z. Ferid Shijaku

Drejtor i Divizionit të Biznesit

Z. Idit Farka

Koordinator Projekti dhe i Financës së Strukturuar

NOTER

Znj. Eriketa Kokoli

NOTER
TIRANE

Shoqëria "Gjikuria" sh.p.k
Regjistruar si Person Juridik me Vendim Gjykate nr. 9293, datë 28.02.1995
NIPT J62903456H

Tiranë, 15 / 11 / 2020

VENDIM NR. 1

I

ASAMBLESË SË JASHTËZAKONSHME TË ORTAKËVE TË SHOQËRISË "GJIKURIA" SH.P.K

Në mbledhjen e sotme, Asambleja e jashtëzakonshme e ortakëve të shoqërisë Gjikuria sh.p.k, (në vijim "Shoqëria"), bazuar mbi dispozitat e Ligjit për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtarë, si dhe nenet 7.1, 7.2, 7.3, 8.1 e vijues të statutit të Shoqërisë,

VENDOSI :

1. Miratimin e të gjitha kontratave/marrëveshjeve të mëposhtme:

   (i) Kontratë Kredie me afat për marrjen e një kredie nga "Shoqëria Koncesionare Rruga Orikum – Llogara" sh.p.k në shumën prej EUR 25,600,000 (njëzetë e pesë milion e gjashtëqind mijë euro) plus interesi i kapitalizuar gjatë 12 muajve pas Disbursimit të Parë, me Kredidhënës shoqëritë "Banka e Tiranës" sh.a, "Intesa Sanpaolo Bank Albania" sh.a dhe "Banka OTP Albania" sh.a. Periudha totale e shlyerjes së Kredisë është 10 vjet nga data e Disbursimit të Parë, por gjithmonë jo më vonë se 31.12.2031. Palët bien dakord që Kredimarresi do te paguaje Interes Kontraktor çdo 3-muaj mbi shumen e disbursuar dhe te pashlyer te kredise sipas Skedulit të Ripagimit të kredisë dorezuar Kredimarresit. Norma e Interesit Kontraktor eshte e ndryshueshme dhe do te llogaritet interes baze (indeks) BONO THESARI 12-mujor (norma mesatare e ponderuar) shtuar me marzhin 3.5 % (tre pikë pesë perqind) ne vit, por jo me pak se 6 % (gjashtë për qind) ne vit, ku Norma Baze e Interesit (indeks) eshte objekt rishikimi dhe ndryshimi nga Banka çdo 12-mujor. Norma Efektive e Interesit (NEI) është 6.41% (gjashtë pikë dyzetë e një për qind) në vit, e llogaritur duke u bazuar në Normën Vjetore të Interesit në ditën e lidhjes së kësaj Kontrate ;

(ii) Marrëveshjes së Kolateralit Financiar mbi të Ardhurat e Arkëtueshme të "Shoqëria Koncesionare Rruga Orikum – Llogara" sh.p.k të cilat do të përfitohen nga Kontrata e Koncesionit Nr. 2515 Rep., Nr. 1353 Kol, datë 20.05.2019 ;

(iii) Marrëveshjes së Barrës Siguruese rradhë e parë mbi të Ardhurat e Arkëtueshme të "Shoqëria Koncesionare Rruga Orikum – Llogara" sh.p.k të cilat do të përfitohen nga Kontrata e Koncesionit Nr. 2515 Rep., Nr. 1353 Kol, datë 20.05.2019 ;

(iv) Marrëveshje Kolaterali Financiar mbi Kuotat e "Shoqëria Koncesionare Rruga Orikum – Llogara" sh.p.k dhe të shoqërisë "Gjikuria" sh.p.k , në favor të "Banka e Tiranës" sh.a, Banka OTP Albania sh.a., Intesa San Paolo Bank Albania sh.a. ;

(v) Marrëveshje Barrë Siguruese rradhë e parë mbi Kuotat e "Shoqëria Koncesionare Rruga Orikum – Llogara" sh.p.k dhe të shoqërisë "Gjikuria" sh.p.k , në favor të "Banka e Tiranës" sh.a, Banka OTP Albania sh.a., Intesa San Paolo Bank Albania sh.a. ;

(vi) Marrëveshje e Pengut rradhë e parë mbi Kuotat e "Shoqëria Koncesionare Rruga Orikum – Llogara" sh.p.k dhe të shoqërisë "Gjikuria" sh.p.k , në favor të "Banka e Tiranës" sh.a, Banka OTP Albania sh.a., Intesa San Paolo Bank Albania sh.a. ;

(vii) Marrëveshje Barrë Siguruese rradhë e parë mbi Asetet e tashmë të shoqërisë "Gjikuria" sh.p.k me vlerën e regjistruar sipas bilancit të auditurar të vitit 2019, në favor të "Banka e Tiranës" sh.a, Banka OTP Albania sh.a., Intesa San Paolo Bank Albania sh.a.

(viii) Marrëveshjes së Barrës Siguruese rradhë e parë mbi Asetet e tashme dhe të ardhshme të "Shoqërisë Koncesionare Rruga Orikum – Llogara" sh.p.k;

	i linjave me fibra optike. Zhvillim i aktivitetit ne fushen e programimit dhe mirembajtjes te software dhe platformave software. Ne fushen e ndertimit te rrjeteve inxhinierike te ujesjellesit, te kanalizimeve te ujerave te bardha dhe te zeza, te vaditjes te kullimit, impiante te ndryshme, punime karpenterie, topogjeodezike, punime ne siperfaqe te gjelberta, mirembajtje te rrugeve, ne fushen e mbrojtjes ambientale lumore si dhe pastrimi i vijes bregdetare. Studim, projektim dhe zbatim punimesh ne hortikulture, arkitekture mjedisi, pejsazheve, siperfaqeve te gjelberta si lulishte, parqe dhe pyje, pastrimi i siperfaqeve urbane, mirmbajtja dhe zhvillimi dekorit ne mjedise urbane. Prodhimi dhe tregtimi (materiali mbjelles bimor) i farnave, fidanave, luleve, shkurre e drureve dekorative. Kryerja e sherbimeve profesionale ne fushen e prerjes dhe mirembajtjes se pyjeve. Sherbime te ekspertizes dhe profesionale ne mjedis, pyje dhe kullota (studime, projektime dhe zbatime). Sherbimi dhe riparimi i automjeteve, hapje pike servisi. Studime dhe konsulence ne fushen e mjekesise. Te kryeje çdo aktivitet tregtar, financiar dhenie e marrje me qera. Te kryeje aktivitete publikimi dhe reklamimi. Aktivitet ne fushen e turizmit. Veprimtarite e ekspertizes lidhur me ndikimin ne mjedis. Karriere guri dekorativ. Sherbimi ekspertize dhe/ose profesionale te mbrojtjes civile. Sherbime ekspertize per, studimi dhe pergatitja e projekteve mbi masat e mbrojtjes nga zjarri te ndertesave te çdo lloji. Hartimin e akteve te ekspertizes teknike per zjarret e rena ne te gjithe territorin e Republikes se Shqiperise. Te kryeje monitorime te gjendjes se mjedisit dhe komponenteve te saj si mjedis ujor, ajrin, biodiversitetin, pyjet dhe tokes. Te zhvilloje analiza laboratorike per matjen e parametrave te cilesise se ujerave siperfaqesore, ujit te pijshem, tokes dhe ajrit si dhe shkarkimeve te te gjitha llojeve te industries se mjedisit, te monitoroje parametrat mjedisore te qyteteve si ajri, zhurmat etj. Te jap konsulence ne fushen e mjedisit. Te hartoje dhe zbatoje projekte per trajtimin e ujerave te ndotura, industriale, ujrave bregdetare etj. Te ofroje konsulence ne fushen e GIS etj. Kryen sherbimet e desinfektimit, desinsektimit dhe deratizimit. Ofron sherbime ne implementimin e sistemeve ISO 14001,9001 etj. Ofron sherbime per Shendetin dhe Sigurine ne pune, te kurseve

	profesionele per implementimin e sistemit te Shendetit dhe Sigurise ne Pune, ISO 14001 dhe ISO 9001. Te kryeje ndertime detare dhe punime thellimi ne uje. Transport mallrash per llogari te vet, per te trete dhe me qera brenda vendit. Transport te mallrave me mjete jashte norme.Punime projektimi dhe zbatimi te restaurimit, perforcimit strukturor (retrofit) dhe koservim ne monumentet te arkitektures, objekteve social kulturore, monumenteve te trashegimise kulturore, godinave an tike, rezidenciale me rendesi te vecante me vlera historike, objekteve te kultit. Konservim, restaurim e rikualifikim i rrenojave e siteve arkeologjike, i arkitektures se kultit, i arkitektures se tradites (vernikulare), i hapesirave (rruge, sheshe) brenda qendrave historike, ansambleve historike urbane, mozaikeve, i pikturave murale dhe shkembore, i veprave te artit ne dru, allci, gure, qeramike, metal, qelq, tekstil, lekure, pergamen e telajo, etj.	
10. Administratori/ët 10.1 Afati i emërimit	Milo Gjikuria	
	Nga: 27/02/1995	Deri: 24/01/2024
11. Procedura e emërimit nëse ndryshon nga parashikimet ligjore 11.1 Kufizimet e kompetencave (nëse ka)		
12. Administratori/ët 12.1 Afati i emërimit	Ardmir Doda	
	Nga: 04/03/2019	Deri: 04/03/2024
13. Procedura e emërimit nëse ndryshon nga parashikimet ligjore 13.1 Kufizimet e kompetencave (nëse ka)		
	Perfaqesimin e shoqerise ne ceshtjet mjedisore, si Ekspert mjedisi per vleresimin e ndikimit ne mjedis, auditim dhe ekspertize mjedisore, pra vetem ne perputhje me rolin e sipercituar. a. duke mos patur asnje te drejte per te kryer veprime te administrimit te veprimtarise tregtare te shoqerise, b. duke mos patur asnje te drejte per te kryer veprime financiare, bankare, c. duke mos patur asnje te drejte per te kryer veprime te tjera, te mbarevajtjes se shoqerise, sipas statutit te saj.	
14. Administratori/ët 14.1 Afati i emërimit	Florenc Gjikuria	
	Nga: 28/01/2005	Deri: 24/01/2024
15. Procedura e emërimit nëse ndryshon nga parashikimet ligjore 15.1 Kufizimet e kompetencave (nëse ka)		

16. Ortakët	MiloGjikuria	
16.1 Vlera e kapitalit	Para: 98.172.000,00	Natyre:
16.2 Numri i pjesëve	1,00	
16.3 Pjesëmarrja në përqindje (%)	36,00	
**Të përfaqësuarit, (Plotësohet vetëm nëse një kuotë zotërohet në bashkëpronësi)*		
16.4 Komente (nëse ka)		
17. Ortakët	FlorencGjikuria	
17.1 Vlera e kapitalit	Para: 174.528.000,00	Natyre:
17.2 Numri i pjesëve	1,00	
17.3 Pjesëmarrja në përqindje (%)	64,00	
**Të përfaqësuarit, (Plotësohet vetëm nëse një kuotë zotërohet në bashkëpronësi)*		
17.4 Komente (nëse ka)		
18. Vende të tjera të ushtrimit të aktivitetit	Tirane Vore PICAR Nr. Pasurie 167/15, Zona Kadastrale Nr. 3974, ne Fshatin Picar Fier Fier FIER Kamion Benz TR 4048 I. Vlore Himare HIMARE Ndertim Rruga Palase-Dhermi Tirane Tirane TIRANE Furgon, Volkswagen, TR 8009 G Durres Nikel NIKEL Rindertimi i Shkolles se Mesme te Bashkuar "Ramazan Karaj" Nikel, Bashkia Kruje Tirane Tirane TIRANE Sistemimi i Perroit te Kallmit, Bashkia Tirane Tirane Kashar KASHAR Rindërtimi i banesave individuale, jashtë zonave të reja per zhvillim, ndërtimin dhe rikonstruksionin e infrastrukturës publike si dhe cdo ndërhyrje tjeter në funksion te tyre, ne Njesine Administrative Kashar dhe Lagjja 13, ku jane percaktuar 7 shtepi. Tirane Tirane TIRANE Mjeti Kamion Koke Terheqese - Targa AB 656 CI Tirane Tirane TIRANE Ndertimi i Rruges se Unazes se Jashtme Tirane, pjesa verilindore (segmenti Kthesa e Saukut-Bregu i Lumit) Lot 3 Vlore Himare DHERMI Impiant i Trajtimi te Ujerave te Ndotura dhe sistemi KUZ Drimadhe, Dhermi. Tirane Petrele MULLET Fshati Dobresh, Nr.Pasurie 403/1.	

	Zone Kadastrale Nr.1498 Tirane Tirane TIRANE "Ndertimi i 5 fiderave te rinj C 1/1 (Nenstacioni Hardin I 5), C 2/1 (Nenstacioni Qemal Stafa 3), C 3/1 (Nenstacioni Ali Demi 1), C 15/1 (Nenstacioni Sitki Cico 4), C 6/1 (Nenstacioni Kabina Shengjergji) per ndarjen e fiderave CI; C2; C3; C6, C15 etj. Vlore Himare DHERMI Fshati Dhermi, nr. pasurie 68/1, zone kadastrale nr. 1739. Vlore Himare PALASE Permiresimi i sistemit te furnizimit me uje te zonave Dhermi, Faza II, Gjilek, Kondraq dhe Palase Fier Fier FIER Kamion Saurer TR 6752 P. Tirane Tirane TIRANE Mjeti Kamion me Vinç- Iveco, AB 573 BX Vlore Himare DHERMI Furnizimi me uje i zonave turistike Drimadhes, Dhermi dhe permiresimi i rrjetit te ujesjellesit te fshatit Dhermi Fier Fier FIER Autobot Uji tip STEYR TR 9614 T. Vlore Himare HIMARE Kompleksi Green Coast, Palase. Vlore Himare PALASE Nderhyrje e integruar per permiresimin e aksesit, sherbimeve dhe rikualifikimit urban ne zonen e Plazhit Palase - Drymadhes Tirane Tirane TIRANE Rikualifikim urban i bllokut qe kufizohet nga Bulevardi Bajram Curri - Bulevardi Petro Nini Luarasi - Rruga Taulantia - Rruga Ali Demi-Faza I. Durres Kruje KRUJE Riparimi i Shkolles "Shaqir Lleja", Bushnesh Durres Shijak SHIJAK Rindertimi i njesive te banimit ne ndertesa (pallat) per zonen e re per zhvillim Shijak, Paketa B, Objektet 5.1, 5.2, 5.3, 5.4, 5.5, 5.6, 5.7, Bashkia Shijak. Tirane Tirane TIRANE Mjeti Autobetoniere - Scania, Targa AB 713 BX Fier Fier FIER Kamion Benz TR 9260 G. Tirane Tirane TIRANE Mjeti Gjysme Rimorkio - Targa AH R690 Fier Fier FIER Autobetoniere tip IVECO FR 3385 D. Tirane Tirane TIRANE Rehabilitimi i rrugëve të bllokut që kufizohet nga rrugët "Fabrika e Qelqit", "Konferenca e Pezës", "Besim Alla" dhe "Jorgo Panajoti" - Faza I Vlore Himare HIMARE Rrethi Vlore, Bashkia Himare, Mali Kolzes, "Vumblo" (Fabrike Asfalto-Betoni)

	Fier Fier FIER Autovinç tip IFA TR 7960 R. Fier Fier FIER Kamion Benz TR 3059 J. Tirane Tirane TIRANE Mjeti Autobetoniere - Scania, Targa AB 825 BX Fier Fier FIER Kamion Vinç Benz TR 9481 H. Tirane Tirane TIRANE Rikualifikim i akseve rrugore Unaza Lindore Loti 3 Tirane Rrogozhine RROGOZHINE Rindertimi i 148 banesave individuale, ndertimi dhe rikonstruksioni i infrastruktures publike dhe çdo nderhyrje tjeter ne funksion te tyre, Bashkia Rrogozhine Fier Fier FIER Gjysem rimorkio Titan, FR 0316 D. Tirane Dajt DAJT Zall Dajt, Zona Kadastrale 3348 Tirane Tirane TIRANE Mjeti Kamioncine - Peugeot, AA 152 MB Tirane Vaqarr VAQARR Rindërtimi i banesave individuale, jashtë zonave të reja per zhvillim, ndërtimin dhe rikonstruksionin e infrastrukturës publike si dhe cdo ndërhyrje tjeter në funksion te tyre, ne Njesine administrative Vaqarr, ku jane te percaktuara 24 shtepi Fier Fier FIER Kamionçine Benz TR 8259 I. Tirane Tirane TIRANE Ndertimi i Godines Tip ne RSU nr.3 (nr.5), Tirane Tirane Kamez KAMEZ Rindërtimin e 162 banesave individuale, ndërtimin dhe rikonstruksionin e infrastrukturës publike dhe çdo nderhyrje tjetër ne funksion të tyre"
19. Të dhëna që njoftohen vullnetarisht	Emri Tregtar: GJIKURIA E-Mail: info@gjikuria.com Telefon: 042264758 Të Tjera: Depozitim i vendimit dt 27-10-2010 per:Emerimin e Z.Nikolla Geço si ekspert kontabel per hartimin e raportit per zmadhimin e kapitalit.
20. Statusi:	Aktiv

Datë: 03/03/2021

Emri, Mbiemri, Nënshkrimi
(i nëpunësit të sportelit)

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË
QENDRA KOMBËTARE E BIZNESIT

Vulosur elektronikisht nga
Qendra Kombëtare e Biznesit
Date:2021/03/03 13:26:38 +01:00
J62903456H2021030313261933
2006

*Shënim : Ky dokument është gjeneruar dhe vulosur me anë
të një procedure automatike nga një sistem elektronik (Qendra Kombëtare e Biznesit)*

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË

DEGA VENDORE TIRANË

NOTER ERIKETA M. KOKOLI
ADRESA NR.10, SAMI FRASHERI, NR.16
TEL:

KONTRATË PENGU

(KONTRATË PENGU KUOTA TË SHOQËRISË)

Nr. repertori: 478 **Nr. koleksioni: 270**

Tirane më 19/03/2021

Ligjet referuese:

1.Ligji nr. 7850, datë 29/07/1994 "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar

2.Ligji nr. 9887, date 10/03/2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar

3.Ligji nr. 110, datë 20/12/2018 "Për Noterinë"

A202105309002927858I

R. BIRLA

KONTRATË PENGU

Për Kuotat e Shoqërisë Koncesionare "Rruga Orikum - Llogara" Sh.p.k

ndërmjet

Banka e Tiranës Sh.A
Banka OTP Albania Sh.A
Intesa San Paolo Bank Albania Sh.A

dhe

Gjikuria Sh.P.K

Data 18.03. 2021

TABELA E LËNDËS

KREU 1. HYRJA, INTERPRETIMI DHE PËRKUFIZIMET 5

NENI 1.01 HYRJA 5
NENI 1.02 INTERPRETIMI 5
NENI 1.03 PËRKUFIZIMET 6

KREU 2. TË PËRGJITHSHME 10

NENI 2.01 BAZA LIGJORE DHE HIERARKIA E NORMAVE 10
NENI 2.02 PËRSHKRIMI I SENDIT TË LËNË PENG 10

KREU 3. PËRFAQËSIMI I PENGMARRËSVE 11

NENI 3.01 PËRFAQËSUESI I PALËVE FINANCUESE 11
NENI 3.02 VEPRIMET KRYHEN VETËM NGA PËRFAQËSUESI I PALËVE FINANCUESE 11
NENI 3.03 KOMUNIKIMET ME PËRFAQËSUESIN E PALËVE FINANCUESE 11
NENI 3.04 VEPRIMET ME EFEKT TË NJËJTË 11

KREU 4. TË DREJTAT DHE DETYRIMET E PALËVE 11

NENI 4.01 TË DREJTAT E PENGDHËNËSIT 11
NENI 4.02 DETYRIMET E PENGDHËNËSIT 11
NENI 4.03 TË DREJTAT E PENGMARRËSVE 13
NENI 4.04 DETYRIMET E PENGMARRËSVE 14

KREU 5. DEKLARIMET DHE GARANCITË 14

NENI 5.01 DEKLARIMET DHE GARANCITË E PALËVE 14
NENI 5.02 DEKLARIMET DHE GARANCITË E PENGDHËNËSIT 16

KREU 6. RASTET E MOSPËRMBUSHJES 16

NENI 6.01 RASTET E MOSPËRMBUSHJES 16
NENI 6.02 PASOJAT E MOSPËRMBUSHJES 17

KREU 7. EKZEKUTIMI I PENGUT 17

NENI 7.01 NJOFTIMI PËR EKZEKUTIM 17
NENI 7.02 SHITJA E PENGUT 18
NENI 7.03 PËRDORIMI I TË ARDHURAVE 18

KREU 8. DËMSHPËRBLIMI 18

NENI 8.01 DËMSHPËRBLIMI 18
NENI 8.02 PRETENDIME NGA PALË TË TRETA 18

KREU 9. HYRJA NË FUQI DHE PËRFUNDIMI I KONTRATËS 19

NENI 9.01 HYRJA NË FUQI E KONTRATËS 19
NENI 9.02 MOMENTI I PËRFUNDIMIT TË KONTRATËS 19
NENI 9.03 MBIJETESA E DISPOZITAVE TË KONTRATËS PAS PËRFUNDIMIT 19

KREU 10. ZGJIDHJA E MOSMARRËVESHJEVE 19

NENI 10.01 MJETET LIGJORE TË PENGDHËNËSIT 19
NENI 10.02 MJETET LIGJORE TË PENGMARRËSVE 20
NENI 10.03 ZGJIDHJA E MOSMARRËVESHJEVE 20
NENI 10.04 LEGJISLACIONI I APLIKUESHËM 20

KREU 11. TË NDRYSHME 20

NENI 11.01 AUTORIZIME 20
NENI 11.02 TRANSFERIMI, CEDIMI, ZËVENDËSIMI, PASOJAT DHE MBI PASARDHËSIT 21
NENI 11.03 PALËT E TRETA NUK PËRFITOJNË TË DREJTA 21
NENI 11.04 VEÇUESHMËRIA E INTERESAVE PASURORE 22
NENI 11.05 NJOFTIMET 22
NENI 11.06 FORCA MADHORE 23
NENI 11.07 HEQJA DORË 23
NENI 11.08 VEÇUESHMËRIA 23
NENI 11.09 ASNJË INTERPRETIM KUNDËR HARTUESIT 23
NENI 11.10 TË KUPTUARIT E DOKUMENTEVE DHE DISPOZITAVE 24
NENI 11.11 NDRYSHIMET 24
NENI 11.12 PËRFAQËSUESI I PALËVE FINANCUESE 24
NENI 11.13 DISKRECIONI LEHTËSUES 24
NENI 11.14 KONTRATA E PLOTË 24
NENI 11.15 KOPJET E NJËJTA 24

Shtojca 1 - Vendim Nr.1 Datë 15.11.2020 i Asamblesë së Përgjithshme të shoqërisë "Gjikuria" sh.p.k
Shtojca 2 – Letërnjoftimet ID
Shtojca 3 – Esktraktet nga QKB

HYRJE

Kjo Kontratë Pengu (në vijim "**Kontrata**") nënshkruhet sot më datë 19.03 2021 ("**Data e Nënshkrimit**"), para meje Notere Eriketa Kokoli, anëtare në Dhomën Kombëtare të Noterisë, Dega Vendore Tiranë, me zyrë në adresën Rruga "Sami Frasheri", pallati përballë Drejtorisë së Policisë Tiranë, kati 4, Tiranë, nga dhe ndërmjet palëve si më poshtë (në vijim secila palë më poshtë do të referohet veçmas si "**Pala**" dhe së bashku "**Palët**" siç mund ta kërkojë herë pas here konteksti i kësaj Kontrate):

(1) GJIKURIA sh.p.k., shoqëri e themeluar sipas legjislacionit shqiptar, me adresë në rrugën "Ibrahim Rugova", Pallati Kontakt, kati 2, Tiranë, me NUIS J62903456H, (në vijim "**Pengdhënësi**"), e përfaqësuar në bazë të Vendimit Nr.1 Datë 15.11.2020 i Asamblesë së Jashtëzakonshme të ortakëve të shoqërisë "Gjikuria" sh.p.k, bashkëngjitur si Shtojca 1 nga administratorët e saj Z.Florenc Gjikuria, i biri i Milos, lindur më 12.01.1973, në Memaliaj, banues në adresën Kompleksi "Rolling Hills", Vila 86, Tiranë, madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar, me Letërnjoftim me Nr. 031406006 dhe me Nr.Personal H30112106D; dhe Z. Milo Gjikuria, i biri i Janit, lindur më 25.07.1943, në Dhërmi, banues në adresën Rruga "Muhamet Gjollesha", Blloku Vasil Shanto, P. 3/1, Tiranë, madhor dhe me zotësi të plotë juridike per te vepruar, mbajtës i letërnjoftimit me Nr. 034489850 dhe me numër personal E30725035J;

(2) BANKA E TIRANËS sh.a., shoqëri aksionare e themeluar sipas legjislacionit shqiptar, me adresë në rrugën "Ibrahimi Rugova", me NUIS J61924008V, e përfaqësuar nga Drejtore e Divizionit të Korporatave, znj. Glenda Kurti, e bija e Agronit, lindur me 06.03.1978, në Tiranë dhe banuese në Tiranë në adresën Rr. "Kongresi i Manastirit", Pall. ½, Shkalla 3, identifikuar me pasaportë Nr. H85306150N dhe Drejtore e Departamentit të Administrimit të Kredive, Znj. Aida Cengu, e bija e Azemit, lindur me 16.02.1970 në Kukës dhe banuese në Tiranë me Letërnjoftim me Nr. 035236532 dhe me Nr. Personal H05216129L, madhore e me zotësi të plotë juridike për të vepruar (në vijim "**Përfaqësuesi i Palëve Financuese**");

(3) BANKA INTESA SANPAOLO BANK ALBANIA sh.a., shoqëri aksionare e themeluar sipas legjislacionit shqiptar, me adresë në rrugën "Ismail Qemali", Nr. 27, me NUIS J81817006P, e përfaqësuar nga Z. Alban Velo, shtetas shqiptar, lindur më datë 16.05.1976, në Lushnjë, me Letërnjoftim me Nr. Personal H60516140E, në cilësinë e Drejtorit të Departamentit të SME -ve dhe Zj.Jonida Duro, shtetase shqiptare, lindur më datë 08.01.1984, në Vlorë, me Letërnjoftim me Nr. Personal I45108023L, në cilësinë e Menaxheres së Marrëdhënieve me Klientët SME; dhe

(4) BANKA OTP ALBANIA sh.a. shoqëri aksionare e themeluar sipas legjislacionit shqiptar, me adresë në rrugën "Bulevardi Dëshmorët e Kombit", Twin Towers, Kulla 1, Kati 9, me NUIS K414280IU, e përfaqësuar nga zoti Ferid Shijaku, në cilësinë e Drejtori i Divizionit të Biznesit me Letërnjoftim me Nr. 035912295 dhe

me Nr. Personal G80118119I dhe zoti Idit Farka, në cilësinë e Koordinator Projekti dhe i Financës së Strukturuar me Letërnjoftim me Nr. 035812285 dhe me Nr. Personal I70122052S;

Banka e Tiranës sh.a., Intesa SanPaolo Bank sh.a. dhe Banka OTP Albania sh.a., do të referohen në vijim në këtë Kontratë si "**Pengmarrësit**" dhe/ose "**Kredidhënësit**".

PËRSHKRIME PARAPRAKE

MEQENËSE, më 20 Maj 2019, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Pengdhënësi dhe Kredimarrësi kanë lidhur një Kontratë Koncesioni/PPP të nënshkruar në Tiranë përpara noter Ermal Hamzaj me Nr. 2515 Rep/Nr. 1353 Kol. Datë 20.05.2019 për projektimin, ndërtimin dhe mirëmbajtjen e segmentit rrugor "Porti i Jahteve – By Pass Orikum – Dukat (Ura e Shën Elizës)" (në vijim "**Kontrata e Koncesionit**");

MEQENËSE, Shoqëria Konçesionare "Rruga Orikum - Llogara" sh.p.k (në vijim "**Kredimarrësi**") ka kërkuar kredi për realizimin e projektit për projektimin, ndërtimin dhe mirëmbajtjen e segmentit rrugor "Porti i Jahteve – By Pass Orikum – Dukat (Ura e Shën Elizës)";

MEQENËSE, Kredidhënësit kanë rënë dakort që ta financojnë Kredimarrësin sipas kushteve të parashikuara në Kontratën e Kredisë (siç përkufizohet më poshtë);

MEQENËSE, Kontrata e Kredisë parashikon që Pengdhënësi së bashku me Palët Garantuese të tjera do t'i japin Kredidhënësve garanci duke vendosur Peng (siç përkufizohet më poshtë) mbi Kuotat e Pengdhënësit sipas kushteve të kësaj Kontrate;

ATËHERË, në bazë të kushteve, të drejtave, detyrimeve, deklarimeve dhe garancive të shprehura në këtë Kontratë, Palët bien dakord si më poshtë:

KREU 1. HYRJA, INTERPRETIMI DHE PËRKUFIZIMET

Neni 1.01 Hyrja

Të gjitha parashtrimet e mësipërme që janë përfshirë në hyrjen dhe përshkrimet paraprake të kësaj Kontrate janë pjesë integrale e saj.

Neni 1.02 Interpretimi

(a) Kontrata si e Tërë. Çdo e drejtë, detyrim, apo kusht i përshkruar në këtë Kontratë duhet të interpretohet në kontekstin e Kontratës të marrë si e tërë dhe duke marrë në konsideratë qëllimet që nxitën Palët për të hyrë në këtë Kontratë.

(b) Titujt, Krerët, Nenet, Paragrafët. Titujt e krerëve, neneve, paragrafëve, nënparagrafëve që përmban kjo Kontratë si dhe ato që janë në tabelën e lëndës janë vetëm për

referencë dhe nuk do të ndikojnë në asnjë mënyrë në kuptimin apo interpretimin e kësaj Kontrate.

(c) Shtojcat. Të gjitha anekset dhe shtojcat bashkëngjitur apo referuar, janë inkorporuar dhe janë pjesë integrale të kësaj Kontrate. Nëse një fjalë e përdorur në ndonjë aneks apo shtojcë fillon më gërmë kapitale por nuk është e përkufizuar në këtë aneks apo shtojcë, do të ketë kuptimin e përkufizuar në këtë Kontratë. Kur në tekstin e kësaj Kontrate ka referenca për një kre, nen, paragraf, nënparagraf, aneks, shtojcë, të tilla referenca lidhen me kreun, nenin, paragrafin, nënparagrafin, aneksin apo shtojcën e kësaj Kontrate, përveçse kur përcaktohet ndryshe.

(d) Interpretimet Gramatikore. Përveçse në rastet kur thuhet shprehimisht ndryshe, në Kontratë:

(1) Fjalët e përdorura në numrin njëjës përfshijnë edhe ato të përdorura në numrin shumës;

(2) Fjalët e përdorura në një rasë apo gjini përfshijnë, sipas kontekstit, edhe rasat dhe gjinitë e tjera;

(3) Nëse një fjalë është e përkufizuar, edhe format e tjera gramatikore do të kenë kuptimin përkatës;

(4) Fjala "përfshin", do të thotë "përfshin, pa u kufizuar", pavarësisht nëse ndiqet nga ai togfjalësh apo jo; dhe

(5) Fjalët e përdorura në këtë Kontratë dhe që janë përkufizuar në Kontratën e Kredisë, nëse nuk parashikohet ndryshe, do të kenë të njëjtin kuptim.

Neni 1.03 Përkufizimet

"Barrë" do të thotë çdo interes ose pjesëmarrje në kapital e çdo Personi (përfshirë çdo të drejtë për të blerë, opsion apo të drejtë parablerje) apo çdo hipotekë, detyrim, peng, garanci, kalim të drejtash, kufizim, barrë siguruese (përfshirë ato të krijuara me ligj), kolateral financiar, titull me rezervë apo Kontratë ose transaksione të tjera siguruese, apo dhënie me qira, blerje me këste apo qiramarrje afatgjata, shitje me kredi apo Kontratë të tjera ku parashikohet që pagesa të kryhet në kohë të ndryshme, apo çfarëdo lloj e drejte tjetër reale apo kufizimi që mund të vihet mbi, apo lidhet me Kuotat.

"Data e Nënshkrimit" ka kuptimin që i është dhënë në hyrjen e kësaj Kontrate.

"Detyrimet" ka kuptimin e dhënë në Kontratën e Kredisë.

"Dëm" i referohet në mënyrë kumulative çdo dëmi kontraktor ose jashtëkontraktor, kosto, shpenzimi të kryer, pagese, humbje ose detyrimi i cili është pasojë direkte ose e tërthortë e shkeljes së deklaratave, garancive, premtimeve apo e zotimeve të kësaj Kontrate, përfshirë shpenzimet e kryera për të parandaluar apo përballuar Pretendimet që sjellin shkaktimin e këtij Dëmi, apo për të parandaluar pasojat e tij, si shpenzimet avokatore dhe gjyqësore.

"Disbursim" ka kuptimin e dhënë në Kontratën e Kredisë.

"Ditë Pune" do të thotë dita në të cilën Banka e Shqipërisë është e hapur për punë, përjashtuar të shtunën, të dielën dhe festat zyrtare në Republikën e Shqipërisë.

"Dokumentet e Financimit" kanë kuptimin e dhënë në Kontratën e Kredisë.

"Dokumentet e Garancive" kanë kuptimin e dhënë në Kontratën e Kredisë.

"**Entitet Qeveritar**" do të thotë (i) Kuvendi, Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë, çdo ministri, departament, ose nëndarje e tyre; dhe (ii) çdo Person tjetër, gjykatë, agjenci apo autoritet nën kontrollin e drejtpërdrejtë ose jo të Republikës së Shqipërisë, që ka juridiksion mbi Palët sipas Legjislacionit të Zbatueshëm.

"**Forca Madhore**" në këtë Kontratë do të konsiderohet një ngjarje apo situatë që (i) është e paparashikueshme, (ii) është jashtë kontrollit të Palës që e pretendon forcën madhore dhe nuk është shkaktuar për faj të saj (iii) ka ndikim direkt mbi Palën që e pretendon forcën madhore, dhe (iv) bën të pamundur përmbushjen e detyrimit nga ana e Palës që pretendon forcën madhore. Për ilustrim, Forca Madhore mund të përfshijë (x) aktet e luftës, terrorizmit, revoltat civile, veprimet e elementeve të natyrës (p.sh. zjarri, përmbytja, stuhia etj.), apo vendosja e masave të jashtëzakonshme sipas Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë. Për të shmangur çdo keqinterpretim, mungesa e likuiditetit të një Pale, bllokimi i llogarive bankare të tij nga ndonjë prej Entiteteve Qeveritare, paaftësia paguese, bllokimi i aktivitetit tregtar, pezullimi apo bllokimi i punimeve, nga një Entitet Qeveritar nuk janë dhe nuk do të konsiderohen si Forcë Madhore.

"Garanci" ka kuptimin e dhënë të Kontrata e Kredisë.

"Gjykim" ka kuptimin që i është dhënë te Neni 5.01(c) (*Deklarimet dhe Garancitë e Palëve; Mungesa e Konflikteve apo Nevojës për Miratime*) i kësaj Kontrate.

"Informacion Konfidencial" ka kuptimin e dhënë te Neni 11.01(b)(3) *(Autorizime; Autorizimi për Përdorimin e Informacionit Konfidencial)* i kësaj Kontrate.

"**Kodi Civil**" ka kuptimin e ligjit nr.7850 datë 29.7.1994 "*Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë*", me gjithë ndryshimet që kanë hyrë në fuqi në çastin e lidhjes së kësaj Kontrate.

"Kontrata e Koncesionit" ka kuptimin e dhënë në përshkrimet paraprake të kësaj Kontrate.

"Kontrata e Kredisë" është kontrata me Nr. 2169 Rep, Nr. 1143 Kol. Datë 15.11.2020, nënshkruar pranë noteres Eriketa Kokoli.

"Kontrata" ka kuptimin që i është dhënë në hyrjen e kësaj Kontrate.

"Kredimarrësi" është Shoqëria Koncesionare "Rruga Orikum – Llogara" sh.p.k., shoqëri e themeluar sipas legjislacionit shqiptar, me adresë në rrugën "Ibrahim Rugova", Pallati "Kontakt", kati 3, Tiranë, me NIPT L82327014A.

"Kuota" ka kuptimin e dhënë te Neni 2.02(a) (*Vendosja e Pengut*) i kësaj Kontrate.

"Legjislacion i Zbatueshëm" do të thotë çdo ligj, akt nënligjor, akt normativ kombëtar apo lokal, urdhër, dekret apo akt tjetër, kod, direktivë, vendime dhe akte të ministrave, qarkore të departamenteve, rregullore, deklarata dhe interpretime të organeve zyrtare të Republikës së Shqipërisë, çdo vendim gjyqësor apo çdo licencë, aprovim, leje apo autorizim apo miratime të tjera në fuqi, të Republikës së Shqipërisë, apo të çdo njësie apo ndarje administrative ose të çdo Personi të krijuar me ligj, (qoftë i pavaruar apo jo), që ka juridiksionin përkatës mbi Palët, përfshirë ndryshimet e herëpashershme të tyre.

"Ligji për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" ka kuptimin e ligjit nr.9887 datë 10.3.2008 *"Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale"*.

"Marrëveshja e Drejtpërdrejtë" është marrëveshja me Nr.Prot.7762/4 Datë 16.11.2020.

"Marrëveshja Ndërmjet Kreditorëve" është kontrata me nr 472 Rep dhe nr 264 Kol, datë 13.03.2021.

"Ndryshim Përkeqësues Thelbësor" (i) kur i përdoret në referencë me Pengdhënësin apo Palët Garantuese ka kuptimin që i është dhënë në Kontratën e Kredisë; dhe (ii) kur i referohet Pengmarrësve do të thotë një ndryshim i tillë i rrethanave që nuk i lejon Pengmarrësit të përmbushin detyrimet e tyre në bazë të kësaj Kontrate.

"Palë Dëmshpërblyese" ka kuptimin e dhënë te Neni 8.01 (*Dëmshpërblimi*) i kësaj Kontrate.

"Palë e Dëmshpërblyer" ka kuptimin e dhënë te Neni 8.01 (*Dëmshpërblimi*) i kësaj Kontrate.

"Palë" ka kuptimin që i është dhënë në hyrjen e kësaj Kontrate.

"Palët Garantuese" ka kuptimin e dhënë në Kontratën e Kredisë.

"Pengdhënës" është Gjikuria sh.p.k., një shoqëri e themeluar sipas legjislacionit shqiptar, me adresë në rrugën "Ibrahim Rugova", Pallati "Kontakt", kati 2, Tiranë, me NIPT J62903456H.

"Pengmarrësit" ka kuptimin që i është dhënë në hyrjen e kësaj Kontrate.

"Pengu" është mjeti për sigurimin e ekzekutimit të detyrimeve mbi Kuotat, që sipas Kodit Civil sigurón përmbushjen e Detyrimeve kundrejt Pengmarrësve.

"Person i Përshtatshëm" ka kuptimin e dhënë në Marrëveshjen e Drejtpërdrejtë.

"Person" do të thotë çdo individ, person fizik, kompani, ortakëri e çdo lloj forme organizimi e parashikuar nga Legjislacioni i Zbatueshëm ose ai i një vendi specifik, përfshirë Entitetet Qeveritare.

"Përfaqësuesi i Palëve Financuese" ka kuptimin që i është dhënë te Neni 3.01 (*Përfaqësuesi i Palëve Financuese*) i kësaj Kontrate si dhe ushtron kompetencat e Përfaqësuesit të Kredisë dhe Përfaqësuesit të Palëve Financuese sipas Marrëveshjes Ndërmjet Kreditorëve dhe përfshin çdo subjekt që mund të zëvendësojë Përfaqësuesin aktual të Palëve Financuese në të ardhmen.

"Pretendim" do të thotë çdo ankesë, padi, pretendim, kërkesë për dëmshpërblim, në gjykatë, gjykatë arbitrazhi, Entitet Qeveritar apo në çdo institucion a organizëm që merr vendime të ngjashme dhe që ka juridiksion mbi Palët.

"Qendra Kombëtare e Biznesit" ka kuptimin e institucionit të rregulluar nga ligji nr.9723 datë 3.5.2007 *"Për Regjistrimin e Biznesit"*, i ndryshuar, si dhe çdo institucion që mund ta zëvendësojë atë në të ardhmen.

"Rast Mospërmbushje" ka kuptimin që i është dhënë në Kontratën e Kredisë dhe/ose te Neni 6.01*(Rastet e Mospërmbushjes)* i kësaj Kontrate.

"Shoqëri Mëmë" ka kuptimin që i jepet në ligjin nr. 9901, datë 14.4.2008 *"Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare"*, i ndryshuar.

"Të Drejtat e Lidhura" do të thotë:

(a) çdo dividend, shpërndarje, ose interes i paguar ose i pagueshëm në lidhje me Kuotat, përfshirë por pa u kufizuar në shpërndarjet të cilat lindin si pasojë e zvogëlimit të kapitalit themeltar, pretendimet mbi të ardhurat e likuidimit si dhe të gjithë pretendimet financare të tashme apo të ardhshme të lidhura me to;

(b) çdo kuotë, letra me vlerë, te drejta, të holla ose pasuri të lindura ose të ofruara në çdo kohë (me anë të të drejtës së kthimit, bonuseve, preferimit, të drejtave me kusht, zëvendësimit, këmbimit ose ndryshe) në lidhje me ose mbi Kuotën;

(c) të gjithë dividendët, interesat ose të ardhura të tjera në lidhje me çdo aset të përmendur në paragrafët (a), (b) dhe (c) më lart;

(d) të gjithë të drejtat e votës në lidhje me Kuotën, të cilat mund të ushtrohen si në asamblenë e zakonshme të Pengdhënësit; dhe

(e) të gjitha të drejtat e Pengdhënësit në lidhje me ose mbi cilëndo kuotë që mund të fitohet në të ardhmen prej Pengdhënësit nëpërmjet kapitalizimit të fitimeve, rritjes së kapitalit, ndarjes, kthimit të borxhit në kapital, sigurimit të kuotave, etj.

KREU 2. TË PËRGJITHSHME

Neni 2.01 Baza Ligjore dhe Hierarkia e Normave

Kjo Kontratë bazohet në Legjislacionin e Zbatueshëm, përfshirë, por pa u kufizuar në dispozitat e Kodit Civil. Për aq sa lejohet nga dispozitat e Legjislacionit të Zbatueshëm, kur kjo Kontratë parashikon ndryshe nga Legjislacioni i Zbatueshëm, dispozitat e kësaj Kontrate do të mbizotërojnë.

Neni 2.02 Përshkrimi i Sendit të Lënë Peng

(a) Vendosja e Pengut. Nëpërmjet kësaj Kontrate, Pengdhënësi vendos në favor të Pengmarrësve, si Garanci për përmbushjen e Detyrimeve sipas Kontratës së Kredisë, Peng të radhës së parë mbi:

(1) kuotën pjesë të kapitalit me vlerë 1.000,00 Lekë, në pronësi të Pengdhënësit në kapitalin e shoqërisë Shoqëria Koncesionare "Rruga Orikum – Llogara" sh.p.k., shoqëri e themeluar sipas legjislacionit shqiptar, me adresë në rrugën "Ibrahim Rugova", Pallati "Kontakt", kati 3, Tiranë, me NIPT L82327014A (në vijim "**Kredimarrësi**"); dhe që përfaqëson 100 % të kapitalit total të Kredimarrësit (në vijim "**Kuota**"), dhe

(2) çdo kuotë të re që Pengdhënësi do të zotërojë mbi Kredimarrësin, letër me vlerë, të drejta, të holla, ose pasuri të lindura ose të ofruara në çdo kohë (qoftë me anë të kthimit, bonus, preferimit, të drejtave me kusht, zëvendësimit, këmbimit ose ndryshe), etj; dhe

(3) të gjitha të Drejtat e Lidhura (në vijim, paragrafët (1), (2) dhe (3) bashkarisht do referohen në këtë Kontratë si "**Kuotat**").

(b) Qëllimi i Pengut. Pengu vendoset me qëllim sigurimin e përmbushjes të të gjitha Detyrimeve të Pengdhënësit dhe/ose Palëve Garantuese sipas Kontratës së Kredisë, duke përfshirë por pa u kufizuar në shumën totale të Detyrimeve kundrejt Kredidhënësve deri në pagimin e plotë të tyre nga Pengdhënësi dhe/ose Palët Garantuese, si dhe çdo shumë tjetër që këta të fundit i detyrohen Pengmarrësve sipas Kontratës së Kredisë.

(c) Aplikimi tek Ndryshimet e Kontratës së Kredisë. Palët bien dakord që kjo Kontratë do të aplikohet *mutatis mutandis* edhe përmbi çdo ndryshim që mund t'i bëhet Kontratës së Kredisë, përveç rastit kur këto ndryshime e kanë përjashtuar shprehimisht aplikimin e kësaj Kontrate. Çdo ndryshim që mund t'i bëhet Kontratës së Kredisë nuk do të prekë Pengun e vendosur mbi Kuotat.

KREU 3. PËRFAQËSIMI I PENGMARRËSVE

Neni 3.01 Përfaqësuesi i Palëve Financuese

Palët pranojnë se Pengmarrësit kanë emëruar Bankën e Tiranës sh.a si përfaqësues të tyre për të ndërmarrë çdo veprim dhe firmosur çdo akt që ka lidhje me ata sipas kësaj Kontratë (në vijim "**Përfaqësues i Palëve Financuese**"). Palët bien dakord dhe pranojnë se çdo veprim apo akt i firmosur prej Përfaqësuesit të Palëve Financuese do të konsiderohet si i kryer personalisht prej tyre, përveç rasteve kur kjo Kontratë, Marrëveshja Ndërmjet Kreditorëve apo Legjislacioni i Zbatueshëm parashikon ndryshe.

Neni 3.02 Veprimet Kryhen Vetëm nga Përfaqësuesi i Palëve Financuese

Çdo veprim i parashikuar në këtë Kontratë, si dhe çdo veprim i nevojshëm apo i dobishëm për të ekzekutuar këtë Kontratë, që duhet të kryhet nga Pengmarrësit, mund të kryhet edhe nga Përfaqësuesi i Palëve Financuese në emër dhe për llogari të gjithë Pengmarrësve.

Neni 3.03 Komunikimet me Përfaqësuesin e Palëve Financuese

Për zbatimin e kësaj Kontrate, Pengdhënësi do të komunikojë me Përfaqësuesin e Palëve Financuese.

Neni 3.04 Veprimet me Efekt të Njëjtë

Çdo veprim që Pengdhënësi kryen kundrejt Përfaqësuesit të Palëve Financuese, do të konsiderohet se ka efekt të njëjtë kundrejt Pengmarrësve të tjerë, dhe çdo veprim që Përfaqësuesi i Palëve Financuese kryen kundrejt Pengdhënësit, do të konsiderohet se është bërë nga tërë Pengmarrësit bashkërisht.

KREU 4. TË DREJTAT DHE DETYRIMET E PALËVE

Neni 4.01 Të Drejtat e Pengdhënësit

Gjatë gjithë kohëzgjatjes së kësaj Kontrate dhe derisa nuk është dërguar një njoftim për Rast Mospërmbushjeje, Pengdhënësi gëzon të gjitha të Drejtat e Lidhura me Kuotat që bazohen në Legjislacionin e Zbatueshëm.

Neni 4.02 Detyrimet e Pengdhënësit

Pengdhënësi zotohet që gjatë kohëzgjatjes së kësaj Kontrate:

(a) Regjistrimi i Pengut. Regjistrimi pranë Regjistrit të Barrëve Siguruese do të kryhet nga Pengdhënësi me shpenzimet e veta, brenda një afati të arsyeshëm me të cilin Pengmarrësit janë dakord, përveç kur Pengmarrësit vendosin ndryshe. Kur ky regjistrim kryhet nga Pengdhënësi, ky i fundit do t'i dorëzojë Përfaqësuesit të Palëve Financuese dokumentin zyrtar që vërteton regjistrimin ose një deklaratë në formë dhe përmbajtje të pranueshme nga Pengmarrësit në lidhje me kryerjen e regjistrimeve sa më sipër. Nëse Pengdhënësi nuk kryen regjistrimin sipas kushteve të vendosura nga Pengmarrësit, ose nëse Pengmarrësit me diskrecionin e tyre të lirë vendosin që ta kryejnë vetë regjistrimin ose nëpërmjet ekspertëve të jashtëm të zgjedhur nga ata,

Pengdhënësi nuk çlirohet nga detyrimi për të mbuluar shpenzimet për kryerjen e regjistrimit. Shpenzimet për këtë regjistrim, do të mbulohen në çdo rast nga Pengdhënësi, sa më shpejt të jetë e mundur pas kërkesës së Përfaqësuesit të Palëve Financuese. Pengdhënësi detyrohet të kryejë regjistrimet përkatëse edhe në Qendrën Kombëtare të Biznesit me shpenzimet e veta dhe brenda afateve ligjore.

(b) Barra me Radhë Preference të Parë. Pengdhënësi do t'i mbajë të drejtat e Pengmarrësve në bazë të kësaj Kontrate si Barrë me preferencë të radhës së parë, duke mbizotëruar mbi të drejtat e çdo kreditori tjetër të tashëm apo të ardhshëm të Pengdhënësit.

(c) Dhënie Informacioni. Me kërkesë të Përfaqësuesit të Palëve Financuese, do të japë me shkrim çdo informacion që mund t'i kërkohet në lidhje me Kuotat.

(d) Veprime të Tjera. Me kërkesë të Përfaqësuesit të Palëve Financuese, Pengdhënësi do të kryejë të gjitha veprimet e nevojshme si dhe do të firmosë çdo dokument apo akt, me qëllim që të ruajë të pacënuar regjistrimin e Pengut të krijuar në bazë të kësaj Kontrate në favor të Pengmarrësve dhe në përgjithësi t'i japë efekt të plotë të gjitha të drejtave që kjo Kontratë u jep Pengmarrësve, përfshirë, pa kufizim:

(1) kompletimin dhe mbajtjen në fuqi të plotë të Pengut mbi Kuotat;

(2) vendosjen e Pengut në favor të Pengmarrësve mbi të gjitha Kuotat e ardhshme dhe Të Drejtat e Lidhura me to të nënshkruara nga Pengdhënësi;

(3) t'i mundësojë Pengmarrësve të ushtrojnë të drejtat dhe mjetet juridike që ai ka të drejtë në përputhje me këtë Kontratë, duke përfshirë, pa kufizime, të gjitha të drejat dhe mjetet juridike të ushtrueshme pas ndodhjes së një Rasti Mospërmbushjeje; dhe/ose

(4) të ndryshojë statutin e Pengdhënësit dhe/ose Kredimarrësit për të reflektuar sa më mirë të drejtat e Pengmarrësve në bazë të kësaj Kontrate.

(e) Kuota e Lirë nga Barrët. Pengdhënësi do të mbajë Kuotat të lira nga çdo Barrë (me përjashtim të atyre për të cilat Pengmarrësit kanë dhënë pëlqimin me shkrim, përfshirë Pengun sipas kësaj Kontrate).

(f) Ndalime të Ndryshme. Pengdhënësi nuk do të kryejë asnjë veprim material apo juridik, Barrësimi, disponimi ndarje, bashkimi, përthithje, shndërrimi, pjesëtimi, transferimi, tjetërsimi apo cedimi të drejtave mbi Kuotat ose çdo të Drejte të Lidhur me to (përfshirë këtu asetet dhe/ose aktivitetin e shoqërisë dhe/ose zmadhimin e kapitalit që mund të ndikojë në zvogëlimin e pjesëmarrjes së Pengmarrësve në kapital) në asnjë lloj forme apo mënyre, pa miratim e mëparshëm me shkrim të Pengmarrësve.

(g) Pretendimet apo të Metat. Do të njoftojë menjëherë Përfaqësuesin e Palëve Financuese në rast se ka apo vihet në dijeni të një Pretendimi kundrejt Kuotave apo/dhe nëse një masë kufizimi vendoset mbi Kuotat, apo/dhe një e metë materiale apo juridike mund të cenojë të drejtën e Barrës së Pengmarrësve. Pengdhënësi do të ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme për t'i shmangur ato Pretendime, kufizime, apo të meta duke ruajtur dhe mbajtur të pacënuar regjistrimin e kësaj Kontrate në favor të Pengmarrësve.

(h) Shpenzimet të Pengdhënësit. Pengdhënësi nuk do të ngarkojë Pengmarrësit me asnjë nga shpenzimet per regjistrimin apo mbajtjen e pacënuar të regjistrimit të Pengut në favor të Pengmarrësve në Qendrën Kombëtare të Biznesit.

(i) Garanci per Shpenzimet. Pengu mbi Kuotat, përveç Detyrimeve do të garantojë edhe pagesën apo rimbursimin e të gjitha shpenzimeve gjyqësore, shpenzimet per ekzekutimin e detyrueshëm të Detyrimeve nëpërmjet procedurave për ekzekutimin e detyrueshëm, shpërblimin e Dëmit të shkaktuar nga vonesa e ekzekutimit, shpenzimet e kryera nga Pengmarrësit për regjistrimin e Pengut në Qendrën Kombëtare të Biznesit (nëse regjistrimi është bërë nga Pengdhënësit), shpenzimet për sigurimin e Kuotave, komisionet bankare dhe të raportit te vlerësimit, si dhe çdo detyrim tjetër të Palëve Garantuese dhe/ose Pengdhënësit që burojnë nga Kontrata e Kredisë dhe/ose kjo Kontratë dhe/ose Legjislacioni i Zbatueshëm.

(j) Zëvendësimi në Rast Cënimi. Në rast se Pengmarrësve u cenohet e drejta e Pengut sipas kësaj Kontrate, për çfarëdolloj arsye, në mënyrë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë, qoftë pjesërisht apo edhe tërësisht, atëherë Pengdhënësi do të jetë i detyruar me kërkesën e Pengmarrësve, të zëvëndësojë të drejtën e cënuar të Pengut me një Garanci shtesë të kënaqshme për Pengmarrësit si dhe brenda afatit të vendosur nga këta të fundit.

(k) Njoftime për Pengmarrësit. Pengdhënësi do të njoftojë Pengmarrësit menjëherë për çdo informacion të rëndësishëm në lidhje me Kuotat, përfshirë, pa u kufizuar në:

(1) çdo ndryshim në të dhënat identifikuese të Pengdhënësit ose të shoqërisë, pjesë të Kuotave të së cilës përbëjnë Pengun;

(2) ekzistencën e çdo fakti të pranishëm apo të mundshëm që mund të shkaktojë:

(i) pamundësinë e likuidimit të Kuotave;

(ii) vështirësi për ekzekutimin e të drejtave të Kredidhënësve ndaj Kuotave; ose

(iii) Rast Mospërmbushjeje.

(l) Ushtrimi i të Drejtës së Votës. Gjatë gjithë kohëzgjatjes së kësaj Kontrate Pengdhënësi do t'i ushtrojë të drejtat e votës në mënyrë të tillë që Pengdhënësi të mos marrë asnjë vendim i cili (i) nuk do të ishte në përputhje me parashikimet e kësaj Kontrate; (ii) do të ndikonte negativisht në vlefshmërinë apo ekzekutimin e Pengut; (iii) nuk do të ishte në përputhje ose do të ishte në kundërshtim me parashikimet në Kontratën e Kredisë; (iv) do të pengonte ushtrimin e të drejtave të Pengmarrësve të cilat lindin nga/ose në lidhje me këtë Kontratë.

Neni 4.03 Të Drejtat e Pengmarrësve

(a) E Drejta e Dokumentacionit. Pengmarrësit kanë të drejtë të tërheqin nga Qendra Kombëtare e Biznesit vërtetimin përkatës, si dhe çdo dokument tjetër që lidhet me Kuotat mbi të cilat është vendosur Pengu në favor të Pengmarrësve në bazë të kësaj Kontrate (si vërtetime mbi gjendjen juridike etj.).

(b) E Drejta e Informacionit. Pengmarrësit kanë të drejtë të marrin të gjitha informacionet dhe dokumentacionin që në gjykimin e tyre është i dëshirueshëm dhe/ose të nevojshëm në lidhje me Kuotat, që të sigurohen për zbatimin e të drejtave të tyre në bazë të kësaj Kontrate.

(c) Ushtrimi i të Drejtave të Pengmarrësve. Në qoftë se Pengdhënësi ndodhet në rrethanat e një Rasti Mospërmbushjeje, nëpërmjet Përfaqësuesit të Palëve Financuese, Pengmarrësit kanë të drejtë të ushtrojnë të gjitha të drejtat që i lindin atyre në bazë të dispozitave të përshkruara te Neni 6.02 (*Pasojat e Rastit të Mospërmbushjes*) i kësaj Kontrate, pa pasur nevojën e ndonjë miratimi, autorizimi apo veprimi tjetër të Pengdhënësit.

(d) Shpenzimet. Çdo shpenzim gjyqësor ose jashtëgjyqësor që bëjnë Pengmarrësit lidhur me këtë Kontratë, do të jetë në ngarkim të Pengdhënësit dhe sigurohet edhe nga Pengu.

Neni 4.04 Detyrimet e Pengmarrësve

(a) Posedimi i Lirë nga Pengdhënësi. Pengmarrësit nuk do të cenojnë Pengdhënësin në posedimin e tij mbi Kuotat, përveç kur parashikohet ndryshe në këtë Kontratë.

(b) Respektimi i të Drejtave. Pengmarrësit do të respektojnë të drejtat e Pengdhënësit bazuar në dispozitat e kësaj Kontrate dhe në dispozitat e Legjislacionit të Zbatueshëm.

(c) Të Dhënat Personale. Pengmarrësit garantojnë se përpunimi i të dhënave të Pengdhënësit do të menaxhohet nga stafi teknik i zyrës përgjegjëse për trajtimin e të dhënave personale dhe do të bëhet në përputhje me mënyrat e parashikuara nga Ligji Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

KREU 5. DEKLARIMET DHE GARANCITË

Neni 5.01 Deklarimet dhe Garancitë e Palëve

Palët deklarojnë dhe garantojnë se në Datën e Nënshkrimit dhe në datën e secilit nga Disbursimet:

(a) Themelimi dhe Mbarëvajtja. Palët janë themeluar, vazhdojnë të ekzistojnë, kanë tagër dhe autoritet të plotë juridik, nuk kanë hyrë në procedurë falimentimi, si dhe kanë përmbushur detyrimet ligjore në përputhje me Legjislacionin e Zbatueshëm. Palët zotërojnë të gjitha licensat, lejet, autorizimet dhe aprovimet e nevojshme që i duhen që të ushtrojnë veprimtarinë e tyre siç po e ushtrojnë, përveç atyre licensave, lejeve, autorizimeve dhe aprovimeve, mungesa e të cilave, veç e veç apo në tërësi, nuk kanë pasur dhe nuk pritet që në mënyrë të arsyeshme të kenë një Ndryshim Përkeqësues Thelbësor në aftësinë për të përmbushur detyrimet e tyre sipas kësaj Kontrate.

(b) Autoriteti; Nënshkrimi dhe Dorëzimi; Zbatimi. Secila nga Palët ka tagër dhe autoritet të plotë juridik për të nënshkruar këtë Kontratë dhe për të kryer transaksionet e përmendura në të. Nënshkrimi i Kontratës, dorëzimi i saj i nënshkruar Palës tjetër si dhe kryerja e transaksioneve të përmendura në këtë Kontratë, janë të autorizuara në mënyrë të rregullt nga të gjitha aktet e

nevojshme të secilës prej Palëve. Secila nga Palët e ka nënshkruar dhe ia ka dorëzuar Palës tjetër këtë Kontratëtë nënshkruar sipas rregullave dhe kjo Kontratë përbën detyrim të vlefshëm, të ligjshëm, të detyrueshëm dhe të zbatueshëm të secilës Palë në përputhje me kushtet dhe detyrimet që përmban Kontrata dhe Legjislacioni i Zbatueshëm.

(c) Mungesa e Konflikteve apo Nevojës për Miratime. Përveç parashikimeve te Neni 5.01(h) (*Alternativë e Pavarur*) më poshtë, nënshkrimi i kësaj Kontrate nga secila nga Palët, si edhe kryerja e transaksioneve të përmendura në të dhe zbatimi i kushteve dhe detyrimeve të saj nuk shkaktojnë ndonjë shkelje, apo nuk shkaktojnë nevojën që të ushtrohet e drejta për të përfunduar, anuluar, apo për të përshpejtuar plotësimin e ndonjë detyrimi, nuk sjellin humbje të përfitimeve materiale, apo nuk rezultojnë në krijimin e ndonjë Barre mbi Kuotat, përveç Pengut të parashikuar sipas kësaj Kontrate, për shkak të konfliktit me ndonjë dispozitë të (i) marrëveshjeve, licensave apo çfarëdo prej angazhimeve të tjera të detyrueshme ligjore ku secila nga Palët është palë, (ii) ndonjë urdhër administrativ apo vendim gjykate (në vijim "**Gjykim**") ose (iii) Legjislacionin e Zbatueshëm. Secilës nga Palët nuk i kërkohet të marrë, apo të aplikojë për të marrë, ndonjë miratim, leje, aprovim, licencë, urdhër, apo autorizim nga ndonjë Entitet Qeveritar lidhur me nënshkrimin, dorëzimin si dhe përmbushjen e detyrimeve të kësaj Kontrate, përveç atyre aprovimeve apo autorizimeve që janë specifikuar shprehimisht në këtë Kontratë.

(d) Vërtetësia e Deklarimeve. As kjo Kontratë dhe as ndonjë deklaratë, raport, ose dokument i shkruar, i përgatitur dhe i paraqitur, ose që duhet përgatitur dhe paraqitur nga secila nga Palët, sipas kësaj Kontrate ose në lidhje me transaksionet e kryera si pasojë e saj, nuk përmban ndonjë deklarim, apo nuk lë pa përmendur fakte materiale të domosdoshme, prania ose mungesa e të cilave do t'i bënte këto deklarata, raporte apo dokumenta të pasakta apo të pavërteta.

(e) Nuk ka dijeni për Deklarata të Pasakta. Secila nga Palët nuk ka dijeni që ndonjë nga deklarimet, garancitë apo premtimet e bëra nga vetë Pala apo nga Pala tjetër në këtë Kontratë mund të mos jenë të vërteta apo të sakta.

(f) Mungesa e Shkakut që Sjell Pavlefshmërinë. Secila nga Palët nuk ka dijeni për ndonjë shkak që mund të sjellë pavlefshmërinë e Kontratës apo ndonjë neni të saj.

(g) Mungesa e Konflikteve. Secila nga Palët deklaron se në dijeninë e saj nuk ka asnjë Gjykim, veprim, procedurë apo hetim në ndonjë gjykatë apo institucion tjetër (i) që mund ta ndalojë atë të nënshkruajë këtë Kontratë, (ii) që ka qëllim ndalimin e kryerjes së veprimeve që janë objekt i kësaj Kontrate, ose (iii) që mund të ndalojë apo që mund të ndikojë thelbësisht dhe negativisht në përmbushjen e detyrimeve të një Pale sipas kësaj Kontrate, ose vlefshmërinë dhe zbatueshmërinë e saj.

(h) Alternativë e Pavarur. Palët deklarojnë dhe bien dakord që, megjithëse në Datën e Nënshkrimit ato kanë nënshkuar dy kontrata, një marrëveshje siguruese dhe një marrëveshje kolaterali financiar ma anë të cilës Pengdhënësi i ka dhënë Pengmarrësve Peng mbi Kuotat, ekzistenca e atyre Kontratave nuk përbën shkelje të dispozitave të kësaj Kontrate. Për më tepër, Pengdhënësi kupton dhe bie dakord që, nëse do të ndodhë një Rast Mospërmbushjeje, është krejtësisht në diskrecionin e lirë e të vetëm të Përfaqësuesit të Palëve Financuese që të zgjedhë se

si do t'i ekzekutojë të drejtat e Pengmarrësve mbi Kuotat, nëpërmjet kësaj Kontrate apo nëpërmjet Kontratës Siguruese.

Neni 5.02 Deklarimet dhe Garancitë e Pengdhënësit

Pengdhënësi deklaron dhe garanton se në Datën e Nënshkrimit dhe në datën e secilit nga Disbursimet:

(a) Pronar me të Drejta të Plota. Pengdhënësi është pronar me të drejta të plota mbi Kuotat dhe ka të drejtë t'i përdorë Kuotat si Garanci duke vendosur Peng mbi to.

(b) Kuotat e Lira nga Barrët. Përveç sa parashikohet shprehimisht në këtë Kontratë, Kuotat janë të lira nga çdo lloj Barre tjetër.

(c) Radhë e Parë. Të drejtat e Pengmarrësve mbi Kuotat mbizotërojnë mbi të drejtat e çdo kreditori tjetër të Pengdhënësit.

KREU 6. RASTET E MOSPËRMBUSHJES

Neni 6.01 Rastet e Mospërmbushjes

Krahas Rasteve të Mospërmbushjes të parashikuara si të tilla në Kontratën e Kredisë, do të konsiderohen si Rast Mospërmbushjeje edhe rastet si më poshtë vijon:

(a) Shkelje e Deklaratave dhe Garancive. Pengdhënësi është në shkelje të një apo të gjitha deklarimeve dhe garancive të bëra, por pa u kufizuar te Neni 5.01 (*Deklarimet dhe Garancitë e Palëve*) dhe Neni 5.02 (*Deklarimet dhe Garancitë e Pengdhënësit*) të kësaj Kontrate, apo ndonjë prej këtyre deklarimeve dhe garancive rezultojnë të jenë të pasakta dhe të paplota.

(b) Mosrespektim i Detyrimeve. Pengdhënësi nuk respekton parashikimet te Neni 4.02 (*Detyrimet e Pengdhënësit*) i kësaj Kontrate, për çfarëdolloj arsyeje, përfshirë, pa u kufizuar në, për shkak të një Gjykimi.

(c) Pretendime nga Persona të Tjerë. Një Person tjetër ka një Pretendim mbi Kuotat dhe ndërmerr hapa që mund të sjellin një Ndryshim Përkeqësues Thelbësor.

(d) Gjykim mbi Palët Garantuese. Nëse ka një Gjykim mbi Palët Garantuese që mund të sjellë një Ndryshim Përkeqësues Thelbësor.

(e) Zgjidhja e Kontratës së Kredisë. Kredidhënësit kanë vendosur zgjidhjen e Kontratës së Kredisë të lidhur me Kredimarrësin dhe Palëve Garantuese për shkaqe që lidhen me shkelje të saj nga Palët Garantuese.

(f) Rrezik. Në qoftë se, sipas mendimit të Pengmarrësve, dhe mbi baza tregtare të arsyeshme, Pengu rrezikohet ose mund të vihet në rrezik.

(g) Mospërmbushja e Tërthortë. Nëse Palët Garantuese dështojnë të shlyejnë një prej Detyrimeve të parashikuara në Dokumentet e Financimit sipas parashikimeve përkatëse ose dështon të përmbushë ndonjë detyrim tjetër të lidhur me garantimin e Kontratës së Kredisë, kjo do të konsiderohet mospërmbushje e tyre për të gjitha Detyrimet e parashikuara në të gjitha Dokumentet e Financimit ku janë palë, përfshirë, pa u kufizuar, këtë Kontratë.

Neni 6.02 Pasojat e Mospërmbushjes

Në rrethanat e një Rasti Mospërmbushjeje, Përfaqësuesi i Palëve Financuese, në emër të Pengdhënësve, mund të ushtrojë secilën nga të drejtat si më poshtë, veç e veç apo së bashku:

(a) E Drejta e Përfitimit të Dividendëve. Pengdhënësi jep shprehimisht pëlqimin se, me ndodhjen e një Rasti Mospërmbushjeje dhe marrjen e një njoftimi nga Përfaqësuesi i Palëve Financuese, Pengmarrësit do të kenë të drejtë - pa asnjë miratim, autorizim, urdhër ekzekutimi, Gjykim, apo veprim tjetër - të përftojnë të gjithë të ardhurat dhe përfitimet që rrjedhin nga Pengu, përfshirë, pa u kufizuar, Të Drejtat e Lidhura, dhe çdo shumë të arkëtueshme tjetër që lidhet me Pengun dhe, në vijim, të kreditojë të ardhurat neto kundrejt Detyrimeve. Nga data e marrjes së njoftimit te sipërpërmendur Pengdhënësi zotohet të mos kryejë asnjë pagesë per dividendë, si dhe çdo shumë tjetër të paguar ose të pagueshme në lidhje me Kuotat, pa miratimin e Pengmarrësve.

(b) Ushtrimi i Kontrollit në Rast Mospërmbushje. Kur ndodh një Rast Mospërmbushjeje, Përfaqësuesi i Palëve Financuese mund të ushtrojë të drejtën për kontrollin efektiv të Pengdhënësit në përputhje me Nenin 6.03 (*Ushtrimi i Kontrollit mbi Kredimarrësin*) të Marrëveshjes së Drejtpërdrejtë.

(c) E Drejta për Sekuestrimin dhe Shitblerjen e Pengut. Kur ndodh një Rast Mospërmbushjeje, Pengmarrësit, pa paragjykuar të drejtat e tjera që ata kanë sipas kësaj Kontrate apo marrëveshjeve të tjera që Palët kanë nënshkruar dhe/ose Legjislacionit të Zbatueshëm, gëzojnë të drejtën për sekuestrimin e Pengut dhe shitblerjen e tij sipas parashikimeve te KREU 7 (*Ekzekutimi i Pengut*) i kësaj Kontrate.

(d) Maturimi i Përshpejtuar. Kur ndodh një Rast Mospërmbushjeje, nga çasti i ngjarjes së kësaj rrethane mospërmbushjeje dhe në çdo kohë më pas, Përfaqësuesi i Palëve Financuese (i) ka të drejtë të kërkojë pagimin e një pjese apo të gjithë Detyrimeve brenda 10 (dhjetë) Ditësh Pune nga njoftimi i bërë për këtë qëllim, pavarësisht nëse këto Detyrime janë maturuar ose jo dhe/ose (ii) zgjidhjen e njëanshme të Kontratës së Kredisë.

KREU 7. EKZEKUTIMI I PENGUT

Neni 7.01 Njoftimi për Ekzekutim

Në kushtet e një Rasti Mospërmbushjeje, në përputhje me Nenet 556-559 të Kodit Civil, Përfaqësuesi i Palëve Financuese do të njoftojë Pengdhënësin që planifikon të fillojë procedurat e ekzekutimit të detyrueshëm për Pengun. Ky njoftim do të bëhet brenda 10 (dhjetë) Ditësh Pune nga marrja dijeni për Rastin e Mospërmbushjes.

Neni 7.02 Shitja e Pengut

(a) Shitja e Kuotave. Për shitjen e Kuotave, Pengmarrësit do të kryejnë proceduratë e parashikuara në nenet 556-559 të Kodit Civil, për aq sa këto dispozita janë të zbatueshme për këtë natyrë shitjeje dhe për sa kohë nuk është parashikuar ndryshe në këtë Kontratë, kur Legjislacioni i Zbatueshëm e lejon.

(b) Personi i Përshtatshëm si Blerës. Palët bien dakord që, në përputhje me Nenin 6.06 (*Transferimi i Kuotave të Kredimarrësit te Personi i Përshtatshëm*) të Marrëveshjes së Drejtpërdrejtë, Pengdhënësi do t'ia transferojë Pengun Personit të Përshtatshëm, nëse i kërkohet nga Përfaqësuesi i Palëve Financuese.

(c) Kredidhënësit si Blerës. Palët bien dakord që Pengmarrësit mund t'i blejnë Kuotat ose një pjesë të tyre sipas parashikimeve në Legjislacionin e Zbatueshëm.

Neni 7.03 Përdorimi i të Ardhurave

Kur ndodh një Rast Mospërmbushjeje, Pengdhënësi autorizon shprehimisht dhe në mënyrë të parevokueshme Pengmarrësit që, pa patur nevojë për miratim apo njoftim shtesë, të paguajnë në rrugë jashtëgjyqësore, dhe të ndërmarrin të gjitha veprimet e nevojshme apo të dëshirueshme në lidhje me ripagimin e, Detyrimeve dhe te gjitha shpenzimeve, qofshin gjyqësore ose jo, në përputhje me Legjislacionin e Zbatueshëm, duke i mbajtur nga fondet e krijuara nga shitja e Kuotave apo përfitimi i Të Drejtave të Arkëtuesheme.

KREU 8. DËMSHPËRBLIMI

Neni 8.01 Dëmshpërblimi

Në përputhje me dispozitat e kësaj Kontrate, secila nga Palët (në cilësinë e saj si palë zhdëmtuese, në vijim "**Pala Dëmshpërblyese**") pranon të dëmshpërblejë Palën tjetër (në cilësinë e saj si palë e dëmshpërblyer, në vijim "**Pala e Dëmshpërblyer**") dhe ta mbrojë atë nga çdo Dëm i shkaktuar, drejtpërdrejt apo tërthorazi, që bazohet në, lind nga, apo rrjedh prej, pa u kufizuar në, mospërmbushjen nga Pala Dëmshpërblyese të detyrimeve, deklarimeve, garancive, kushteve apo të premtimeve të parashikuara në këtë Kontratë, me kusht që, në rastin e Pengmarrësve, mospërmbushjet vijnë si rezultat i një pakujdesie të rëndë apo dashjes. Në të gjitha rastet, Pengdhënësi bie dakord që përgjegjësia e mundshme e Pengmarrësve është e pjesëtueshme dhe josolidare.

Neni 8.02 Pretendime nga Palë të Treta

(a) Mbrojtje nga Pala Dëmshpërblyese. Menjëherë pas (i) marrjes dijeni të ndonjë fakti, ndodhie ose ngjarjeje që mund të rezultojë në një Pretendim në bazë të kësaj Kontrate, ose (ii) marrjes së një njoftimi për ndonjë Pretendim nga një Person palë e tretë ndaj Palës së Dëmshpërblyer, Pala e Dëmshpërblyer do të njoftojë me shkrim Palën Dëmshpërblyese për natyrën dhe bazën e Pretendimit. Pala Dëmshpërblyese ka të drejtë të bëjë mbrojtjen nga Pretendimi me shpenzimet e saj dhe duke përzgjedhur këshilltarët e saj, të cilët duhet të jenë të pranueshëm dhe për Palën e Dëmshpërblyer, me kusht që (x) brenda 30 ditëve pas marrjes së njoftimit nga Pala e Dëmshpërblyer, Pala Dëmshpërblyese e njofton Palën e Dëmshpërblyer që

do ta bëjë këtë mbrojtje, dhe (v) Pala Dëmshpërblyese nuk mund të nënshkruajë ndonjë Kontratë pajtimi me palën pretenduese pa miratimin e Palës së Dëmshpërblyer.

(b) Mbrojtje nga Pala e Dëmshpërblyer. Në rast se Pala Dëmshpërblyese refuzon të marrë përsipër mbrojtjen ndaj Pretendimit (i) Pala e Dëmshpërblyer do të mbrohet vetë kundër Pretendimit dhe (ii) Pala Dëmshpërblyese do të mbetet përgjegjëse për çdo Dëm të drejtpërdrejtë apo të tërthortë që mund t'i vijë Palës së Dëmshpërblyer si rezultat i Pretendimit. Pavarësisht se cila Palë do të marrë përsipër mbrojtjen ndaj Pretendimit, secila Palë do t'i vendosë në dispozicion Palës tjetër, pas kërkesës së saj, të gjitha informacionet dhe dokumentacionin e arsyeshëm dhe të nevojshëm për të mbështetur procesin e mbrojtjes ndaj Pretendimit, si dhe për të verifikuar çdo Dëm që shkaktohet nga Pretendimi.

KREU 9. HYRJA NË FUQI DHE PËRFUNDIMI I KONTRATËS

Neni 9.01 Hyrja në Fuqi e Kontratës

Kjo Kontratë hyn në fuqi në Datën e Nënshkrimit.

Neni 9.02 Momenti i Përfundimit të Kontratës

(a) Kjo Kontratë do të mbetet në fuqi deri në momentin e shlyerjes së plotë të Detyrimeve kundrejt Pengmarrësve, dhe detyrimeve të tjera sipas Kontratës së Kredisë si dhe të çdo detyrimi tjetër të lidhur me garantimin e Kredisë dhe/ose detyrimit të kësaj Marreveshjeje.

(b) Pas shlyerjes së Detyrimeve te parashikuara në paragrafin (a) më sipër, Pengdhënësi do i drejtohet me shkrim Përfaqësuesit të Palëve Financuese duke njoftuar pagimin e plotë të tyre.

(c) Përfaqësuesi i Palëve Financuese pasi verifikon shlyerjen e Detyrimeve, brenda 10 (dhjetë) Ditësh Pune firmos dokumentat e nevojshme për fshirjen e Pengut nga Qendra Kombëtare e Biznesit. Heqja e regjistrimit të Pengut sipas këtij neni, konsiderohet dhe momenti i përfundimit të kësaj Kontrate.

Neni 9.03 Mbijetesa e Dispozitave të Kontratës pas Përfundimit

Pavarësisht përfundimit të Kontratës, dispozitat te Neni 8.01 (*Dëmshpërblimi*), KREU 10 (*Zgjidhja e Mosmarrëveshjeve*), Neni 11.01(b) (*Autorizimi për Përdorimin e Informacionit Konfidencial*) të kësaj Kontrate do të mbijetojnë dhe do të vazhdojnë të jenë në fuqi edhe pas përfundimit të Kontratës sipas dispozitave të parashikuara te Neni 9.02 (*Momenti i Përfundimit të Kontratës*).

KREU 10. ZGJIDHJA E MOSMARRËVESHJEVE

Neni 10.01 Mjetet Ligjore të Pengdhënësit

(a) Në rast se Pengdhënësi vlerëson se Përfaqësuesi i Palëve Financuese apo Pengmarrësit e tjerë veprojnë në shkelje të kësaj Kontrate, duhet të njoftojë menjëherë

Përfaqësuesin e Palëve Financuese për këtë fakt, në formën e parashikuar te Neni 11.01(*Njoftimet*) i kësaj Kontrate.

(b) Pengdhënësi dhe Përfaqësuesi i Palëve Financuese do të zhvillojnë bisedime me mirëkuptim për një periudhë jo më të gjatë se 30 (tridhjetë) Ditë Pune nga data e njoftimit. Në rast se Palët nuk bien dakord për ndreqjen e shkeljeve të pretenduara nga Pengdhënësi, atëherë Pengdhënësi ka të drejtë të ngrejë padi në gjykatën kompetente pasi afati 30 (tridhjetë) ditor i zhvillimit të bisedimeve ka përfunduar.

Neni 10.02 Mjetet Ligjore të Pengmarrësve

Në Rast Mospërmbushjeje, përveç të drejtave dhe mjeteve ligjore që parashikohen në Legjislacionin e Zbatueshëm, Përfaqësuesi i Palëve Financuese duhet të njoftojë Pengdhënësin, i cili ka 30 (tridhjetë) Ditë Pune afat të zgjidhë mospërmbushjen, në formën e parashikuar te Neni 11.01 (*Njoftimet*) i kësaj Kontrate, përsa vijon:

(a) Duhet të paguajë të gjitha Detyrimet, duke përfshirë detyrimin e siguruar me Peng dhe të arkëtojë të gjithë borxhin që i detyrohet, përfshirë shpenzime të arsyeshme për kostot e gjykatës, të avokatëve dhe shpenzime të tjera ligjore; si dhe

(b) Pengmarrësit gëzojnë të drejtat e parashikuara te KREU 7 (*Ekzekutimi i Pengut*) i kësaj Kontrate për të siguruar përmbushjen e Detyrimeve të Pengdhënësit.

Neni 10.03 Zgjidhja e Mosmarrëveshjeve

Palët do të përpiqen në mënyrë të arsyeshme që çdo mosmarrëveshje mes tyre të zgjidhet me mirëkuptim. Në rast se mirëkuptimi nuk mund të arrihet, secila nga Palët do t'i drejtohet Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Neni 10.04 Legjislacioni i Aplikueshëm

Kjo Kontratë do të zbatohet dhe do të interpretohet në përputhje me Legjislacionin e Zbatueshëm të Republikës së Shqipërisë.

KREU 11. TË NDRYSHME

Neni 11.01 Autorizime

(a) Autorizimi për Regjistrime. Pengdhënësi autorizon Përfaqësuesin e Palëve Financuese, që, në rast se e gjykon të arsyeshme, në emër të dhe me shpenzimet e Pengdhënësit të regjistrojë formularët e njoftimit të regjistrimit dhe/ose dokumenta të tjerë në Qendrën Kombëtare të Biznesit (apo regjistra dhe regjistrarë të tjerë nëse një rregjistrim i tillë është i dëshirueshëm apo i nevojshëm) dhe të ndërmarrë të gjitha veprimet që Pengmarrësit mund të mendojnë se janë të nevojshme për të kompletuar dhe vazhduar kompletimin e Pengut, për të mbrojtur dhe ruajtur Pengun dhe për ta ekzekutuar atë.

(b) Autorizimi për Përdorimin e Informacionit Konfidencial. Në zbatim të nenit 127 të Ligjit nr. 9662, datë 18.12.2006 "Për Bankat në Republikën e Shqipërisë", Vendimit nr. 67 datë 13.10.2010 "*Për Miratimin e Rregullores "Për Përmbajtjen e Informacionit dhe Funksionimin e Regjistrit të Kredive në Bankën e Shqipërisë*" të miratuar nga Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë, dhe Ligjit Nr. 9887, datë 10.03.2008 "*Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale*", Pengdhënësi, nëpërmjet nënshkrimit të kësaj Kontrate Pengu, duke pranuar se (i) të dhënat demografike dhe financiare të ruajtura në Regjistrin e Kredive të Bankës së Shqipërisë do të trajtohen nga Pengmarrësit në përputhje me Legjislacionin e Zbatueshëm, dhe (ii) Pengmarrësit, Shoqëritë Mëmë të tyre si dhe Regjistri i Kredive të Bankës së Shqipërisë kanë marrë të gjitha masat e nevojshme për të garantuar trajtimin e sigurt të të dhënave të Pengdhënësit, autorizon në mënyrë të parevokueshme Pengmarrësit që për qëllim (ndër të tjera) të vlerësimit të përshtatshmërisë së Pengdhënësit për të marrë përsipër dhe zbatuar detyrimet e tij në bazë të kësaj Kontrate dhe aftësisë së Pengmarrrësve për të qenë në përputhje me kërkesat e ndryshme rregullatore që i aplikohen atyre:

(1) të njihet me detyrimet e Pengdhënësit ndaj bankave/degëve të bankave të huaja/subjekteve kredidhënëse, nëpërmjet përpunimit të autorizuar të të dhënave/informacionit të Regjistrit të Kredive;

(2) të përdorin emrin dhe të dhënat identifikuese dhe financiare të Pengdhënësit që mbahen në Regjistrin e Kredive, për kryerjen e raportimeve standarde dhe të detyrueshme në Regjistrin e Kredive të Bankës së Shqipërisë.

(3) të transferojnë dhe të trajtojnë të gjitha të dhënat personale dhe financiare të tij (më poshtë referuar si "**Informacioni Konfidencial**") me dhe tek Shoqëritë Mëmë të tyre, nëse dhe sa herë që kërkohen nga Shoqëritë Mëmë përkatëse dhe që të kenë akses, të përdorin dhe të trajtojnë Informacionin Konfidencial që Pengmarrësit zotërojnë ose marrin në zotërim nga Regjistri i Kredive të Bankës së Shqipërisë.

Neni 11.02 Transferimi, Cedimi, Zëvendësimi, Pasojat dhe mbi Pasardhësit

(a) Pengdhënësi. Pengdhënësi nuk mund ta transferojë, cedojë, ndryshojë apo kalojë të drejtat dhe detyrimet e kësaj Kontrate te asnjë Person, përveç se në përputhje me parashikimet te Neni 4.02(f) (*Ndalimi për Tjetërsimin*) i kësaj Kontrate. Gjithsesi, Pengdhënësi do të sigurohet që Pegu i vendosur mbi Kuotat në bazë të kësaj Kontrate do t'i shtrijë efektet e tij edhe do të transferohet bashkë me Pengun dhe te pasardhësit e Pengdhënësit, të cilët do të jenë gjithashtu të detyruar të respektojnë të drejtat e kësaj Kontrate.

(b) Pengmarrësit. Të drejtat që Pengmarrësit kanë në bazë të kësaj Kontrate janë lirisht të transferueshme dhe do kalojnë dhe te zëvendësuesit apo pasardhësit e tyre, në përputhje me Dokumentet e Financimit.

Neni 11.03 Palët e Treta nuk Përfitojnë të Drejta

Kjo Kontratë është lidhur vetëm mes Palëve dhe mund të zbatohet vetëm prej tyre. Kjo Kontratë nuk mund të interpretohet në asnjë rast se krijon të drejta për ndonjë palë të tretë, përfshirë punonjësit, agjentët, përfaqësuesit, kontraktorët, furnizuesit ose konsumatorët e një

Pale. Një Person i cili nuk është Palë në këtë Kontratë nuk gëzon asnjë të drejtë sipas kësaj Kontrate.

Neni 11.04 Veçueshmëria e Interesave Pasurore

Pengdhënësi bie dakord dhe pranon shprehimisht se kjo Kontratë është një garanci, e veçuar nga çdo Garanci tjetër qe është dhënë ose do të jepet nga Palët Garantuese në favor të Pengmarrësve për sigurimin e shlyerjes së Detyrimeve. Pengdhënësi bie dakord që Pengmarrësit mund të ushtrojnë të drejtat e tyre sipas kësaj Kontrate, pavarësisht nga të drejtat e tyre sipas ndonjë Garancie tjetër në bazë të Dokumentave të Garancisë.

Neni 11.05 Njoftimet

(a) Metoda e Njoftimit. Njoftimet dhe çdo lloj tjetër komunikimi në lidhje me këtë Kontratë do të jetë me shkrim dhe në gjuhën shqipe dhe duhet të bëhet në përputhje me këtë nen. Njoftimi do të bëhet: (i) duke e dorëzuar personalisht, me kundërfirmë; ose (ii) dërguar me postë të parapaguar me konfirmim dorëzimi nga Pala marrëse në adresën e përcaktuar ne këtë Kontratë, apo ndonjë adresë tjetër të specifikuar nga Pala përkatëse. Në shtesë të sa më lart, po pa u konsideruar njoftim, Palët do t'i dërgojnë njoftimet e tyre me e-mail (në adresën e përcaktuar më poshtë), dhe në çdo rast e adresuar qartësisht për vëmendjen e Palës përkatëse.

(b) Koha e Njoftimit. Çdo njoftim, i dërguar sipas mënyrave të mësipërme do të konsiderohet si i dorëzuar sipas rregullave dhe në kohën e specifikuar si më poshtë:

(1) Në rastin e dërgimit dorazi, kur dorëzimi kryhet te përfaqësuesit e Palës marrëse gjatë Ditës së Punës dhe dorëzimi është pranuar me shkrim nga Pala;

(2) Në rastin e njoftimit me postë të parapaguar, në mungesë të provave që njoftimi është marrë më parë, njoftimi konsiderohet i dhënë, nëse është dërguar me postë, 5 (pesë) Ditë Pune pas postimit;

(c) Adresa e Njoftimit. Adresat ku Palët mund të njoftojnë njëra-tjetrën janë si më poshtë:

(1) Drejtuar Pengdhënësit:

Rruga "Ibrahim Rugova",
Pallati Kontakt, kati 2,
Tiranë, Shqipëri
Në vëmendje të:
Florenc Gjikuria
florenc.gjikuria@gjikuria.com
Milo Gjikuria
milo.gjikuria@gjikuria.com

(2) Drejtuar Përfaqësuesit të Palëve Financuese:

Rruga "Ibrahim Rugova",
Tiranë, Shqipëri

Në vëmendje të:
Glenda Kurti
gkurti@tiranabank.al
+355696092289
Eranda Loci
eloci@tiranabank.al
+355699107487

(d) Ndryshimi i Adresës ose Emrit. Secila Palë do ta njoftojë menjëherë Palën tjetër të kësaj Kontrate, në rast ndryshimi të të dhënave të specifikuara në këtë nen.

Neni 11.06 Forca Madhore

(a) Nuk Konsiderohet Shkelje. Vonesa në përmbushjen e detyrimeve sipas kësaj Kontrate prej njërës nga Palët nuk do të quhet shkelje ose mospërmbushje e kësaj Kontrate në rast se vjen si rrjedhojë e Forcës Madhore me kusht që (i) Pala e prekur nga kjo ngjarje të ketë marrë të gjitha masat paraprake të arsyeshme, përkujdesjen e duhur dhe masa të ndryshme të arsyeshme, për të përmbushur afatet dhe kushtet e kësaj Kontrate, dhe (ii) të ketë njoftuar Palën tjetër brenda 5 (pesë) Ditëve Pune nga ndodhja e ngjarjes, duke specifikuar saktësisht llojin e Forcës Madhore dhe arsyet pse e bëjnë të pamundur përmbushjen e detyrimit përkatës.

(b) Ndryshimi i Kontratës. Në rast se pasojat e shkaktuara nga Forca Madhore janë të tilla që duhet bërë një modifikim i Kontratës, Palët bien dakord të fillojnë negociatat në mirëbesim për një ndryshim të Kontratës për të rregulluar pasojat e Forcës Madhore.

Neni 11.07 Heqja Dorë

Asnjë mospërmbushje ose vonesë në përmbushje nga secila Palë në ushtrimin e ndonjë të drejte ose kompetence të parashikuar në këtë Kontratë nuk mund të konsiderohet si heqje dorë, dhe as ushtrimi i pjesshëm apo vetëm i një të drejte, as braktisja ose mosndjekja e hapave të mëtejshëm për t'i zbatuar këto të drejta apo kompetenca, nuk do të intepretohet në asnjë rast si arsye për t'u bërë pengesë që Pala të ushtrojë në një kohë tjetër këto të drejta apo kompetenca, apo të ushtrojë në çdo rast të drejta apo kompetenca të tjera.

Neni 11.08 Veçueshmëria

Nëse, në çdo kohë, çfarëdo dispozite që përfshihet në këtë Kontratë ose çdo pjesë e saj, në çfarëdo mase, është ose bëhet e paligjshme, e pavlefshme, e ndaluar me ligj ose e pazbatueshme në çfarëdolloj aspekti sipas Legjislacionit të Zbatueshëm, kësaj dispozite nuk do t'i jepet asnjë efekt dhe do të konsiderohet se nuk është përfshirë në këtë Kontratë, por pa shfuqizuar dispozitat e tjera të Kontratës. Palët bien dakord që do bëjnë çdo përpjekje të mundshme dhe të arsyeshme që dispozita e paligjshme, e pavlefshme ose e pazbatueshme do të zëvendësohet me një dispozitë të ligjshme, të përshtatshme, të vlefshme, të zbatueshme dhe që t'i afrohet sa më shumë synimit dhe qëllimit të dispozitës së paligjshme, të pavlefshme ose të pazbatueshme.

Neni 11.09 Asnjë Interpretim Kundër Hartuesit

Palët pranojnë që kjo është një Kontratë e negociuar. Fakti që njëra Palë e Kontratës (apo këshilltarët e saj) ka hartuar Kontratën apo një dispozitë të caktuar të saj apo se ajo përfiton nga ajo dispozitë nuk do të përdoret kundër saj në interpretimin e kushteve të Kontratës.

Neni 11.10 Të Kuptuarit e Dokumenteve dhe Dispozitave

Palët pranojnë dhe janë dakord se ato i kanë lexuar dhe kuptuar kushtet, detyrimet dhe të drejtat e lindura nga kjo Kontratë dhe se ata kanë pasur mundësinë të këshillohen me juristë sipas zgjedhjes së tyre.

Neni 11.11 Ndryshimet

Ndryshimet e kësaj Kontrate, përfshirë dhe Shtojcat e saj, janë të vlefshme vetëm nëse bëhen me shkrim dhe nënshkruhen nga të dyja Palët.

Neni 11.12 Përfaqësuesi i Palëve Financuese

Pengdhënësi autorizon Përfaqësuesin e Palëve Financuese të ndërmarrë të gjitha veprimet që Përfaqësuesi i Palëve Financuese mund të mendojë se janë të nevojshme për të bërë Kontratën efektive dhe për t'i dhënë efekt çdo të drejte e detyrimi të Palëve në këtë Kontratë, për të mbrojtur apo ruajtur Pengun dhe për të realizuar procedurën e ekzekutimit të detyrueshëm sipas dispozitave te KREU 7 (*Ekzekutimi i Pengut*) i kësaj Kontrate.

Neni 11.13 Diskrecioni Lehtësues

Përfaqësuesi i Palëve Financuese mund të japë afate kohore shtesë ose lehtësira të tjera, kompromise, rregullime, të çlirojë ose të shkarkojë nga detyrimi apo të ndërmarrë veprime të tjera me Pengdhënësin siç mund ta shikojë të arsyeshme pa paragjykuar përgjegjësinë e Pengdhënësit apo të drejtat e Pengmarrësve. Pavarësisht parashikimeve më lart, ky diskrecion lehtësues nuk do të përbëjë detyrim për Pengmarrësit apo heqje dorë nga ndonjë e drejtë e Pengmarrësve.

Neni 11.14 Kontrata e Plotë

Kjo Kontratë është shtesë dhe jo zëvendësim i ndonjë Barre tjetër që mbahet tani apo do krijohet në të ardhmen nga Pengdhënësi, dhe kjo Kontratë është në dobi të Palëve dhe e detyrueshme për to si dhe për personat që mund të zenë vendin e tyre ose të cilëve u janë transferuar të drejtat dhe detyrimet.

Neni 11.15 Kopjet e Njëjta

Kjo Kontratë mund të nënshkruhet në 7 (shtatë) kopje, dhe çdonjëra prej të cilave kur është e nënshkruar dhe dorëzuar nga të dy Palët në mënyrë të rregullt, do të konsiderohet si origjinale dhe të gjitha së bashku do të përbëjnë një dokument të vetëm.

PALËT bien dakord me kushtet, të drejtat dhe detyrimet sa më lart dhe e nënshkruajnë këtë Kontratë më poshtë në datën 19 . 03 . 2021.

PENGËDHËNËS

GJIKURIA sh.p.k.

Përfaqësuar nga Administratorët

Z. Florenc Gjikuria

_____

Z. Milo Gjikuria

_____

PENGMARRËSIT

BANKA E TIRANËS sh.a.

Përfaqësuar nga:

Znj. Glenda Kurti

_____

Drejtore e Divizionit të Korporatave

Znj. Aida Cengu

_____

Drejtore e Departamentit të Administrimit të Kredive

BANKA INTESA SANPAOLO BANK ALBANIA sh.a.

Përfaqësuar nga:

Z.Alban Velo

_____

Drejtor i Departamentit të SME-ve

INTESA SANPAOLO BANK
Albania
Rr. I. Qemali, Nr 27. Tirane
Nipt: J81817006P

Znj. Jonida Duro

_____

Menaxhere e Marrëdhënieve me Klientët SME

BANKA OTP ALBANIA sh.a.

Përfaqësuar nga:

Z. Ferid Shijaku

_____

Drejtor i Divizionit të Biznesit

Z. Idit Farka

_____

Koordinator Projekti dhe i Financës së Strukturuar

NOTER

Znj. Eriketa Kokoli

_____

Shoqëria "Gjikuria" sh.p.k
Regjistruar si Person Juridik me Vendim Gjykate nr. 9293, datë 28.02.1995
NIPT J62903456H

Tiranë, 15 / 11 / 2020

VENDIM NR. 1

I

ASAMBLESË SË JASHTËZAKONSHME TË ORTAKËVE TË SHOQËRISË "GJIKURIA" SH.P.K

Në mbledhjen e sotme, Asambleja e jashtëzakonshme e ortakëve të shoqërisë Gjikuria sh.p.k, (në vijim "Shoqëria"), bazuar mbi dispozitat e Ligjit për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtarë, si dhe nenet 7.1, 7.2, 7.3, 8.1 e vijues të statutit të Shoqërisë,

VENDOSI :

1. Miratimin e të gjitha kontratave/marrëveshjeve të mëposhtme:

(i) Kontratë Kredie me afat për marrjen e një kredie nga "Shoqëria Koncesionare Rruga Orikum – Llogara" sh.p.k në shumën prej EUR 25,600,000 (njëzetë e pesë milion e gjashtëqind mijë euro) plus interesi i kapitalizuar gjatë 12 muajve pas Disbursimit të Parë, me Kredidhënës shoqëritë "Banka e Tiranës" sh.a, "Intesa Sanpaolo Bank Albania" sh.a dhe "Banka OTP Albania" sh.a. Periudha totale e shlyerjes së Kredisë është 10 vjet nga data e Disbursimit të Parë, por gjithmonë jo më vonë se 31.12.2031. Palët bien dakord që Kredimarresi do te paguaje Interes Kontraktor çdo 3-muaj mbi shumen e disbursuar dhe te pashlyer te kredise sipas Skedulit të Ripagimit të kredisë dorezuar Kredimarresit. Norma e Interesit Kontraktor eshte e ndryshueshme dhe do te llogaritet interes baze (indeks) BONO TIJESARI 12-mujor (norma mesatare e ponderuar) shtuar me marzhin 3.5 % (tre pikë pesë perqind) ne vit, por jo me pak se 6 % (gjashtë për qind) ne vit, ku Norma Baze e Interesit (indeks) eshte objekt rishikimi dhe ndryshimi nga Banka çdo 12-mujor. Norma Efektive e Interesit (NEI) është 6.41% (gjashtë pikë dyzetë e një për qind) në vit, e llogaritur duke u bazuar në Normën Vjetore të Interesit në ditën e lidhjes së kësaj Kontrate ;

(ii) Marrëveshjes së Kolaterali Financiar mbi të Ardhurat e Arkëtueshme të "Shoqëria Koncesionare Rruga Orikum – Llogara" sh.p.k të cilat do të përftohen nga Kontrata e Koncesionit Nr. 2515 Rep., Nr. 1353 Kol, datë 20.05.2019 ;

(iii) Marrëveshjes së Barrës Sigurimese rradhë e parë mbi të Ardhurat e Arkëtueshme të "Shoqëria Koncesionare Rruga Orikum – Llogara" sh.p.k të cilat do të përftohen nga Kontrata e Koncesionit Nr. 2515 Rep., Nr. 1353 Kol, datë 20.05.2019 ;

(iv) Marrëveshje Kolaterali Financiar mbi Kuotat e "Shoqëria Koncesionare Rruga Orikum – Llogara" sh.p.k dhe të shoqërisë "Gjikuria" sh.p.k , në favor të "Banka e Tiranës" sh.a, Banka OTP Albania sh.a., Intesa San Paolo Bank Albania sh.a. ;

(v) Marrëveshje Barrë Siguruese rradhë e parë mbi Kuotat e "Shoqëria Koncesionare Rruga Orikum – Llogara" sh.p.k dhe të shoqërisë "Gjikuria" sh.p.k , në favor të "Banka e Tiranës" sh.a, Banka OTP Albania sh.a., Intesa San Paolo Bank Albania sh.a. ;

(vi) Marrëveshje e Pengut rradhë e parë mbi Kuotat e "Shoqëria Koncesionare Rruga Orikum – Llogara" sh.p.k dhe të shoqërisë "Gjikuria" sh.p.k , në favor të "Banka e Tiranës" sh.a, Banka OTP Albania sh.a., Intesa San Paolo Bank Albania sh.a. ;

(vii) Marrëveshje Barrë Siguruese rradhë e parë mbi Asetet e tashmë të shoqërisë "Gjikuria" sh.p.k me vlerën e regjistruar sipas bilancit të auditurar të vitit 2019, në favor të "Banka e Tiranës" sh.a, Banka OTP Albania sh.a., Intesa San Paolo Bank Albania sh.a.

(viii) Marrëveshjes së Barrës Siguruese rradhë e parë mbi Asetet e tashme dhe të ardhshme të "Shoqërisë Koncesionare Rruga Orikum – Llogara" sh.p.k;

(ix) Marrëveshje Kolaterali Financiar mbi të Ardhurat e tashme dhe të ardhshme të shoqërisë "Gjikuria" sh.p.k nga projekte të ndryshme sipas shtojces 8 "Projektet shtese te koncesionarit", ku vlera e të cilave nuk duhet të jetë më pak se 7,000,000 EUR (shtatë milion euro), në favor të "Banka e Tiranës" sh.a, Banka OTP Albania sh.a., Intesa San Paolo Bank Albania sh.a. ;

(x) Marrëveshje Barrë Siguruese rradhë e parë mbi të Ardhurat e tashme dhe të ardhshme të shoqërisë "Gjikuria" sh.p.k nga projekte të ndryshme sipas shtojces 8 "Projektet shtese te koncesionarit", ku vlera e të cilave nuk duhet të jetë më pak se 7,000,000 EUR (shtatë milion euro), në favor të "Banka e Tiranës" sh.a, Banka OTP Albania sh.a., Intesa San Paolo Bank Albania sh.a. ;

(xi) Marrëveshje Kolaterali Financiar mbi të Ardhurat që do të përftohen nga Marrëveshja e lidhur ndërmjet "Shoqëria Koncesionare Rruga Orikum – Llogara" sh.p.k dhe shoqërisë "Gjikuria" sh.p.k, në favor të "Banka e Tiranës" sh.a, Banka OTP Albania sh.a., Intesa San Paolo Bank Albania sh.a. ;

(xii) Marrëveshje e Barrës Sigurimesë radhë e parë mbi të Arkëtueshmat që do të përftohen nga Marrëveshja e lidhur ndërmjet "Shoqëria Koncesionare Rruga Orikum – Llogara" sh.p.k dhe shoqërisë "Gjikuria" sh.p.k, , në favor të "Banka e Tiranës" sh.a, Banka OTP Albania sh.a., Intesa San Paolo Bank Albania sh.a. ;

(xiii) Kontrata e Dorëzanisë së shoqërisë "Gjikuria" sh.p.k, në favor të "Banka e Tiranës" sh.a, Banka OTP Albania sh.a., Intesa San Paolo Bank Albania sh.a.

4. Autorizimin së bashku të administratorëve të Shoqërisë, Z. Florenc Gjikuria dhe Z. Milo Gjikuria, për nënshkrimin e kontratave/marrëveshjeve të përmendura në pikën 1 më sipër në emër dhe për llogari të shoqërisë "Gjikuria" sh.p.k.

5. Autorizimin së bashku të administratorëve të Shoqërisë, Z. Florenc Gjikuria dhe Z. Milo Gjikuria, të ndjekin të gjitha hapat dhe procedurat si dhe nënshkruajnë të gjithë aktet apo të ndërmarrin të gjitha veprimet e nevojshme me qëllim regjistrimin në regjistrat publikë dhe/ose efektivitetin dhe/ose kompletimin e këtyre kontratave/marrëveshjeve.

6. Në rast se do të ketë amendime/shtojca të kontratave/marrëveshjeve të mësipërme, në çdo rast do të paraqiten vendime të reja Asambleje.

7. Autorizimin së bashku të administratorëve të Shoqërisë, Z. Florenc Gjikuria dhe Z. Milo Gjikuria, për të marrë pjesë në mbledhjen e asamblesë së përgjithshme të Shoqëria Koncesionare "Rruga Orikum – Llogara" sh.p.k., në cilësinë e ortakut të vetëm, për miratimin e kontratave/marrëveshjeve dhe nënshkrimin e çdo vendimi asambleje, sipas rendit të ditës si më poshtë:

"1. Miratimin e kontratave/marrëveshjeve të mëposhtme:

(i) Kontratë Kredie me afat për marrjen e një kredie nga "Shoqëria Koncesionare Rruga Orikum – Llogara" sh.p.k në shumën prej EUR 25,600,000 (njëzetë e pesë milion e gjashtëqind mijë euro) plus interesi i kapitalizuar gjatë 12 muajve pas Disbursimit të Parë, me Kredidhënës shoqëritë "Banka e Tiranës" sh.a. "Intesa Sanpaolo Bank Albania" sh.a dhe "Banka OTP Albania" sh.a. Perindha totale e shlyerjes së Kredisë është 10 vjet nga data e Disbursimit të Parë, por gjithmonë jo më vonë se 31.12.2031. Palët bien dakord që Kredimarresi do te paguaje Interes Kontraktor çdo 3-muaj mbi shumen e disbursuar dhe te pashlyer te kredise sipas Skedulit të Ripagimit të kredisë dorezuar Kredimarresit. Norma e Interesit Kontraktor eshte e ndryshueshme dhe do te llogaritet interes baze (indeks) BONO THESARI 12-mujor (norma mesatare e ponderuar) shtuar me marzhin 3.5 % (tre pikë pesë per qind) ne vit. por jo me pak se 6 % (gjashtë për qind) ne vit. ku Norma Baze e Interesit (indeks) eshte objekt rishikimi dhe ndryshimi nga Banka çdo 12-mujor. Norma Efektive e Interesit (NEI) eshte 6.41% (gjashtë pikë dyzetë e një për qind) në vit. e llogaritur duke u bazuar në Normën Vjetore të Interesit në ditën e lidhjes së kësaj Kontrate ;

(ii) Marrëveshje Kolaterali Financiar mbi të Ardhurat e Arkëtueshme të Kredimarrësit, të cilat do të përftohen nga Kontrata e Koncesionit Nr. 2515 Rep., Nr. 1353 Kol, datë 20.05.2019, në favor të "Banka e Tiranës" sh.a, Banka OTP Albania sh.a., Intesa San Paolo Bank Albania sh.a. ;

(iii) Marrëveshje e Barrës Sigurnese rradhë e parë mbi të Ardhurat e Arkëtueshme të Kredimarrësit, të cilat do të përftohen nga Kontrata e Koncesionit Nr. 2515 Rep., Nr. 1353 Kol, datë 20.05.2019, në favor të "Banka e Tiranës" sh.a, Banka OTP Albania sh.a., Intesa San Paolo Bank Albania sh.a. ;

(iv) Marrëveshje e Barrës Sigurnese rradhë e parë mbi Asetet e tashme dhe të ardhshme të Kredimarrësit, në favor të "Banka e Tiranës" sh.a, Banka OTP Albania sh.a., Intesa San Paolo Bank Albania sh.a. ;

(v) Marrëveshje Kolaterali Financiar mbi të Ardhurat që do të përftohen nga Marrëveshja e lidhur ndërmjet Kredimarrësit dhe Koncesionarit, në favor të "Banka e Tiranës" sh.a, Banka OTP Albania sh.a., Intesa San Paolo Bank Albania sh.a. ;

(vi) Marrëveshje e Barrës Sigurnese rradhë e parë mbi të Ardhurat që do të përftohen nga Marrëveshja e lidhur ndërmjet Kredimarrësit dhe Koncesionarit, në favor të "Banka e Tiranës" sh.a, Banka OTP Albania sh.a., Intesa San Paolo Bank Albania sh.a.

(vii) Marrëveshje Kolaterali Financiar mbi Kuotat e "Shoqëria Koncesionare Rruga Orikum – Llogara" sh.p.k, në favor të "Banka e Tiranës" sh.a, Banka OTP Albania sh.a., Intesa San Paolo Bank Albania sh.a. ;

(viii) Marrëveshje Barrë Sigurnese rradhë e parë mbi Kuotat e "Shoqëria Koncesionare Rruga Orikum – Llogara" sh.p.k, në favor të "Banka e Tiranës" sh.a, Banka OTP Albania sh.a., Intesa San Paolo Bank Albania sh.a. ;

(ix) Marrëveshje e Pengu rradhë e parë mbi Kuotat e "Shoqëria Koncesionare Rruga Orikum – Llogara" sh.p.k, në favor të "Banka e Tiranës" sh.a, Banka OTP Albania sh.a., Intesa San Paolo Bank Albania sh.a.

2. Autorizimin e administratorit të Shoqërisë, Z. Ermal Ali për nënshkrimin e kontratave/marrëveshjeve të përmendura në pikën 1 më sipër ku Shoqëria është palë.

3. Autorizimin e administratorit të Shoqërisë, Z. Ermal Ali, të ndjekë të gjitha hapat dhe procedurat si dhe nënshkruajë të gjithë aktet apo të ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme me qëllim regjistrimin në regjistrat publikë dhe/ose efektivitetin dhe/ose kompletimin e këtyre kontratave/marrëveshjeve.

4. Në rast se do të ketë amendime/shtojca të kontratave marrëveshjeve të mësipërme, në çdo rast do të paraqiten vendime të reja Asamblejë".

ORTAKËT E SHOQËRISË

Z. Florenc Gjikuria

(emër, mbiemër, nënshkrimi, vula)

Z. Milo Gjikuria

(emër, mbiemër, nënshkrimi, vula)

Shoqëria "Gjikuria" sh.p.k
Regjistruar si Person Juridik me Vendim Gjykate nr. 9293, datë 28.02.1995
NIPT J62903456H

PROCESVERBAL

I

MBLEDHJES SË JASHTËZAKONSHME TË ASAMBLESË SË ORTAKËVE TË SHOQËRISË "GJIKURIA" SH.P.K

I mbajtur sot më datë 15 / 11 / 2020, ora 09:00, në selinë e Shoqërisë "Gjikuria" sh.p.k, shoqëri me përgjegjësi të kufizuar e regjistruar me Vendimin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë nr. 9293, datë 28.02.1995 dhe NIPT J62903456H, (në vijim "Shoqëria"), me adresë Rruga "Ibrahim Rugova", pranë Gardës së Republikës, Pallati Kontakt, mbi Union Bank, Tiranë.

Mbledhja e jashtëzakonshme e asamblesë së ortakëve zhvillohet në përputhje me nenet 7.2, 7.3, 8.1 e vijues të statutit të Shoqërisë.

Verifikohet prezenca e anëtarëve:

Të pranishëm në këtë mbledhje janë të gjithë ortakët e Shoqërisë, respektivisht Z. Florene Gjikuria, i biri i Milos, lindur më datë 12.01.1973 në Memaliaj, Tepelenë dhe me banim në Tiranë, i identifikuar me Kartën e Identitetit me numër personal H30112106D, dhe Z. Milo Gjikuria, i lindur më datë 25.07.1943 në Dhërmi, Vlorë dhe me banim në Tiranë, i identifikuar me Kartën e Identitetit me numër personal E30725035J, të cilët zotërojnë 100% të kuotave të Shoqërisë. Gjikuria sh.p.k është ortake e vetme e Shoqëria Koncesionare "Rruga Orikum - Llogara" sh.p.k.

Ortakët prezentë morën në shqyrtim rendin e ditës si më poshtë vijon:

1. Miratimin e kontratave/marrëveshjeve të mëposhtme:

(i) Kontratë Kredie me afat për marrjen e një kredie nga "Shoqëria Koncesionare Rruga Orikum – Llogara" sh.p.k në shumën prej EUR 25,600,000 (njëzetë e pesë milion e gjashtëqind mijë euro) plus interesi i kapitalizuar gjatë 12 muajve pas Disbursimit të Parë, me Kredidhënës shoqëritë "Banka e Tiranës" sh.a, "Intesa Sanpaolo Bank Albania" sh.a dhe "Banka OTP Albania" sh.a. Periudha totale e shlyerjes së Kredisë është 10 vjet nga data e Disbursimit të Parë, por gjithmonë jo më vonë se 31.12.2031. Palët bien dakord që Kredimarresi do te paguaje Interes Kontraktor çdo 3-muaj mbi shumen e disbursuar dhe te pashlyer te kredise sipas Skedulit të Ripagimit të kredisë dorezuar Kredimarresit. Norma e Interesit Kontraktor eshte e ndryshueshme dhe do te llogaritet interes baze (indeks) BONO THESARI 12-mujor (norma mesatare e ponderuar) shtuar me marzhin 3.5 % (tre pikë pesë perqind) ne vit, por jo me pak se 6 % (gjashtë për qind) ne vit, ku Norma Baze e Interesit (indeks) eshte objekt rishikimi dhe ndryshimi nga Banka çdo 12-mujor. Norma Efektive e Interesit (NEI) është 6.41% (gjashtë pikë dyzetë e një për qind) në vit, e llogaritur duke u bazuar në Normën Vjetore të Interesit në ditën e lidhjes së kësaj Kontrate ;

(ii) Marrëveshjes së Kolateralit Financiar mbi të Ardhurat e Arkëtueshme të "Shoqëria Koncesionare Rruga Orikum – Llogara" sh.p.k të cilat do të përfitohen nga Kontrata e Koncesionit Nr. 2515 Rep., Nr. 1353 Kol, datë 20.05.2019 ;

(iii) Marrëveshjes së Barrës Siguruese rradhë e parë mbi të Ardhurat e Arkëtueshme të "Shoqëria Koncesionare Rruga Orikum – Llogara" sh.p.k të cilat do të përfitohen nga Kontrata e Koncesionit Nr. 2515 Rep., Nr. 1353 Kol, datë 20.05.2019;

(iv) Marrëveshje Kolaterali Financiar mbi Kuotat e "Shoqëria Koncesionare Rruga Orikum – Llogara" sh.p.k dhe të shoqërisë "Gjikuria" sh.p.k , në favor të "Banka e Tiranës" sh.a, Banka OTP Albania sh.a., Intesa San Paolo Bank Albania sh.a. ;

(v) Marrëveshje Barrë Siguruese rradhë e parë mbi Kuotat e "Shoqëria Koncesionare Rruga Orikum – Llogara" sh.p.k dhe të shoqërisë "Gjikuria" sh.p.k , në favor të "Banka e Tiranës" sh.a, Banka OTP Albania sh.a., Intesa San Paolo Bank Albania sh.a. ;

(vi) Marrëveshje e Pengut rradhë e parë mbi Kuotat e "Shoqëria Koncesionare Rruga Orikum - Llogara" sh.p.k dhe të shoqërisë "Gjikuria" sh.p.k , në favor të "Banka e Tiranës" sh.a, Banka OTP Albania sh.a., Intesa San Paolo Bank Albania sh.a. ;

(vii) Marrëveshje Barrë Siguruese rradhë e parë mbi Asetet e tashme të shoqërisë "Gjikuria" sh.p.k me vlerën e regjistruar sipas bilancit të auditurar të vitit 2019, në favor të "Banka e Tiranës" sh.a, Banka OTP Albania sh.a., Intesa San Paolo Bank Albania sh.a.

(viii) Marrëveshjes së Barrës Siguruese rradhë e parë mbi Asetet e tashme dhe të ardhshme të "Shoqërisë Koncesionare Rruga Orikum - Llogara" sh.p.k;

(ix) Marrëveshje Kolaterali Financiar mbi të Ardhurat e tashme dhe të ardhshme të shoqërisë "Gjikuria" sh.p.k nga projekte të ndryshme sipas shtojces 8 "Projektet shtese te koncesionarit", ku vlera e të cilave nuk duhet të jetë më pak se 7,000,000 EUR (shtatë milion euro), në favor të "Banka e Tiranës" sh.a, Banka OTP Albania sh.a., Intesa San Paolo Bank Albania sh.a. ;

(x) Marrëveshje Barrë Siguruese rradhë e parë mbi të Ardhurat e tashme dhe të ardhshme të shoqërisë "Gjikuria" sh.p.k nga projekte të ndryshme sipas shtojces 8 "Projektet shtese te koncesionarit", ku vlera e të cilave nuk duhet të jetë më pak se 7,000,000 EUR (shtatë milion euro), në favor të "Banka e Tiranës" sh.a, Banka OTP Albania sh.a., Intesa San Paolo Bank Albania sh.a. ;

(xi) Marrëveshje Kolateralit Financiar mbi të Ardhurat që do të përftohen nga Marrëveshja e lidhur ndërmjet "Shoqëria Koncesionare Rruga Orikum - Llogara" sh.p.k dhe shoqërisë "Gjikuria" sh.p.k, në favor të "Banka e Tiranës" sh.a, Banka OTP Albania sh.a., Intesa San Paolo Bank Albania sh.a. ;

(xii) Marrëveshje e Barrës Siguruese rradhë e parë mbi të Ardhurat që do të përftohen nga Marrëveshja e lidhur ndërmjet "Shoqëria Koncesionare Rruga Orikum – Llogara" sh.p.k dhe shoqërisë "Gjikuria" sh.p.k, , në favor të "Banka e Tiranës" sh.a, Banka OTP Albania sh.a., Intesa San Paolo Bank Albania sh.a. ;

(xiii) Kontrata e Dorëzanisë së shoqërisë "Gjikuria" sh.p.k, në favor të "Banka e Tiranës" sh.a, Banka OTP Albania sh.a., Intesa San Paolo Bank Albania sh.a.

2. Autorizimin së bashku të administratorëve të Shoqërisë, Z. Florenc Gjikuria dhe Z. Milo Gjikuria, për nënshkrimin e kontratave/marrëveshjeve të përmendura në pikën 1 më sipër në emër dhe për llogari të shoqërisë "Gjikuria" sh.p.k.

3. Autorizimin së bashku të administratorëve të Shoqërisë, Z. Florenc Gjikuria dhe Z. Milo Gjikuria, të ndjekin të gjitha hapat dhe procedurat si dhe nënshkruajnë të gjithë aktet apo të ndërmarrin të gjitha veprimet e nevojshme me qëllim regjistrimin në regjistrat publikë dhe/ose efektivitetin dhe/ose kompletimin e këtyre kontratave/marrëveshjeve.

4. Në rast se do të ketë amendime/shtojca të kontratave/marrëveshjeve të mësipërme, në çdo rast do të paraqiten vendime të reja Asambleje.

5. Autorizimin së bashku të administratorëve të Shoqërisë, Z. Florenc Gjikuria dhe Z. Milo Gjikuria, për të marrë pjesë në mbledhjen e asamblesë së përgjithshme të Shoqëria Koncesionare "Rruga Orikum - Llogara" sh.p.k., në cilësinë e ortakut të vetëm, për

miratimin e kontratave/marrëveshjeve dhe nënshkrimin e çdo vendimi asamblejë, sipas rendit të ditës si më poshtë:

"1. Miratimin e kontratave/marrëveshjeve të mëposhtme:

